REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

# MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T.U-së
**Z. EDI RAMA**

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Z. ARBEN GUMENI

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak
Nr. 60 Datë 31.10.2024

Kryetar i Bashkisë
Z. TËRMET PEÇI

## PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË TEPELENË
## PLANI I ZHVILLIMIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit
Nr. 52 , Datë 24.12.2024

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit: Z. LORENC BAMI

STUDIO KONSULENTE: B.O.E "ARCHISPACE sh.p.k." & "Sferastudio sh.p.k" & "A&I Design sh.p.k"
Përfaqësuesi B.O.E ligjor
Rais Petrela
Nr. Liç 6732/6

REFF: Kontrate Nr.10490/5 date.27.09.2018

## TABELA E PËRMBAJTJES


**REZULTATI – PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TË BASHKISË TEPELENË .............. 5**

**1.1 PLANI I PROPOZUAR I PËRDORIMIT TË TOKËS ................................................ 5**

1.1.0. HYRJE ........................................................................................................ 5

1.1.1 STRUKTURIMI i TERRITORIT SIPAS PESE SISTEMEVE TERRITORIALE .................... 8

1.1.2 STRUKTURIMI I TERRITORIT NË ZONA DHE NJËSI STRUKTURORE ...................... 17

1.1.3 PROPOZIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS SIPAS KATEGORIVE, NËNKATEGORIVE DHE FUNKSIONEVE ............................................................. 20

1.1.4 ZONAT E RËNDËSISE KOMBËTARE ........................................................ 34

1.1.5 ZONAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE URBAN ........................ 43

1.1.6 ZHVILLIMI I I NJËSIVE QË DO TË JENË SUBJEKT I PLANEVE TË DETAJUARA VENDORE ............................................................................................. 57

1.1.7 SHPËRNDARJA E POPULLSISË NË TERRITORIN E BASHKISË TEPELENË ............ 60

1.1.8 PLANI I STREHIMIT .................................................................................. 62

1.1.9 INSTRUMENTAT PËR DREJTIMIN E ZHVILLIMIT ........................................ 65

**2.2 PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE ........................... 66**

2.2.1. RRJETI I INFRASTRUKTURES SË TRANSPORTIT ............................................ 66

2.2.2. SKEMA E TRANSPORTIT PUBLIK .................................................................. 77

2.2.3. RRJETI I INFRASTRUKTURAVE INXHINIERIKE .............................................. 79

**3.3.PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT ................................................................. 104**

3.3.1 KUADRI RREGULLATOR PËR MBROJTJEN E PEIZAZHIT .................................. 104

**4.4 PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR ...... 120**

4.4.1 PLANI I VEPRIMEVE .................................................................................. 120

4.4.2 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE - PIK ......................................................... 127

4.4.3 NDRYSHIMET INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR ZBATIMIN E PPV-SË .......... 146

4.4.4 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCES PËR HARTIMIN E PDV'VE ................................................................................................. 159

4.4.5 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCES PËR HARTIMIN E PLANEVE SEKTORIALE ............................................................................. 161

4.4.6 TREGUESIT E MONITORIMIT PËR ZBATIMIN E PPV-SË ..................................... 163

4.4.7 FAKTORËT QË NDIKOJNË RISHIKIMIN E PLANIT të PËRGJITHSHËM VENDOR .. 169

6.5. SHTOJCAT ................................................................................................ 170

6.6. DËGJESA PUBLIKE .................................................................................... 174



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA

ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration - studio@archispace.com NIPT L42403012A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA

# TABELA E FIGURAVE


fig 1 – Harta administrative e Bashkisë Tepelenë ........ 7
fig 2 – Tabela e perberjes administrative të Bashkisë Tepelenë, ........ 8
fig 3 - Pamje e qendres së qytetit të Tepelenës, e dominuar nga muret e kalasë së Tepelenës ........ 8
fig 4 – Pamje panoramike e pozicionimit të qytetit të Tepelenës, me malin e Golikut në sfond. ........ 10
fig 5 – Pamje e rezervuarit të Turanit, pjesë e sistemit bujqësor të Bashkisë Tepelenë. ........ 11
fig 6 – Pamje natyrore e lugines së përroit të Turanit, pranë fshatit Veliqot ........ 11
fig 7 – Pamje e lumit Vjose poshte qytetit Tepelenë, perberesi kryesor i Sistemit Territorial Ujor ........ 12
fig 8 - Harta e Konvertimit të Sistemeve Territoriale të Bashkisë Tepelenë, sipas Strategjisë Territoriale ........ 13
fig 9 – Fragment i hartes së Njësive Strukturore në nivel qyteti ........ 15
fig 10 - Harta e listes së plote të Projekteve Strategjike të zhvillimit të Bashkisë Tepelenë ........ 17
fig 11 – Harta e ndarjes së territorit në Zona dhe Njësi Strukturore – Bashkia Tepelenë ........ 19
fig 12 – Pamje e qytetit të Tepelenës, dominuar nga banesat kolektive 4-5 kateshe ........ 23
fig 13 – Harta e nen-kategorive të përdorimit të tokës – Bashkia Tepelenë ........ 29
fig 14 – Harta e Zonave të Rëndësise Kombëtare – Bashkia Tepelenë ........ 35
fig 15 - Tabela e objekteve dhe zonave te klasifikuara ne pasuri kulturore te paluejteshme ........ 38
fig 16 - Pamje ajrore e kalasë së Tepelenës, në qender të qytetit ........ 39
fig 17 - Fragment 1 PKK - Sistemi Natyror, territoret jugore të Shqipërisë ........ 41
fig 18 - Fragment PKK - Sistemi Infrastrukturor ........ 42
fig 19 - Harta e zonave të rëndësisë kombëtare në Bashkinë Tepelenë ........ 43
fig 20 - Harta e Vizionit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Tepelenë ........ 44
fig 21 - Pozicioni strategjik i propozuar për ferme blegtorale pranë fshatrave Progonat, Gusmar, Nivicë ........ 46
fig 22 - Pozicioni strategjik i propozuar për ferme blegtorale pranë fshatrave Dhëmblan dhe Sinanaj 46
fig 23 - Pozicioni strategjik i propozuar për ferme blegtorale pranë fshatrave Dukaj dhe Turan ........ 47
fig 24 - Pamje ballore e muzeut etnografik te qytetit te Tepelenës ........ 49
fig 25 - Pamje e gjendjes fizike ekzistuese të shtepise së Selam Musait në fshatin Salari. ........ 49
fig 26 - Pamje e shtepise se Selam Musait, pas procesit te restaurimit dhe muzealizimit, ne fshatin Salari ........ 50
fig 27 – Skeme koncept i ndërhyrjes në strukturen ndertimore të Nivicës ........ 51
fig 28 – Pamje e sheshit te rikonstruktuar te Nivicës ........ 52
fig 29 – Tipologjia e baneses se gurit ........ 52
fig 30 – Masterplani i propozuar i fshatit Nivicë si model ndërhyrjeje ........ 53
fig 31- Pamje 3-dimensionale e propozuar e qendres së Nivicës ........ 54
fig 32 - Skema e transformimeve strategjike demografike në Bashkinë Tepelenë ........ 55
fig 33 - Harta e Njësive Strukturore të parashikuar për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore ........ 57
fig 34 - Tabela e Njësive Strukturore të planifikuara për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore ........ 59
fig 35 - Tabela e prognozës demografike Tepelenë 2034 ........ 61
fig 36 - Skema e rrjeteve rrugore të propozuara në Bashkinë Tepelenë, sipas kategorive përkatëse ........ 67
fig 37 - Prerjet terthore të rrjetit rrugor, sipas kategorive të Kodit Rrugor ........ 74
fig 38 - Tabela e klasifikimit të akseve rrugore sipas funksionit të tyre, treguesve të trafikut, si dhe parametrave teknike, sinjalistikes dhe shpejtesise ........ 76
fig 39 - Rrjeti i linjave nderqytetese të Bashkisë Tepelenë – miratuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise ........ 77
fig 40 - Skema e transportit publik të ropozuar, Bashkia Tepelenë ........ 78
fig 41 - Lista e Fiderave që dalin nga nenstacioni në Bashkinë Tepelenë ........ 80
fig 42 – Skema e furnizimit me energji elektrike të Bashkisë Tepelenë ........ 81
fig 43 - Skeme grafike e sistemeve të propozuara të filtrimit të ujerave në zonat rurale ........ 92
fig 44 - Harta e shpërndarjes së shërbimit arsimor dhe shëndetësor ........ 102
fig 45 - Foto ilustruese të zgarave filtruese metalike në rreze të pemeve pergjate rrugëve ........ 106
fig 46 - Shembull ilustrues i gjelbërimit të nje korridori kembesor me dy tipe të veçanta pemesh – Shanhai, Kinë ........ 107

fig 47 - Shembuj të aplikimit të pishes si gjelbërim urban – Romë, Itali ............ 108
fig 48 – Harta e fazimit te PDV've, per zbatimin e Planit te Përgjithshëm Vendor ............ 121
fig 49 - Tabela e të ardhurave tatimore – PBA 2019-2021, Bashkia Tepelenë ............ 128
fig 50 - Tabela e shperndarjes së burimeve financiare – PBA 2019-2021, Bashkia Tepelenë ............ 128
fig 51– Paraqitje tabelare e të dhenave financiare të Bashkisë Tepelenë për periudhen 2017-2019.... 139
fig 52 – Paraqitje grafike e te dhenave financiare te Bashkise Tepelenë per periudhen 2017 - 2019. 139
fig 53 - Paraqitje krahasimore e raportit të zerave të shpenzimeve buxhetore për vitet 2017-2019 – Bashia Tepelenë ............ 140
fig 54 - Tabela e burimeve të financimit për investimet kapitale për periudhen 2017-2019 – Bashkia Tepelenë ............ 141
fig 55 - Tabela e rritjes reale të ekonomise, shprehur në termat e rritjes së PBB, në nivel kombëtar 142
fig 56 - Përmbledhje e kategorive dhe sipërfaqes së pronave në pronesi të Bashkisë Tepelenë ......... 142
fig 57 - Tabela përmbledhese e burimeve dhe nevojave financiare të PIK- Bashkia Tepelenë........... 145
fig 58 - Pamje të vershimit të lumit Vjosë , dhjetor 2017 ............ 173
fig 59 - Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Z. Termet Peçi, duke mbajtur fjalen e hapjes së takimit.......... 174
fig 60 - Pamje të degjeses publike në Bashkinë Tepelenë ............ 175

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA

ARCHISPACE STUDIO - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration - Architecture - studio@archi-space.com NIPT: L42403012A

# REZULTATI – PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TË BASHKISË TEPELENË

## 1.1 PLANI I PROPOZUAR I PËRDORIMIT TË TOKËS

### 1.1.0. HYRJE

Qëllimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë është koordinimi dhe harmonizimi i procesit të zhvillimit të parametrave të 5 sistemeve territoriale të planifikimit afatgjatë të kësaj njësie vendore, specifikuar sipas kuadrit rregullator të Planifikimit të Territorit (Ligjin Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar.

Synimi afatgjatë i këtij dokumenti është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë të të gjithë elementëve territoriale dhe infrastrukturore të Bashkisë Tepelenë, në kontekstin e orientimit të suksesshëm të kërkesave për zhvillim dhe investimeve në territoret urbane, pozicionimin dhe fazat e zhvillimit të hapësirave ekonomike, sociale dhe të argëtimit, në koordinim me mbrojtjen dhe ripërtëritjen e mjedisit.

Dokumenti në vazhdim i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë është hartuar duke u mbështetur në përfundimet dhe rekomandimet e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit si dhe të Dokumentit të Strategjisë Territoriale. Plani mundëson ndërthurjen finale të gjetjeve dhe propozimeve të analizës së Strategjisë, të zbërthyer dhe të interpretuar në projeksione demografike, transformime territoriale, infrastrukturore dhe të shërbimeve. Dy komponentë thelbësorë të PPV janë gjithashtu dokumentet e Rregullores si dhe Plani i Investimeve Kapitale.

Në dokumentin e PPV trajtohet në mënyrë të detajuar elementi i rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Bashkisë Tepelenë, me qëllim zbatimin rigoroz dhe efiçient të Planit. Ky element është pasur në konsideratë gjatë gjithë procesit dhe metodologjisë së hartimit të Planit, nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit dhe koncepteve midis grupeve të punës.

Nëpërmjet Planit realizohet zbatimi konkret dhe efektiv i propozimeve të Strategjisë Territoriale për Bashkinë Tepelenë, nëpërmjet përcaktimit të mënyrës së zhvillimit sipas propozimeve të hartuara për të gjithë territorin administrativ që përfshin kjo Njësi Vendore.

#### 1.1.0.1 PËRMBLEDHJE INFORMATIVE E BASHKISË TEPELENË

E krijuar në vitin 2015, pas miratimit të Reformës së re Administrative Territoriale, Bashkia Tepelenë pozicionohet në rajonin jug-perëndimor të territorit të Republikës së Shqipërisë, pjesë administrative e Qarkut të Gjirokastrës. Ajo përllogaritet me një sipërfaqe të

përgjithshme 431, 24 km² dhe një popullsi prej 8,949 banorësh, dhe me një dendësi prej 20,75 banorë/km². Duhet përmendur fakti së të dhënat për popullsinë i referohen Censusit të vitit 2011, ndërkohë që të dhënat e popullsisë nga regjistrat e gjendjes civile flasin për një popullsi prej rreth 16,371 banorësh. Kjo diferencë e madhe vjen si rezultat i levizjeve të mëdha demografike që kanë pësuar këto vendbanime pas viteve 90-të.



*fig 1 – harta administrative e Bashkisë Tepelenë*

Shtrirja e territorit të Bashkisë përgjatë aksit rrugor të Jugut, Levan – Tepelenë – Gjirokastër, ofron një pozicionim strategjik mjaft të mirë, ku ofrohen mundësi të mira për stimulimin dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Lidhje të drejtpërdrejtë organike kjo Njësi Vendore realizon me Bashkinë Memaliaj, Kelcyrën, si dhe Gjirokastrën, ndërsa komunikimi me Himarën dhe me Selenicën është i vështirë për shkak të gjendjes fizike të akseve rrugore, ku përmendim aksin e vjetër kombëtar Tepelenë-Sevaster-Kotë.

Në territorin e kësaj Bashkie ndodhet 1 qytet dhe 25 fshatra, të organizuar në 4 njësi administrative, sipas tabelës së mëposhtme:

1. **Njësia Administrative Tepelenë** – Qytet Tepelenë
2. **Njësia Qendër Tepelenë** - Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat
3. **Njësia Administrative Lopës** - Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmblan, Lab Martalloz
4. **Njësia Administrative Kurvelesh** - Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin

| **Njësitë** | **Qytet/Fshatrat** | **Popullsia** |
|---|---|---|
| Njësia Administrative **Tepelenë** | Qytet Tepelenë | 4342 |
| Njësia Administrative **Qendër Tepelenë** | Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat | 3179 |
| Njësia Administrative **Lopës** | Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmblan, Lab-Martalloz | 723 |
| Njësia Administrative **Kurvelesh** | Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin | 705 |
| Total | | 8949 |

*fig 2 – Tabela e perberjes administrative të Bashkisë Tepelenë,*

Struktura urbane e Bashkisë Tepelenë ka karakteristika territoriale tipike rurale, e kushtëzuar nga konfiguracioni i thyer kodrinor-malor i terrenit. Në mënyrë të listuar, karakteristikat kryesore të territorit të kësaj Njësie Vendore mund të përmblidhen si më poshtë:

- Reliev dominues kodrinor malor
- Formacione gjeologjike gëlqerore
- Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 732 m.
- Pika më e ulët – shtrati i Vjosës – 105 metra mbi nivelin e detit.
- Pika më e lartë - maja e Këndrevicës 2122 metra mbi nivelin e detit



*fig 3 - Pamje e qendres së qytetit të Tepelenës, e dominuar nga muret e kalasë së Tepelenës*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration - ARCHISPACE STUDIO - studio@archi-space.com NIPT: L42403012A

Qyteti i Tepelenës ka një pozicion qëndror në të gjithë strukturën urbane të Bashkisë, ndërkohë që fshatrat janë të pozicionuar përgjatë akseve rrugore lokale, tipare këto mjaft të dallueshme për Njësitë Administrative Lopës dhe Kurvelesh. Në aspektin e infrastrukturës dhe shërbimeve, ky pozicionim i fshatrave përbën një element të favorshëm nga pikëpamja administrative financiare për Bashkinë Tepelenë. Kjo vjen për faktin së në rastet kur vendbanimet janë pranë njëra tjetrës dhe pranë një aksi komunikimi kryesor, kostot e ndërtimit dhe mirëmbajtjes periodike të infrastrukturave ulen në mënyrë të konsiderueshme. E kundërta mund të thuhet për Bashkinë fqinje Memaliaj, e cila ka një konfiguracion urban mjaft të shpërhapur, me një numër të madh fshatrash në distancë nga njëri tjetri, dhe si rrjedhim me kosto të mëdha infrastrukturash dhe shërbimesh në aspektin e ndertimit dhe të mirembajtjes.

### 1.1.1 STRUKTURIMI i TERRITORIT SIPAS PESE SISTEMEVE TERRITORIALE

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë bazohet në Ligjin Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" e ndryshuar. Sipas këtij kuadri ligjor referues, është bërë strukturimi i të gjithë territorit të kësaj Njësie Vendore, i cili nënkupton ndarjen dhe klasifikimin e territorit në 4 nivele hierarkie, të renditura në:

- Sistemet territoriale;
- Zonat;
- Njësi Strukturore
- Nën-Njësi Strukturore, të konceptuara edhe si Zona unike Zhvillimore

**Sistemi territorial** është bashkësia e një sërë hapësirave apo rrjeteve, me karakteristika të ngjashme për nga funksioni dhe treguesit, të cilët formojnë një tërësi të dallueshme në hartën e një Njësie Vendore. Në këtë kontekst planifikimi, të specifikuar në VKM Nr. 686, datë 22/11/2017, i ndryshuar territori i Bashkisë Tepelenë është analizuar dhe strukturar sipas 5 (pesë) sistemeve territoriale, me kodifikimin përkatës:

a) UB - Sistemi Urban;
b) IN - Sistemi Infrastrukturor;
c) B - Sistemi Bujqësor;
ç) N - Sistemi Natyror;
d) U - Sistemi Ujor;

**Sistemi urban (UB)** - formohet nga tërësia e vendbanimeve urbane dhe rurale, territoreve të ndërtuara ku kryhen funksione dhe aktivitete social-ekonomike. Sistemi urban kufizohet nga vija e gjelbër. Nëpërmjet analizës së karakteristikave të komponentëve të këtij sistemi është mundësuar analiza dhe vlerësimi i një fizionomie të sistemit urban të Bashkisë Tepelenë, duke

specifikuar morfologjinë, tipologjinë, dendësitë, koefiçientët ekzistues, etj. E krahasuar me sistemet e tjera territoriale, nëpermjet trajtimit të prognozave dhe propozimeve strategjike të zhvillimit, në Planin e Përgjithshëm Vendor janë përcaktuar ndryshimet përkatëse të hapësirave të këtij sistemi, si në qytet Tepelenë ashtu edhe në të gjitha qendrat rurale të kësaj Njësie Vendore.



*fig 4 – pamje panoramike e pozicionimit të qytetit të Tepelenës, me malin e Golikut në sfond.*

**Sistemi infrastrukturor (IN)** - formohet nga tërësia e rrjeteve dhe strukturave që mbështetin dhe mundësojnë aktivitetin njerëzor, duke përfshirë akset rrugore të komunikimit, transportin publik, rrjetet e shpërndarjes së energjisë, rrjetet e komunikimit digital dhe elektronik, linjat e furnizimit dhe shkarkimeve të ujit si dhe menaxhimin e mbetjeve. Shtrirja dhe mirë-funksionimi i këtyre rrjeteve është esenciale për një Bashki apo territor të dhënë, pasi garanton ekzistencën dhe vetë funksionimin e sistemit urban apo dhe sistemeve të tjera.

**Sistemi bujqësor (B)** - përfshin tërësinë e terreneve bujqësore, të kultivuara me bimët e arave, pemishtet, ullishtet dhe vreshtat, bimët medicinale, foragjerët, etj. Gjithashtu në këtë sistem përfshihen edhe infrastrukturat bujqësore si rrjetet e vaditjes, kullimit, rezervuaret, etj si dhe të gjitha strukturat në funksion të aktivitetit bujqësor. Ky sistem është rezultati i ndërveprimit në kohë të aktiviteteve njerëzore për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor. Për shkak të rolit të tyre prodhues, shtrirjes dhe sipërfaqes, terrenet e përfshira në këtë sistem janë evidentuar si një komponent tepër me rëndësi për ekonominë e Bashkisë Tepelenë. Në kontekstin aktual të zhvillimit njerëzor si dhe respektimit të burimeve ekonomike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar ka sanksionuar në mënyrë eksplicite ruajtjen e fondit të tokës bujqësore, duke ndaluar kategorikisht transformimin e saj në përdorime të tjera (brenda sistemeve të tjera territoriale).

**Sistemi natyror (N)** përbëhet nga tërësia e tokave dhe peizazheve natyrore, korridoreve ekologjike lidhëse të tyre, si dhe infrastruktura e strukturat në funksion të aktivitetit natyror. Në përgjithësi, ky sistem përfshin ato hapësira në të cilat përjashtohen zhvillimet urbane, si dhe përshkohen nga një nivel i kufizuar i sistemit infrastrukturor. në pjesën dërrmuese të tyre shërbejnë për qëllime argëtimi dhe rekreacioni, duke përbërë kështu një potencial të madh për zhvillimin e turizmit natyror dhe turizmit të aventurës, jo vetëm në Bashkinë Tepelenë por edhe në të gjitha njësitë e tjera vendore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
ARCHISPACE STUDIO
Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
archispace.studio@archi-space.com



*fig 5 – Pamje e rezervuarit të Turanit, pjesë e sistemit bujqësor të Bashkisë Tepelenë*



*fig 6 – Pamje natyrore e lugines së përroit të Turanit, pranë fshatit Veliqot*

**Sistemi ujor (U)** formohet nga tërësia e trupave ujorë, burimeve nëntokësore e mbitokësore ujore dhe ligatinave. I kombinuar me karakteristikat e Sistemit Bujqësor, uji konsiston në një potencial me rëndësi madhore për zhvillimin perspektiv të një Njësie Vendore apo rajoni të dhënë. Për vetë natyrën e tyre fluide, trupat ujore ofrojnë gjithashtu hapësira lidhëse duke përmirësuar komunikimin midis terreneve të ndryshme. Një sistem urban i kombinuar me elementë karakteristikë të sistemit ujor prezanton një potencial të madh në kontekstin e zhvillimit të degëve të energjisë, turizmit natyror apo edhe vetë vlerave peisazhistike. E trajtuar në një mënyrë inteligjente, sipërfaqja ujore mund të harmonizohet mjaft mirë me sistemin urban, duke rritur vlerat dhe potencialin e të dyjave.



*fig 7 – Pamje e lumit Vjose poshte qytetit Tepelenë, perberesi kryesor i Sistemit Territorial Ujor*

Referuar të dhënave të publikuara, Bashkia Tepelenë ka një sipërfaqe prej 447,31 km², ndërkohe në baze te llogaritjeve te kryera në sistemin hartografik te Planit te Përgjithshëm Vendor, sipërfaqja e kesaj Njësie Vendore e kombinuar në Sisteme dhe Njësi Strukturore rezulton në 47212,10 Ha, pra rreth 472 km² e cila dominohet nga territoret e klasifikuara në Sistemin Natyror. Sipas bilancit të realizuar gjatë Analizës së Përgjithshme të Territorit, Sistemi Natyror përbën rreth 90% të sipërfaqes totale të kësaj Njësie Vendore, ndërkohë që më pas rradhiten territoret brenda Sistemit Bujqësor, me 4.6% të territorit. Përsa i përket Sistemit Ujor, territori i Bashkisë Tepelenë përshkohet nga Lumi Vjosa si elementi ujor dominues, ndërkohë që një tjetër korridor i rëndësishëm ujor është i Bënçës, që buron nga zona malore e Kurveleshit, por edhe nga një numër përrenjsh tributarë. Në total, Sistemi Ujor në Bashkinë Tepelenë përbën 2.24% të territorit të Bashkisë. Sistemi Urban, i karakterizuar nga një skemë tipike rurale, zë rreth 1.78% të totalit të sipërfaqes, ndërsa Sistemi Infrastrukturor do të zëre një sipërfaqe prej 0.58%.

| **Sistemet** | **Sipërfaqja ekzistuese (ha)** | **Përqindja (%)** | **Sipërfaqja e propozuar (ha)** | **Përqindja (%)** | **Ndryshimet në përqindje të Sistemeve** |
|---|---|---|---|---|---|
| (B) Bujqesor | 2051.76 | 4.59 | 2734.13 | 6.11 | 1.52 |
| (IN) Infrastrukturor | 258.57 | 0.58 | 112.62 | 0.25 | -0.33 |
| (N) Natyror | 40623.45 | 90.81 | 39929.96 | 89.26 | -1.55 |
| (U) Ujor | 1002.61 | 2.24 | 1254.45 | 2.8 | 0.56 |
| (UB) Urban | 795.56 | 1.78 | 700.79 | 1.58 | -0.2 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Total** | **44731.95** | **100** | **44731.95** | **100** | **0** |

*Fig. 1 – Tabela e bilancit të Sistemeve Territoriale dhe ndryshimet në vlera*

Ndërkohë, duhet theksuar së dallimi i territoreve që i përkasin sistemeve të ndryshme në Bashkinë Tepelenë është relativisht i vështirë. Zgjerimi gradual dhe kryesisht i paplanifikuar i hapësirave urbane ka ndikuar në zënien e terreneve bujqësore, si dhe parcelizimin e një pjesë të tyre në sipërfaqe shumë të vogla. Kjo dinamike, e evidentuar në thuajse të gjitha Njësitë Vendore në Shqipëri, ka bërë që kufiri ndarës midis sistemit urban dhe atij bujqësor të jetë relativisht i vështirë për tu përcaktuar. Në një pjesë të konsiderueshme të territoreve bujqësore të Bashkisë Tepelenë identifikohen situata të kombinimit të banesave individuale të ndërtuara rishtazi, të cilat rrethohen nga parcela bujqësore për përmasa të vogla dhe të mesme. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kufirin midis terreneve natyrore dhe urbane, ku ndërtimet e reja, të instaluara në mënyrë jo të planifikuar, kanë sfumuar kufirin dallues midis territoreve të këtyre dy sistemeve. Kjo situatë është e dukshme në zonat e ulëta rurale, sidomos ato pranë aksit Tepelenë Memaliaj.




| Sistemet | Sipërfaqja ekzistuese (ha) | Përqindja (%) | Sipërfaqja e propozuar (ha) | Përqindja (%) | Ndryshimet në përqindje të Sistemeve |
|---|---|---|---|---|---|
| (B) Bujqesor | 2051.78 | 4.59 | 2734.13 | 6.11 | 1.52 |
| (IN) Infrastrukturore | 258.57 | 0.58 | 112.62 | 0.25 | -0.33 |
| (N) Natyror | 40673.45 | 90.83 | 39929.96 | 89.26 | -1.55 |
| (U) Ujor | 1002.61 | 2.24 | 1254.45 | 2.8 | 0.56 |
| (UB) Urban | 795.56 | 1.78 | 700.79 | 1.58 | -0.2 |
| **Total** | **44731.95** | **100** | **44731.95** | **100** | **0** |

*fig 8 - Harta e Konvertimit të Sistemeve Territoriale të Bashkisë Tepelenë, sipas Strategjisë Territoriale*

Megjithatë, në rastin e Bashkisë Tepelenë, e karakterizuar nga parametra të ulët të zhvillimit social-ekonomik si dhe e përballur me një ritëm shqetësues migrimi të brendshëm të popullsisë, intensiteti i konvertimit të territoreve brenda sistemeve të ndryshme ka qënë mjaft i ulët, krahasuar kjo me Bashkitë e Shqipërisë qendrore dhe në Ultësirën Perëndimore. Bashkia Tepelenë është një Njësi Vendore me një sipërfaqe të konsiderueshme territoriale, e cila fatkeqësisht po përjeton një rënie të vazhdueshme të popullsisë së saj, tendencë kjo e evidentuar jo vetëm në fshatrat periferike të Kurveleshit apo të Lopësit, por edhe në qendrat e vogla të banuara përgjatë aksit kryesor interurban Levan Tepelenë Gjirokastër. Kjo tkurrje demografike ka sjellë në mënyrë të pashmangshme edhe rënien në nivele minimale të iniciativave apo investimeve private që kanë ndikim në transformimet territoriale.

Pikërisht për këtë arsye, ndërhyrjet strategjike të propozuara në dokumentin e Strategjisë Territoriale të Bashkisë Tepelenë, janë orientuar sipas synimit final të rivitalizimit të kontekstit ekzistues social-ekonomik të zhvillimit në këtë Njësi Vendore. Në këtë këndveshtrim, duke iu

referuar përfundimeve të analizës territoriale, dhe konkretisht marrëdhënies midis sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Bashkisë me gjurmën e vogël urbane që ka kjo Njësi si dhe domosdoshmërisë së rivitalizimit të kontekstit aktual social ekonomik, është arritur në përfundimin që propozimet strategjike në këtë Njësi Vendore nuk duhet të gjejnë kufizim në aspektin e shtrirjes së tyre hapësinore apo nevojës për transformimin e territoreve sipas klasifikimit të sistemeve.

Propozimet transfomuese të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë, të harmonizuara me propozimet e Strategjisë Territoriale, synojnë konsolidimin e gjurmës ekzistuese të territoreve të klasifikuara brenda Sistemit Urban. E përballur prej shumë vitesh me largimin e popullsisë vendase, qendra urbane e kësaj Njësie Vendore si dhe fshatrat disponojnë hapësira të mjaftueshme urbane për të akomoduar një rritje potenciale në perspektivë. Struktura ekzistuese urbane e qendrave të Bashkisë Tepelenë karakterizohet nga ekzistenca e hapësirave të lira si dhe nga një dendësi e ulët dhe shumë e ulët, sidomos në fshatrat periferikë të saj, ku evidentohet dukshëm edhe fenomeni i braktisjes së njësive të banimit.

Me vlerësimin e kësaj dinamike, Plani i Përgjithshëm Vendor nuk e gjykon të nevojshëm transfomimin masiv të territoreve natyrore apo bujqësore në favor të krijimit të territoreve të reja të banimit. Sipas këtij përfundimi, e gjithë rritja urbane e pritshme në periudhën e analizuar të Planit, do të mund të akomodohet në territoret ekzistuese urbane të Bashkisë Tepelenë, pa qënë nevoja për konvertim të territoreve të Sistemeve të tjera Bujqësore apo Natyrore. Ndërkohë, në vendbanimet kryesore është domosdoshmëri plotësimi i zonave me shërbimeve tregtare, aktivitete dhe shërbime sociale.

Ndryshimet territoriale të Sistemeve të prezantuara në dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor evidentohen si rrjedhojë e dy proceseve specifike të ndërhyrjes, dhe konkretisht:

**1. Konfigurimi i Njësive Strukturore**

E gjithë hapësira e Bashkisë Tepelenë është analizuar në mënyrë të detajuar sipas linjave të territorit, duke identifikuar një numër të madh parcelash të cilat plotësojnë kriteret për përcaktimin e Njësive Strukturore. Në total, i gjithë territori i Bashkisë **është ndarë në 540 Njësi Strukturore**, të cilat përcaktojnë dhe instrumentin bazë për kontrollin dhe zhvillimin e territorit në periudhën e zbatimit të Planit. Gjatë këtij procesi, një kujdes i madh është treguar që të mos mbivendosen apo përfshihen brenda një Njësie, territore të klasifikuara sipas kategorive të përdorimit në Sisteme të ndryshme.



*fig 9 – Fragment i hartes së Njësive Strukturore në nivel qyteti*

Gjatë këtij procesi, konvertimet e territoreve kanë ardhur si pasojë kryesisht e rakordimeve të kufijve të sistemit të Njësive Strukturore, duke pasur parasysh që:

- Në Njësitë Strukturore brenda Sistemit Urban të krijohej një hapësirë e nevojshme për konsolidimin e vendbanimeve apo të shërbimeve, duke përfshirë brenda njësise edhe ato hapësira bosh të nevojshme për akomodimin në perspektivë të hapësirave publike, hapësirave të mundshme për dendësim të banesave, ndërtimin e rrugëve të brendshme, hapësirave sportive, etj.
- Njësitë Strukturore brenda Sistemeve Natyrore dhe Bujqësore kanë ruajtur gjurmët ekzistuese të terrenit. Ashtu siç është evidentuar edhe në Analizën e Përgjithshme të Territorit si edhe në dokumentin e Strategjisë Territoriale, territoret që përbëjnë këto dy sisteme kanë qënë gjithnjë në një marrëdhenie "shkëmbimi" me njëra tjetrën, ku territore të Sistemit Natyror janë transformuar gradualisht në territore që tashmë klasifikohen brenda Sistemit Bujqësor. Konkretisht bëhet fjalë për konvertimin e terreneve natyrore me shkurre apo pyje në plantacione të reja me kultura shumëvjeçare, proces ky që evidentohet thuajse në të gjithë territorin e Bashkisë. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë ka përcaktuar kufijtë e këtyre Njësive Strukturore duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të linjave të territorit, duke bërë që edhe një pjesë e ish zonave natyrore tashmë të klasifikohen në territore të Sistemit Bujqësor.

**2. Propozimet e Projekteve Strategjike**

Në kontestin ekzistues, pjesa më e madhe e rritjes së territoreve të Sistemit Urban në Bashkinë Tepelenë vjen si pasojë e transformimit të zonës veriore të qytetit, e cila kthehet në një zonë me prioritet zhvillimi urban, ekonomik dhe social për të gjithë territorin e Bashkisë. Kjo hapësirë është konceptuar të transformohet në zonën kryesore të rritjes urbane dhe ekonomike të Bashkisë Tepelenë. Përveç zonave të reja urbane, në këtë hapësirë, dokumenti i Strategjisë Territoriale propozon:

- Ndërtimin dhe vënien në shfrytëzim të strukturave të magazinimit dhe përpunimit të produkteve blegtorale;
- Ndërtimin e zonës së magazinimit dhe përpunimit të bimëve medicinale;
- Ndërtimin e thertores së re të Tepelenës;
- Ndërtimi i stacionit multimodal të transportit për qytetin e Tepelenës: Propozohet të ndërtohet në pjesën veriore të qytetit, duke akomoduar hapësirat e nevojshme edhe për ndërtimin në perspektivë të stacionin e trenit.
- Ndërtimi i impiantit qëndror të depurimit të ujërave të zeza të qytetit të Tepelenës. Ky projekt transfomon një pjesë të territoreve bujqësore në sistemin e klasifikimit të infrastrukturës.

E gjithë kjo, do të paraprihet nga hartimi i Planeve të Detajuara Vendore, duke ndërthurur në këtë mënyrë strukturimin e hapësirave urbane me rrjetet e infrastrukturave dhe të shërbimeve.

Ndërkohë, ndërhyrje të tjera që kanë ndikim në transformimin e territoreve sipas klasifikimit të Sistemeve Territoriale janë:

- **Zhvillimi i tre fermave blegorale pilot midis fshatrave Progonat dhe Nivicë (Kurvelesh), Dhëmblan dhe Sinanaj (Lopës), Dukaj – Turan (Qender);** Projekti ka për qëllim që të mundësojë krijimin e strukturave të specializuara për mbarë-shtimin e bagëtive në këto territore, duke u bazuar në traditën ekzistuese blegtorale të zonave. Ky propozim përbën një nga elementët e fortë të propozimeve lidhur me zhvillimin ekonomik të Bashkisë Tepelenë, me ndikim si në sektorin e blegtorisë ashtu edhe në agroturizem. Projekti ndikon në transfomimin e disa hapësirave natyrore në territore të klasifikuara në sistemin bujqësor.
- Ndërtimi i urave të reja të Dragotit, Leklit, Dorëzit si dhe urës që lidh fshatrat Sinanaj dhe Dorëz. Këto projekte kanë ndikim në transformimin e territoreve të klasifikuara në Sistemin Natyror dhe Bujqësor në territore që përfshihen në Sistemin territorial të Infrastrukturës.



*fig 10 - Harta e listes së plote të Projekteve Strategjike të zhvillimit të Bashkisë Tepelenë*

- Ndërtimi i impianteve septike të trajtimit teknologjik të ujërave të zeza për fshatrat e Kurveleshit, fshatin Dragot dhe fshatin Bënçë. Përmes këtyre propozimeve kemi transformim të territoreve natyrore dhe bujqësore në territore të klasifikuara në Sistemin territorial të Infrastrukturës.
- Ndërtimi i pesë pikave tranzit të depozitimit të mbetjeve në pllajën e Kurveleshit, dhe konkretisht midis fshatrave Progonat dhe Gusmar, midis fshatrave Dragot dhe Luadh, midis fshatrave Dukaj dhe Salari, pranë urës së Leklit si dhe në pllajën e Lopësit. Këto propozime nënkuptojnë transformimin e territoreve natyrore në territore të klasifikuara në Sistemin territorial të Infrastrukturës.

### 1.1.2 STRUKTURIMI I TERRITORIT NË ZONA DHE NJËSI STRUKTURORE

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë, për qëllime planifikimi dhe zhvillimi e koncepton territorin të ndarë në Zona dhe Njësi Strukturore realizuar konform Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar si dhe VKM Nr.408 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" e ndryshuar. Konkretisht,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
Architecture - Interior Design - Urban Planning - Architectural Restoration
ARCHISPACE STUDIO

përcakimet ligjore për këto kategori të kalisifikimit të territorit, në mënyrë të përmbledhur përcaktojnë:

**Zona**

- "Zona" është pjesë përbërëse e një sistemi territorial të caktuar, që detajohet në nivelin e kategorisë së përdorimit të tokës.
- Kufijtë e zonave përcaktohen gjatë hartimit të dokumentit të planifikimit, në mënyrë të tillë që një zonë:
  - të ketë një kufi të vetëm e të mbyllur dhe të identifikohet në mënyrë unike në territor;
  - të respektojë zonime të veçanta të detyrueshme nga legjislacioni sektorial (zonat e mbrojtura mjedisore, kulturore etj.), sipas rastit.
- Zona mund të përmbajë disa kategori përdorimi toke, pjesë të një sistemi të vetëm territorial

Në bazë të analizës së gjendjes ekzistuese dhe të propozimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë, në territorin e kësaj Njësie Vendore janë identifikuar 258 Zona specifike.

**Njësia Strukturore**

- Njësia strukturore është pjesë përbërëse e Zonës që detajohet në nivelin e nënkategorisë së përdorimit të tokës
- Kufijtë e Njësive Strukturore përcaktohen gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, në mënyrë të tillë që çdo njësi:
  - të ketë një kufi të vetëm e të mbyllur dhe të identifikohet në mënyrë unike në territor;
  - të mos ketë përdorime të papërputhshme dhe me ndikime negative mes tyre;
  - të respektojë zonime të veçanta të detyrueshme nga legjislacioni sektorial (zonat e mbrojtura mjedisore, kulturore etj.), sipas rastit;
  - të kufizohet nga elemente fizike territoriale të dallueshme, si rrugë, linja hekurudhore, breza mbrojtës dhe sanitarë, brigje ujore, përrenj, lumenj etj.
- Njësia mund të përmbajë disa kategori /nënkategori përdorimi toke, pjesë të një sistemi të vetëm territorial




*fig 11 – Harta e ndarjes së territorit në Zona dhe Njësi Strukturore – Bashkia Tepelenë*

Për secilën nga këto Njësi, në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë janë specifikuar kriteret dhe kushtet e zhvillimit. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore, konturimi i Njësive Strukturore në Bashkinë Tepelenë i është referuar një serie kriteresh specifike, duke pasur si qellim garantimin e kompaktësimit dhe njëtrajtshmërinë e tipologjisë hapësinore ekzistuese dhe atë të propozuar.

Duhet nënvizuar fakti së jo të gjitha zonat (Njësitë) e përcaktuara në Bashkinë Tepelenë do të jenë objekt i hartimit të Planeve të detajuara Vendore. Plani ka përcaktuar Njësitë Strukturore që do të jenë objekt i PDV've, duke iu referuar plotësimit të të paktën njërit prej kritereve të paraqitura në vazhdim;

- Kufijtë e Njësisë Strukturore të konturojnë zona urbane që paraqesin nevoja emergjente në aspektin e rikualifikimit të hapësirave të brendshme,
- Terrenet që kanë nevojë për zgjerim dhe përmirësim të infrastrukturave rrugore, duke nënkuptuar ndryshimin e destinacionit për pjesë të hapësirës publike apo private.
- Zonat që do të akomodojnë përdorime të rëndësishme për Bashkinë, si zona ekonomike të reja, hapësira turistike të dedikuara, njësi të reja shërbimi, hapësira parkimi, etj.
- Prekin njësi me zhvillim të lartë, në presion zhvillimi, zona të reja të pazhvilluara
- Prekin zona ku parashikohet ndryshimi i përdorimit të lejuar të tokës, psh, nga natyror në urban, apo nga kategori të ndryshme të një sistemi.

### 1.1.3 PROPOZIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS SIPAS KATEGORIVE, NËNKATEGORIVE DHE FUNKSIONEVE

Pas analizës së përgjithshme dhe Strategjisë Territoriale, zonimi i propozuar i territorit përbën edhe komponentin më të rëndësishëm të procesit të planifikimit të Bashkisë Tepelenë. Harta e propozuar e përdorimit të tokës është komponenti bazë në të cilën pasqyrohet strukturimi i territorit në zona dhe njësi strukturore, të cilat përshkallëzohen në nivel kategorie, nënkategorie dhe funksioni. Për çdo Njësi të propozuar, pasqyrohen parimet e zhvillimit, të cilat pasqyrohen në mënyrë të detajuar në formën e Rregullores së Planit. Ky proces strategjik mjaft i rëndësishëm është realizuar duke u bazuar në disa parime e praktika konform kuadrit rregullator, normave si dhe kufizimeve kryesore në nivel kombëtar.

**Parimi i qëndrueshmërisë** – Parimet e procesit të zonimit marrin në konsideratë një tërësi karakteristikash si zhvillimi historik i një hapësire të caktuar, si dhe specifikat gjeografike dhe morfologjike të territorit të saj. Gjithashtu është marrë në konsideratë principi i qëndrueshmërisë i miratuar në nivel global e cila ka një konsideratë të veçantë në udhëzimet e politikave kombëtare dhe praktikave të suksesshme të ndjekura në vendet evropiane. Zbatimi i këtij principi synon drejt një zhvillimi të qëndrueshëm duke lënë hapësira për rritjen potenciale të zhvillimit, pa kompromentuar qëndrueshmërinë e burimeve natyrore në planin

afatgjatë. Edhe në rastin e Bashkisë Tepelenë, vëmendje të vecantë i është kushtuar vlerësimit të zonave urbane e rurale potenciale të zgjerimit, të kombinuar me premisat ekzistuese të rritjes demografike, sociale si dhe mundësisë së kësaj Njësie Vendore për investime kapitale.

**Parimi i kufizimeve territoriale** – përpara nisjes së klasifikimit të territorit sipas kategorive dhe nën-kategorive të përdorimit, është proceduar me përcaktimin e gjurmëve të territorit, duke iu refueruar tipologjive gjeografike ekzistuese, (male, kodra, fusha, lumenj, shpate, etj). Kjo është gjykuar si një metodologji shumë praktike në procesin e njohjes dhe konturimit paraprak të territorit, e kombinuar me analizën e shpërndarjes së njollave urbane, si edhe të zonave të reja të zhvillimit. Në këtë fazë të procesit, duke analizuar edhe databazën e të dhënave dhe studimeve ekzistuese të Bashkisë Tepelenë, është bërë e mundur përcaktimi i elementëve përjashtimore të zhvillimit në këtë Njësi Vendor, të përfshira në konceptin e zonave të mbrojtura natyrore, sipërfaqet e shpateve të pjerrëta dhe me tendencë erozioni, zonat e prirura për përmbytje, zonat tektonike, etj. Në mënyrë të ngjashme janë vendosur një sërë kriteresh për zonat e mbrojtjes mjedisore dhe peizazheve, të cilat marrin në konsideratë parametrat topografikë, të tilla si mbrojtja e majave të kodrave, grykave dhe luginave, brigjeve të lumenjve dhe trupave ujore, etj.

**Klasifikimi i formave bazë të përdorimit të tokës** - Nëpërmjet këtij klasifikimi të parë, duke u bazuar në metodologjinë zyrtare të organizimit të hapësirës në Sisteme Territoriale, është bërë i mundur evidentimi i qartë i hapësirave urbane dhe atyre jo-urbane në Bashkinë Tepelenë, për të vazhduar më pas me konturimin e hapësirës së përgjithshme bujqësore, terreneve natyrore si dhe sipërfaqes ujore. Për sa i përket elementëve të Sistemit Infrastrukturor, është proceduar kryesisht me saktësimin e rrjetit rrugor, pasi pjesa më e madhe e rrjeteve të tjera sekondare të infrastrukturave përshkojnë pikerisht linjat e rrjetit rrugor.

**Klasifikimi i kategorive dytësore të përdorimit të tokës -** Pas përcaktimit të përdorimeve bazë të hapësirës administrative të Bashkisë Tepelenë, në funksion të evidentimit të 5 Sistemeve Territoriale, është vazhduar me detajimin e zonave të ndryshme, duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta brenda një kategorie bazë të përdorimit kryesor të tokës. Kjo përfshin studimin e ndryshëm për zona të ndryshme, në të cilin bëhet dallimi mes zonave të banuara dhe zonave me karakter të përzier (banim i kombinuar me veprimtari të tjera), si dhe nivelet e ndryshme të densitetit. Analiza është bërë në mënyrë të ngjashme, edhe pse me më pak hollësi për kategoritë jo-urbane të tokës, sidomos në zonat që janë identifikuar si zona zhvillimi nga vizioni hapësinor.

**Ndërhyrjet në Sistemin Infrastrukturor** – Kategorizimi i rrjetit ekzistues dhe atij të propozuar rrugor për çdo zonë të Bashkisë Tepelenë, u bë përgjatë procesit të analizës dhe zonimit të formave të shfrytëzimit të tokës. Nën-ndarjet hapësinore të zonave të zhvillimit urban janë kryer në respektim të hierarkisë së rrjetit rrugor. Gjatë këtij procesi është pasur parasysh që

zonat homogjene të banimit (lagjet e qytetit Tepelenë apo njësive urbane të vogla) si dhe zonat e vogla periferike të banimit, duhet të përcaktohen dhe jo të përshkohen nga arteriet rrugore urbane (kryesore dhe dytësore), dhe ato ndër-urbane (kombëtare ose rajonale). Gjithashtu me kujdes është analizuar forma e artikullimit të trafikut automobilistik në brendësi të zonave të banimit.

**Ndërhyrjet në Sistemin Natyror** – Kategorizimi dhe nënkategorizimi i përdorimit të tokës në Bashkinë Tepelenë ka ndjekur parimin e ruajtjes konservimit dhe ripërtëritjes së pasurisë natyrore, duke treguar kujdes të vecantë në ruajtjen e territoreve që i përkasin këtij sistemi. Ky proces është bazuar në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti, janë trajtuar zonat e mbrojtura natyrore sipas Ligji Nr. 81/2017 **"Për Zonat E Mbrojtura"**, për identifikimin e zonave që duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave, objektet e shërbimeve, turizmit apo infrastrukturave të llojeve të ndryshme.

**Ndërhyrjet në Sistemin Bujqësor** – Nëndarjet bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore në lidhje me tokat bujqësore. Në këtë mënyrë është proceduar me përcaktimin e hapësirave bujqësore me përdorime kulturash të përhershme, kultura sezonale si dhe tokë djerrë. Ky përcaktim ka një rëndësi të madhe në kontekstin e Bashkisë Tepelenë, për shkak të rëndësisë së tokës bujqësore në zhvillimin ekonomik të Bashkisë, por edhe për ndryshimin e kategorive të përdorimit nga toka me kultivim kulturash sezonale në pemëtore dhe ullishte. Një element i rëndësishëm i marrë në konsideratë në këtë rast është mbrojtja dhe promovimi i peisazheve të tradites bujqësore dhe blegtorale, të cilat pasqyrojnë traditat e zonës së Tepelenës.

**Ndërhyrjet në Sistemin Ujor** – Bazuar në përcaktimet e kuadrit rregullator përkatës, dhe konkretisht Ligjit Nr 111/2012 *"Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"* i ndryshuar, është bërë konturimi i të gjithë trupave ujore të Bashkisë Tepelenë dhe gjithashtu sipas VKM Nr. 748, datë 1.12.2022 *"Përcaktimin e Zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore"*, është përcaktuar zona e bregut të burimit ujor. Plani është përditësuar me kushtëzimet e Vendimit Nr.155, datë 13.3.2023 *"Për shpalljen e ekosistemit natyror te lumit Vjosa Park Kombetar, kategoria II"*. Ky Sistem ka një rëndësi të konsiderueshme për Bashkinë, pasi në territorin e saj shtrihen rrjedha të rëndësishme ujore siç janë lumi Drinos, Vjosë, Bënçë dhe disa përrenj tributarë. Lidhur me këtë komponent mjaft të rëndësishëm territorial, Konsulenti është bazuar në kuadrin rregullator ekzistues të trupave ujorë, dhe konkretisht në Ligjin nr. 111/2012, **"Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"** i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 73, dt. 07.02.2018, **"Strategjia Kombëtare e Meaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore"**.

**Karakteristikat specifike të Zhvillimit Urban të Zonave të Banuara** - Vlerësimi i karakteristikave hapësinore urbane të Bashkisë Tepelenë ka marrë në konsideratë, në mënyrë të veçantë fazat dhe momentet specifike të zhvillimit të kësaj Njësie Vendore, si dhe të zonave

të ndryshme të saj, të cilat kanë formësuar më pas edhe karakterin tipik të peisazhit urban. Një element kyç në këtë analizë ka qënë vlerësimi i strukturës së qytetit të Tepelenës, si qendër urbane relativisht e re, me kufij fizike dhe morfologji hapësinore të dallueshme dhe pak të dëmtuar nga ndërtimet e reja apo ato informale.

Qyteti disponon një tipologji të përzier urbane, me banesa kolektive 2-3 deri në 5 kate, me përmasa relativisht të vogla, në pjesën më të madhe të tyre të ndërtuara me strukturë me mure mbajtëse. Në periudhën para viteve 1990 vetëm 12,5% e territorit të tanishëm të Bashkisë së Tepelenë ishte e urbanizuar (duke përfshirë këtu vendbanimet dhe zonat industriale të ndërtuara në vitet '50-'70. Qendra e urbanizimit ishte qyteti i Tepelenë, por edhe tërësia e fshatrave ekzistuese edhe sot me karakter blegtoral bujqësor e natyror dhe shtrirje lineare ose në përputhje me terrenin. Deri në vitin 2007 urbanizimi arriti masën 18.25%, duke shënuar kështu një rritje të vendbanimeve me 91.98% (afërsisht 2 herë). Zgjerimin më të madh e ka pësuar qyteti Tepelenë. Duke qenë planifikuar që në fillim si qytet me kufi të përcaktuar mirë, Tepelenë ka pësuar një rritje minimale prej 2% gjatë kësaj periudhe.



*fig 12 – Pamje e qytetit të Tepelenës, dominuar nga banesat kolektive 4-5 kateshe*

Tipologjitë më të përhapura hapësinore të shtrirjes ishin: vila me densitet të ulët në toka bujqësore periferike të vendbanimeve ekzistuese, si dhe vila me densitet shumë të ulët në strukturë pikësore. Ndërkaq, në periudhën 2007-2013, rritja hapësinore vjetore në nivel Bashkie ka ritëm shumë të ulët, rreth 0.44% në vit. Kjo vjen në linjë me tendencat migruese të popullsisë dhe tkurrjen e vendbanimeve rurale. Tipologjitë e këtyre lloj vendbanimesh janë kryesisht nukleare, të veçuara, me ndërtime të tipit vilë me densitet të ulët.

Nga pikëpamja e tipologjisë së ndërtimit apo stilit arkitekturor nuk evidentohen elementë të rëndësishëm. Një pjesë e mirë e banesave të vjetra janë me mure guri ndërkohë që objektet

më të reja ndjekin tipin e godinave të vogla individuale të pas viteve 90, me strukturë të lehtë betonarmeje dhe mure tulle.

Ndërkohë, përveç analizës së qytetit, Plani ka analizuar elementët dalluese kryesore të zonave rurale të Bashkisë Tepelenë, duke evidentuar tre veçanti të dallueshme:

1. Në territorin e Bashkisë Tepelenë evidentohen disa fshatra, të cilët ende paraqesin strukturë urbane të dallueshme, megjithë ritmin e lartë të migrmit të popullsisë vendase. Këtu mund të përmendim Dragotin, Progonatin si dhe fshatin Veliqot, pranë qytetit. Këto fshatra kanë një morfologji hapësinore të dallueshme, ku evidentohen qartë hapësirat e banimit nga hapesirat publike si dhe akset e komunikimit. Ndërhyrja urbane në këto tre fshatra duhet të bazohet në konsolidimin e morfologjise ekzistuese si dhe në përmirësimin e hapësirave të brendshme publike
2. Zona rurale me rënie të shpejtë demografike, ku mund të përmenden fshatrat e Lopësit, Beçishtin, Leklin, Lekdushin, Luzatin, Hormovën, Mezhgoranin, Dukaj, etj. Këto fshatra dallohen për shkak të rënies thuajse në nivele minimiale të aktivitetit social-ekonomik, nga objekte banimi të braktisura dhe hapësira publike tërësisht të lëna pas dore. Fatkeqësisht, ky largim i popullsisë së fshatrave periferike nuk ka adresuar qytetin Tepelenë por qytetet kryesore të Shqipërisë dhe të Rajonit Jug-Perëndimor.
3. Fshatrat Peshtan dhe Nivicë – këto dy fshatra kanë pasur mundësinë të përjetojnë një rivitalizim të një pjesë të hapësirave të brendshme, në kuader të zbatimit të Programit Kombëtar "Akademia 100 Fshatrat", nëpërmjet të cilit janë rikonstruktuar disa godina qëndrore të fshatrave, qendrat si dhe sheshe publike. Këto dy ndërhyrje duhet të merren në konsiderate si shembuj konkretë që mund të replikohen edhe në zonat e tjera rurale të Bashkisë Tepelenë.

Propozimet e Planit të Përgjithshëm Rregullues lidhur me format e riorganizimit të territoreve urbane sipas kategorive, përcaktimi i formave të ndërhyrjes, zonave të zhvillimeve të reja si dhe të zonave të reja të zgjerimit urban, ekonomik dhe social, është bazuar në një seri principesh specifike, duke marrë në konsideratë kuadrin rregullator ekzistues si dhe praktikat më të mira të vlerës që mbart, më kryesoret prej të cilave janë të listuara si më poshtë:

**Policentrizmi.** Bazuar në përcaktimet e Planit të Përgjithshem Kombëtar (PPK), zonimi i propozuar është fokusuar në krijimin e nyjeve të rëndësishme urbane në territorin e Bashkisë Tepelenë, të cilat do të shërbejnë si magnet dhe katalizator i rritjes dhe jetës ekonomike dhe sociale të komunitetit vendas. Në këtë mënyrë, propozimet e zonimit synojnë të kufizojnë apo të disiplinojnë zhvillimet sporadike, sidomos në zonat periferike të Bashkisë. Në kontekstin e një njësie vendore me një shtrirje të konsiderueshme si Bashkia Tepelenë, me një numër të madh hapësirash të banuara të shpërndara në të gjtihë territorin e saj, nga ana e Konsulentit është gjykuar e pamundur që të pretendohet një strukture e qëndërzuar në një qendër të vetme (qytet Tepelenë). Një propozim i tillë do të kishte një ndikim negativ në

braktisjen përfundimtare të zonave periferike. Ndërkohë **Policentrizmi**, si element ndërhyres dhe organizues, përputhet më mirë me konfiguracionin ekzistues urban të Bashkisë Tepelenë, duke krijuar në këtë mënyrë qendra të vogla të rikualifikuara, të cilat lidhen më mirë dhe i shërbejnë më mirë zonave urbane (fshatrave) periferike.

**Fuqizimi i potencialit bujqësor dhe blegtoral që ka Bashkia Tepelenë** – lidhur me këtë komponent, Plani propozon konfigurimin sa më të saktë të parcelave bujqësore të kategorive të ndryshme në të gjithë territorin e Bashkisë në studim. Duke qënë së kjo njësi vendore disponon një sipërfaqe të konsiderueshme tokash bujqësore dhe sidomos kullotash për bagëtinë, si dhe rëndësinë që ka ky sektor në zhvillimin perspektiv social-ekonomik të saj, propozimet territoriale kanë ruajtur gjurmët ekzistuese bujqësore, duke shtuar ndërkohë në sistemin bujqësor aktiv edhe hapësirat e kategorizuara si tokë e pakultivuar dhe tokë pa fryt. Qëllimi i këtyre propozimeve është vënia në efiçiencë e këtyre hapësirave pa fryt, duke rritur në këtë mënyrë edhe potencialin bujqësor të Bashkisë Tepelenë.

**Ruajtja e Tokës Bujqësore** – Eshtë specifikë e qartë zhvillimi e përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar si dhe në ligjin Nr.9244, datë 17.6.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore", të ndryshuar në vitin 2014. Sipas këtyre ndryshimeve, ndalohet kategorikisht veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtime specifike. Po sipas ligjit, në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të përhershme me tokën, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral. Brenda këtij konteksti, për hapësirën bujqësore ekzituese, Konsulenti ka propozuar vetëm ndërhyrje rikualifikuese dhe rehabilituese.

**Rikualifikimi tokës natyrore – shfrytëzimi i potencialit turistik** – në kontestin e ndërgjegjësimit mjedisor është një dinamikë tashmë e pakthyeshme në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, propozimet janë mbështetur në filozofinë e ripërtëritjes së aseteve natyrore të Bashkisë Tepelenë. Nga analiza e gjëndjes ekzistuese të kësaj njësie vendore, ndikimi më i madh ndaj sipërfaqes natyrore ka si autor dorën e njeriut, si formën e prerjeve të pyjeve, djegieve periodike si dhe vetë përmasën e ekonomive blegtorale, të cilat kanë nevojë për kullota periodike.

Një komponent i rëndësishëm i metodologjisë së ndërhyrjes në sistemin natyror është trajtimi i sipërfaqeve pyjore. Për këtë gjë, Konsulenti është mbështetur në kuadrin rregullator për pyjet, konkretisht Ligji Nr. 9385, dt. 4/5/2005, "**Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor**", në të cilin specifikohen veprimtaritë mbrojtëse, shoqërore, ekoturistike dhe ekonomike që mund të zhvillohen në hapësirën pyjore, duke u mbështetur në parimet e mbarështimit të qëndrueshëm e shumë funksional të tyre. Një element kyç në këtë analizë ka qënë Ligji nr. 5/2016 "**Për Shpalljen e Moratoriumit të Pyjeve në Republikën e Shqipërisë**", në të cilin sanksionohet, për një periudhe 10 vjeçare 2016 – 2026, ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor publik/privat në të gjithë territorin e Republikës

së Shqipërisë, tregtimi i produkteve të tij, ndalimi i eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit, si dhe i qymyrit të drurit. Në këtë kontekst, Konsulenti ka propozuar ndërhyrje minimale në sistemin natyror, të formës së rekuperimit dhe ripërtëritjes, të kombinuara me ndërhyrjet në sistemin bujqësor, dhe konkretisht:

- *Kufizimi dhe disiplinimi i ndërtimeve* – me qëllim ruajtjen e tokës bujqësore dhe rritjen e efiçiencës së zonave urbane në aspektin e menaxhimit të infrastrukturave dhe shërbimeve, është tentuar në kufizimin e shtrirjes urbane të njësive të banimit, duke përfshirë qytetin e Tepelenës si edhe qendrat rurale apo fshatrat periferike.
- *Konturimin e zonave me madhësi absolute* – në këtë mënyrë synohet që të shmanget një strukturë e fragmentuar urbane dhe e rregulloreve të komplikuar, duke ruajtur korrektësinë brenda morfologjisë urbane të zonave të ndryshme të banimit.
- *Homogjeniteti i zonave* - Zonimi ka siguruar rregulla të plota në mënyrë të thjeshtë, që do të jenë të lehta për t'u zbatuar.
- Respektimi i tipareve dhe gjurmëve ekzistuese të territorit
- *Kufizimi i ndërhyrjeve masive transfomuese urbane* – duke marrë shkas edhe nga dinamika aktuale e zhvillimeve si dhe prognozat modeste të rritjes demografike në Bashkinë Tepelenë, propozimet janë fokusuar në ruajtjen e konfiguracioneve ekzistuese urbane, pa qënë nevoja për ndërhyrje masive transformuese në aspektin e morfologjisë dhe hapësirave.
- *Përdorimi ekonomik i infrastrukturës* – Zonimi ka mbështetur shfrytëzimin ekonomik të infrastrukturës ekzistuese dhe asaj të propozuar, pa shkaktuar dëmtime gjatë përdorimit.
- *Racionalizimi i zhvillimeve ilegale* – Zonat e zgjerimit urban të Bashkisë Tepelenë janë përcaktuar në funksion të konsolidimit të zhvillimit ekzistues të ligjshme, dhe/ose të paligjshëm në përputhje me kërkesat e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të politikës së planifikimit, strategjive dhe planeve, si edhe me skemat përkatëse të planifikimit.

Sistemi i klasifikimit të zonave të përdorimit të tokës, është analizuar nëpërmjet identifikimit të llojit të përdorimit/nën kategorive brenda çdo zone specifike, në lidhje me destinacionin e tij të dëshiruar. Konsulenti ka konsideruar dokumentat e PPK-së si dhe të gjitha strategjitë dhe ligjet kuadër, si një udhëzues kryesor për të përcaktuar metodologjinë e përdorimit të tokës në Bashkinë Tepelenë, duke garantuar kështu përputhshmërisë me aktet nënligjore të miratuara për planifikimin territorial. Në këtë mënyrë, sistemi i propozuar i kategorizimit të tokës, është reflektuar në hartat përkatëse të përdorimit të propozuar të tokës, si dhe në dokumentin e Rregullores të Planit të Përgjithshëm Vendor.

### 1.1.3.1. KODIFIKIMI I ZONIMIT FUNKSIONAL TË PROPOZUAR

Në bazë të tabeles së kategorimit të përdorimit të tokës, në territorin e Bashkisë Tepelenë janë evidentuar 22 kategori të propozuara. Sistemi i klasifikimit të përdorimeve të tokës është analizuar më tej nëpërmjet përcaktimit të nënkategorive përkatëse, referuar Aneksit të VKM

Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" i ndryshuar. Konkretisht klasifikimi i përdorimeve të tokës ndjek strukturen në vijim:

**SISTEMI URBAN "UB"**

Ky sistem është klasifikuar në 10 kategori, përkatësisht si më poshtë:

1. A – BANIM *(përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit)*
2. S – SHËRBIME *(përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare, akomoduese dhe zyre)*
3. IE – INDUSTRI EKONOMI *(përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e industrisë së lehtë e të rëndë, si dhe funksione ekonomike komplekse)*
4. IS – INSTITUCIONE *(përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e administrimit publik, shërbimeve publike, sociale, diplomatike, financiare dhe fetare)*
5. AS – ARSIM *(përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e arsimit në të gjitha nivelet: parashkollor, i ulët, i mesëm dhe i lartë, sipas legjislacionit përkatës)*
6. SH – SHENDETESI *(përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimit ambulator dhe spitalor, sipas legjislacionit përkatës)*
7. SHA – AKTIVITETE SHOQERORE DHE ARGËTIMI *(përfshin territore dhe struktura në shërbim të aktiviteteve kulturore e sportive, parqe dhe hapësira publike)*
8. M – MONUMENTE *(përfshin territore dhe struktura, pjesë të trashëgimisë kulturore dhe historike)*
9. ZU – ZONA USHTARAKE *(përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet ushtarake, sipas legjislacionit përkatës)*
10. V – VARREZE *(përfshin territoret dhe strukturat në shërbim të varrezave)*

Ndërkohë, referuar kuadrit rregullator, kategoritë e përdorimit të tokës të Sistemit Urban janë ndarë sipas nën-kategorive dhe funksioneve, të specifikuara për çdo rast në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë

Kategoria A – BANIM ndahet në dy nënkategori:

1. *A1 BANIM* (me ndarje në funksione banim/ mjedise ndihmëse/ struktura banimi të përkohshme)
2. *A2 BANIM DHE SHËRBIME* (me ndarje në funksione banim dhe shërbime/mjedise ndihmëse)

Kategoria S – SHËRBIME ndahet në dy nënkategori:

1. *S1 SHËRBIME AKOMODIMI DHE ARGËTIMI* (me ndarje në funksione hotele/ resorte/ bujtina/ rulota/ kamping/ bar- restorant)

2. *S2 SHËRBIME TREGTARE DHE BIZNESI* (me ndarje në funksione qender panairi, qender tregtare, qender biznesi, treg shumice, treg akice, dyqane-profesione të lira/pika shërbimi karburanti)

Kategoria IE – INDUSTRI EKONOMI ndahet në 3 nënkategori:

1. *IE1 INDUSTRI E LEHTE* (me ndarje në funksione ushqimore/ tekstil konfeksione/ lëkurë këpucë/ përpunim druri dhe letre/ teknologjike –elektronike/ magazine industrial)
2. *IE2 INDUSTRI E RËNDË* (me ndarje në funksione industri kimike/ prodhim –perunim plastike/ industri riciklimi/ nxjerrje inertesh/ prodhim materiale ndërtimi/ industri mekanike/ gurore/ miniera/ industri perpunim metali/ impiant perpunim nafte – gazi/ pus nafte – gazi/ depo karburanti/ magazine industrial)
3. *IE3 AKTIVITET EKONOMIK KOMPLEKS* (me ndarje në funksione park industrial/ park logjistik/ zonë ekonomike tregtare)

Kategoria IS – INSTITUCIONE ndahet në 5 nënkategori:

1. *IS2 SHËRBIM PUBLIK* (me ndarje në funksione institucion-administrate publike/ policia/ posta/ dogana/ shërbime gjyqesore/ burg/ zjarrefikëse)
2. *IS3 SHËRBIM SOCIAL* (me ndarje në funksione shtëpi femije/ azil/OJQ-OJF)
3. *IS4 SHËRBIM DILOMATIK* (me ndarje në funksione ambasade/ consulate/ rezidenca ambasadoresh)
4. *IS5 INSTITUCIONE FINANCIARE* (me ndarje në funksione bankë shteterore/ banke e nivelit të dyte/ bursa)
5. *IS6 INSTITUCION FETAR* (me ndarje në funksione kishe/ xhami/ manastir/ kuvend/ teqe/ sinagoge)

Kategoria AS – ARSIM ndahet në 4 nënkategori:

1. *AS1 ARSIM PARASHKOLLOR* (me ndarje në funksione cerdhe/ kopesht)
2. *AS2 ARSIM i ULET* (me ndarje në funksione shkolle fillore/ shkolle 9 – vjecare)
3. *AS3 ARSIM i MESEM* (me ndarje në funksione shkolle e mesme/ shkolle e mesme profesionale/ medrese/ seminar/ konvikt)
4. *AS4 ARSIM i LARTE* (me ndarje në funksione universitet/ kampus universitar/ konvikt/ qender kerkimore/ qender arsimore)

Kategoria SH – SHENDETESI ndahet në 2 nënkategori:

1. *SH1 SHËRBIM AMBULATOR* (me ndarje në funksione poliklinike/ ambulance/ klinike/ qender shendetesore)
2. *SH2 SHËRBIM SPITALOR* (me ndarje në funksione spital/ qender spitalore/ qender rehabilitimi/ qender kurative)

Kategoria AKTIVITETE SHOQERORE DHE ARGËTIMI ndahet në 3 nënkategori:

1. *AR1 HAPESIRA PUBLIKE* (me ndarje në funksione park urban/ park botanik/ park zoologjik/ park argëtimi/ hapesire e gjelbër- e perbashket/ kend lojrash)
2. *AR2 AKTIVITETE KULTURORE* (me ndarje në funksioneqender kulturore/ qender kongresesh/ konferencash/ teater/ muze/ kinema/ biblioteka/ galeri arti/ akuarium/ cirk)
3. *AR3 AKTIVITETE SPORTIVE* (me ndarje në funksione kompleks sportiv/ park olimik/ stadium/ terren sportive/ terren hipizmi/ fushe golfi/ akuadrom/ kompleks skish, pallat sporti)




*fig 13 – Harta e nen-kategorive të përdorimit të tokës – Bashkia Tepelenë*

Kategoria M – MONUMENTE ndahet në një nënkategori:

1. *M1 MONUMENTE KULTURE* (me ndarje në funksione kala/qytet antik/ ndertese/ mozaik/ amfiteater/tume)

Kategoria Z - ZONA USHTARAKE ndahet në një nënkategori:

1. *ZU1 INFRASTRUKTURE USHTARAKE* (me ndarje në funksione baze ushtarake kombëtare/ baze ushtarake ndërkombëtare/ aeroport ushtarak/ helioport ushtarak/ port detar ushtarak/ polygon stervitor/ vendstrehim/ repart ushtarak/ administrata ushtarake)

Kategoria V – VARREZE ndahet në 3 nënkategori:

1. *V1 VARREZE* (me ndarje në funksione katolike/ muslimane/ ortodokse/ laike)
2. *V2 VARREZE DESHMORESH* (me ndarje në funksion varreze deshmoresh)
3. *V3 MEMORIAL* (me ndarje në funksion memorial)

**SISTEMI INFRASTRUKTUROR IN**

Ky sistem do të klasifikohet në 5 kategori, përkatësisht si më poshtë:

1. INT - INFRASTRUKTURE TRANSPORTI *(përfshin infrastrukturat e transportit rrugor, hekurudhor, ujor, ajror dhe multimodal; rrjetet e përbëra nga linjat, stacionet dhe struktura të tjera në shërbim të tyre)*
2. IEN - INFRASTRUKTURE ENERGJETIKE *(përfshin infrastrukturat e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burime hidrike, lëndë djegëse, eolike e diellore, si dhe infrastrukturat e gazifikimit, përfshirë linjat dhe strukturat mbështetëse)*
3. ITK - INFRASTRUKTURE TELEKOMUNIKACIONI *(përfshin rrjetet, antenat dhe strukturat që mundësojnë telekomunikacionin)*
4. IUK - INFRASTRUKTURE UJESJELLES – KANALIZIME *(përfshin rrjetet dhe strukturat në shërbim të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza)*
5. IMB - INFRASTRUKTURE MENAXHIMI MBETJESH *(përfshin strukturat në shërbim të grumbullimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta)*

Ndërkohe, referuar kuadrit rregullator, kategoritë e përdorimit të tokës të Sistemit Infrastrukturor janë ndarë sipas nën-kategorive dhe funksioneve, të specifikuara për çdo rast në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë

Kategoria **INT - INFRASTRUKTURE TRANSPORTI** ndahet në 5 nënkategori:

1. *INT1 INFRASTRUKTURE RRUGORE* (me ndarje në funksione autostrade/ rruge interurbane kryesore/ rruge interurbane dytesore/ rruge urbane kryesore/ rruge urbane dytesore/ rruge locale/ parkim / terminal/ stacion automjetesh)
2. *INT2 INFRASTRUKTURE HEKURUDHORE* (me ndarje në funksione linje hekurudhore/ linje trami/ stacion treni/ stacion trami/ terminal)

3. *INT3 INFRASTRUKTURE TRANSPORTI UJOR* (me ndarje në funksione port detar/ terminal/ marine/ port marinash/mol/ kantier detar)

4. *INT4 INFRASTRUKTURE TRANSPORTI AJROR* (me ndarje në funksione aeroport ndërkombëtar/ aeroport kombëtar/ aerodrome/ helioport)
5. *INT5 INFRASTRUKTURE MULTIMODALE* (me ndarje në funksione hub multimodal/ terminal multimodal/ stacion transporti multimodal)

Kategoria **IEN - INFRASTRUKTURE ENERGJETIKE** ndahet në 5 nënkategori:

1. *IEN1 ELEKTRIKE* (me ndarje në funksione central elektrik/ termocentral elektrik/ nenctacion elektrik/ transformator/ kabine elektrike/ shtylle elektrike)
2. *IEN2 HIDRIKE* (me ndarje në funksionehidrocentral me basen ujembledhes/ hidrocentral me derivacion)
3. *IEN3 HIDROKARBURE* (me ndarje në funksione stacion)
4. *IEN4 EOLIKE* (me ndarje në funksione park eolik)
5. *IEN5 DIELLORE* (me ndarje në funksione park fotovoltaik)

Kategoria **ITK - INFRASTRUKTURE TELEKOMUNIKACIONI** ndahet në 2 nënkategori:

1. *ITK1 STACION TELEKOMUNIKACIONI* (me ndarje në funksione stacion telekomunikacioni)
2. *ITK2 ANTENA* (me ndarje në funksione tv/ telefonia)

Kategoria **IUK INFRASTRUKTURE UJESJELLES – KANALIZIME** ndahet në 2 nënkategori:

1. *IUK1 UJESJELLES* (me ndarje në funksione rezervuar/ ujembledhes/ depo uji/ impiant trajtimi i ujit të pijshem/ puse/ stacion pompimi)
2. *IUK2 KANALIZIME* (me ndarje në funksione impiant trajtimi UB/ impiant trajtimi UZ/ pika derdhjeje)

Kategoria **IMB INFRASTRUKTURE MENAXHIMI MBETJESH** ndahet në 2 nënkategori:

1. *IMB1 TRAJTIM MBETJESH* (me ndarje në funksione landfill/ incinerator/ kompostim)
2. *IMB2 DEPOZITIM MBETJESH* (me ndarje në funksione pika transferimi/ pika grumbullimi)

**SISTEMI BUJQËSOR B**

Ky sistem klasifikohet në 4 kategori përdorimi të tokës, përkatësisht si më poshtë:

1. B - TOKE BUJQËSORE *(përfshin tokat bujqësore me kultura të përhershme apo sezonale bujqësore, si dhe tokat djerrë, sipas legjislacionit përkatës)*
2. IB - INFRASTRUKTURE BUJQËSORE *(përfshin infrastrukturën në shërbim të aktivitetit bujqësor që mundëson vaditjen dhe kullimin e tokave bujqësore)*
3. EB - EKONOMI BUJQËSORE *(përfshin strukturat dhe infrastrukturat në funksion të ekonomisë bujqësore e blegtorale, si dhe shërbimet e agroturizmit)*
4. BA - BUJQËSI-BANIM *(përfshin banimin në funksion të aktivitetit bujqësor)*

Çdo kategori përdorimi të tokës bujqësore është ndare sipas nen-kategorive të meposhteme.

Kategoria **B - TOKE BUJQËSORE** ndahet në 3 nënkategori:

1. *B1 - KULTURA të PERHERSHME* (me ndarje në funksione agrume/ ullishte/ vreshta/ arrore/ frutore)
2. *B2 - KULTURA SEZONALE* (me ndarje në funksione drithera/ frutore/ erime/ aromatike-ereza/ orizore/ komplekse)
3. *B3 - TOKE DJERRE* (me ndarje në funksione toke e pakultivuar/ toke e kripur/ toke pa frut)

Kategoria **IB INFRASTRUKTURE BUJQËSORE** ndahet në një nënkategori:

1. *IB3 - INFRASTRUKTURE VADITJE DHE KULLIMI* (me ndarje në funksione argjinature/ hidrovor/ kanal vadites/ kanal kullues/ rezervuar)

Kategoria **EB EKONOMI BUJQËSORE** ndahet në 3 nënkategori:

2. *EB1 - STRUKTURA në FUNKSION të BUJQËSISE* (me ndarje në funksione sera/ magazine frigoriferike/ kapanon – kulle silosi/ ferme)
3. *EB2 - STRUKTURA në FUNKSION të BLEGTORISE* (me ndarje në funksione stalla/ pulari/ bletari/ akuakulture/ baxho/ ferme)
4. *EB3 - AGROTURIZEM* (me ndarje në funksione shërbime akomoduese/ shërbime gastronomie)

Kategoria **BA - BUJQËSI-BANIM** ndahet në një nënkategori:

1. *BA1 BUJQËSI-BANIM* (me ndarje në funksione bujqësi-banim)

Një element interesant për sa i përket sistemit bujqësor në Bashkinë Tepelenë është nën-kategoria e përdorimit Bujqësi-Banim BA. Për shkak të natyrës dhe formës së zhvillimit urban të dy dekadave të fundit, kjo tipologji hapësinore është mjaft e shfaqur në shumë zona rurale, dhe jo vetëm në Bashkinë Tepelenë. Në pjesën më të madhe të tyre, kjo tipologji përdorimi është e evidentuar në periferi të fshatrave ekzistues, për pasojë të iniciativave të paplanifikuara të vetë banorëve të zonave rurale, në shumicen e rasteve, në dëm të tokës bujqësore.

Lidhur me këtë komponent, Plani i Përgjithshëm Rregullues i Bashkisë Tepelenë propozon një formë specifike ndërhyrjeje, në favor të konceptit të zonave kopshte rurale, dhe si potencial të zhvillimit të agroturizmit. Agroturizmi përbën një potencial të veçantë pozitiv për zhvillimin ekonomik lokal në zonat rurale të Bashkisë Tepelenë, duke promovuar shfrytëzimi e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore të kësaj njësie vendore. Objektet agro-turistike të zhvilluara janë të tipit fermë për rritjen, vjeljen dhe përpunimin e ushqimeve lokale tradicionale. Në këto zona, turistët kanë mundësinë për të shijuar peisazhet bujqësore dhe të provojnë shijet e prodhimeve vendase dhe ushqimin tradicional, njohjen nga afër me jetën e përditshme në fshat, të marrin informacion në lidhje me historinë e zonës, dhe të marrin pjesë në aktivitetet rurale.

Kriteret për organizimin dhe planifikimin e objekteve agro-turistike në Bashkinë Tepelenë përfshijnë:

- Pozicionin gjeografik në lidhje me territoret bujqësore, zonat me vlera mjedisore, zonat me vlera kulturore, historike dhe arkeologjike, sipërfaqet dhe trupat ujorë me vlera peisazhistike, etj.
- Lidhja me rrjetin e qarkullimit dhe transportin publik;

Ndërkohë, strukturat agro-turistike të propozuara mund të përmbajnë:

- Shtëpi karakteristike ekzistuese të rinovuara apo edhe vila të reja të ndertuara me tipologjine tradicionale arkitekturore, etj;
- Njësi të prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale.
- Pika informacioni për produktet lokale apo aktivitetet kulturore.
- Hapësira shërbimi, bar/kafe, restorante tradicionale, hapësira parkimi
- Këtu duhet përmendur një saktësim i nevojshëm; emërtimi **Tokë pa Fryt** që shfaqet në Sistemin Natyror – Nën-kategoria **N5**, për shkak të një përsëritjeje në dokumentin e Rregullore së Planifikimit të Territorit, është eliminuar nga Funksioni **B3-3** të kodifikimit të Sistemit Bujqësor, për të evituar mbivendosjet apo keqinterpretimet në aspektin statistikor të Planit të Përgjithshëm Vendor.

**SISTEMI NATYROR N**

Ky sistem klasifikohet në 2 kategori përdorimi, përkatësisht si më poshtë:

1. N - TOKE NATYRORE *(*përfshin territoret natyrore, si: pyje, kullota, livadhe, shkurre e të tjera, të paprekura nga aktiviteti njerëzor*)*
2. NAR - NATYRE DHE ARGËTIM *(*përfshin territoret natyrore, infrastrukturat ekologjike në funksion të aktivitetit njerëzor në natyrë, si: parqe, plazhe, shtigje dhe strukturat në funksion të ekoturizmit*)*

Kategoritë janë ndarë në nënkategori dhe çdo nënkategori në funksione, sipas kuadrit ekzistues rregullator të planifikimit të territorit. Konkretisht:

Kategoria **N - TOKE NATYRORE** ndahet në 5 nënkategori:

1. *N1 - PYJE* (me ndarje në funksione të dendur/ të rralle)
2. *N2 - KULLOTE* (me ndarje në funksione bimesi medicinale/ e paster/ e perzier)
3. *N3 - LIVADH* (me ndarje në funksione livadh për kullotje/ livadh me korrje bari)
4. *N4 - SHKURRE* (me ndarje në funksione e dendur/ e rralle)
5. *N5 - TOKE A FRUT* (me ndarje në funksione ranore/ shkembore/ bimesi e rralle/ zallishte/ bore dhe akuj)

Kategoria **NAR - NATYRE DHE ARGËTIM** ndahet në 4 nënkategori:

1. *NAR1 - PARK NATYROR* (me ndarje në funksione park Bashkiak/ park rajonal)
2. *NAR2 - PLAZH* (me ndarje në funksione natyror/ i sherbyer me infrastrukture)

3. *NAR3 - SHTIGJE* (me ndarje në funksione bicikletash/ kembesore)
4. *NAR4 - EKOTURIZEM* (me ndarje në funksione shërbime akomoduese/ shërbime rekreacioni)

**SISTEMI UJOR U**

Ky sistem përbehet vetem nga një kategori përdorimi:

1. U - UJERA *(*përfshin të gjithë trupat ujorë: dete, laguna, këneta, liqene, lumenj, përrenj e burime ujore, sipas legjislacionit përkatës*)*

Kategoria ndahet në nënkategori dhe nënkategoria në funksione.

Kategoria **U UJERA** ndahet në 7 nënkategori:

1. *U1 - DET* (me ndarje në funksione det)
2. *U2 - LAGUNE* (me ndarje në funksione lagune)
3. *U3 - KENETE* (me ndarje në funksione kenete)
4. *U4 - LIQEN* (me ndarje në funksione natyral/ artificial)
5. *U5 - LUME* (me ndarje në funksione lume)
6. *U6 - PERRUA* (me ndarje në funksione perrua i perhershem/ perrua sezonal)
7. *U7 - BURIM UJOR* (me ndarje në funksione burim ujor i fresket/ burim gjeotermal)

### 1.1.4 ZONAT E RËNDËSISE KOMBËTARE

Në aspektin operacional, të gjitha proceset që kanë të bëjnë me planifikimin e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare, në referencë me përcaktimet e Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, me përcaktimet e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar si dhe me përcaktimet e VKM Nr.408 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" e ndryshuar, janë subjekt hartimi, shqyrtimi dhe miratimi në nivel kombëtar.

Sipas kuadrit ligjor të sipërcituar, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare përfshijnë struktura, instalime apo rrjete infrastrukturore specifike, të cilat dallohen nga vlerat e tyre të veçanta shoqerore, historike, kulturore, ekonomike, mjedisore, etj dhe që janë në funksion të realizimit të objektivave dhe interesave në nivel kombëtarë, si:

a) monumentet e kulturës, qendrat historike, zonat e parqet arkeologjike;
b) pyjet e zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, rrjetet ekologjike, ekosistemet e rrezikuara dhe biodiversiteti;
c) brezi bregdetar, brigjet dhe burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqenet;
ç) toka bujqësore;

d) zonat me rrezik natyror;

dh) digat e dambat;

e) burimet minerare e natyrore dhe rrjetet, komplekset e parqet industriale;

ë) infrastruktura kombëtare e transportit;

f) infrastrukturat inxhinierike të energjisë dhe telekomunikacionit;

g) zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;

gj) zonat ushtarake;

h) zhvillime ose struktura arsimore, shëndetësore, sociale, kulturore e artistike, sportive, të cilat, për shkak të veçorive të tyre, janë të rëndësishme për kryerjen e veprimtarisë së institucioneve shtetërore, sikurse përcaktohet me ligj.




*fig 14 – Harta e Zonave të Rëndësise Kombëtare – Bashkia Tepelenë*

Ndër elementët më të rëndësishëm që përfshihen në klasifikimin e zonave të rëndësisë kombëtare janë edhe zonat e mbrojtura mjedisore. Në kontekstin aktual, ku gjithnjë e më shumë ndërgjegjësimi ndaj problemeve mjedisore në nivel global po bëhet shumë aktiv në të gjitha vendet, grupmoshat apo nivelet e përfaqësimit social, trajtimi i zonave të mbrojtura mjedisore duhet të jetë një prioritet gjithnjë e më serioz për administrimin e territorit në

Bashkinë Tepelenë. Sipas legjislacionit shqiptar, dhe konkretisht sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", kategorizimi i zonave të mbrojtura bëhet si në vijim:

- Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor — Kategoria I
- Park kombëtar — Kategoria II
- Monument natyror — Kategoria III
- Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror — Kategoria IV
- Peizazh i mbrojtur — Kategoria V
- Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara — Kategoria VI
- Park natyror Bashkiak — Kategoria IV
- Kurorë e gjelbër — Kategoria V

Për të gjitha këto kategori, legjislacioni aktual shqiptar përmban kriteret përkatëse të mbrojtjes, në funksion të rëndësisë që ka çdo subjekt i listuar. Ndërkohë, planifikimi mjedisor si dhe zhvillimi i zonave të rëndësisë kombëtare është një proces delikat, i cili kërkon një analizë të thelluar multidimensionale, si dhe një koordinim sa më të detajuar midis institucioneve të planifikimit në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar. Në terma teknike, çdo proces zhvillimi apo transformimi në zonat e rëndësisë kombëtare duhet të paraprihet nga dokumenti i Planit të Detajuar të Zonës me Rëndesi Kombëtare (PDZRK)

Në analizën e përgjithshme të Bashkisë Tepelenë, janë evidentuar të gjitha territoret dhe objektet që përfshihen në kategoritë e mbrojtjes speciale, ku çdo lloj ndërhyrje duhet të miratohet në nivel rajonal dhe kombëtar.

Në vazhdim jepet tabela e detajuar e objekteve të klasifikuara pasuri kulturore të paluejtëshme në këtë Njësi Vendore:

| Nr | Emertimi | | FSHATI | NJ. ADMINISTRATIVE | BASHKIA | QARKU | INSTITUCIONI/ NR. VENDIMIT/ DATA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | KALAJA E TEPELENËS | I | | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | 1. Instituti i Shkencave/ nr. 95/ dt.16.10.1948 2. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 3.Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 2 | KALAJA E QYTEZËS | I | Dukaj | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | 1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 2. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 3 | KALAJA në fshatin Lekël | I | Lekël | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | 1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963 2. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | KALAJA në fshatin Matohasanaj | I | Matohasanaj | Lopës | Tepelenë | Gjirokastër | 1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963<br>2. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 5 | KALAJA në fshatin Nivicë | I | Nivicë | Kurvelesh | Tepelenë | Gjirokastër | 1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963<br>2. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 6 | KALAJA E ZHARËS | I | Dukaj | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | 1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963<br>2. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 7 | KALAJA e Horës | I | Horë | | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 8 | VENDBANIMI ANTIK | I | Qesarat | Qesarat | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 9 | URA METALIKE E LEKLIT | II | Lekël | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | M.T.K.R.S. -Drejt.e Përgjith. e Turiz -mit dhe e Trashegimise Kulturore/ nr. 236/ dt. 17.05.2010 |
| 10 | URA METALIKE E DRAGOTIT | II | Dragot | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | M.T.K.R.S. -Drejt.e Përgjith. e Turiz -mit dhe e Trashegimise Kulturore/ nr. 236/ dt. 17.05.2010 |
| 11 | RRENOJAT E urës SË MUCO HYSËS MBI LUMIN VJOSE | I | Gryka e Meshgoranit | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/ Urdhëres/ 08.01.1977 |
| 12 | RRENOJAT E URËS ANTIKO-MESJETARE MBI LUMIN VJOSE NEN KALANE E TEPELENËS | I | | | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Arsimit dhe Kulturës (Drejtoria e Kulturës) / nr.786/1 / dt.05.11.1984 |
| 13 | Ujësjellësi i Bënçës | I | Bënçë | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | 1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ nr. 6/ dt. 15.01.1963<br>2. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 14 | MULLIRI | I | Nivicë | Kurvelesh | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)/ nr.266/1 / dt.16.02.1979 |
| 15 | KISHA E PROFET ILIAS | II | Lekël | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | M.T.K.R.S.( Drejt Trashig Kulturore) nr.236/ dt.17.05.2010 |
| 16 | KISHA E SHEN THANASIT | II | Lekël | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | M.T.K.R.S.( Drejt Trashig Kulturore) nr.236/ dt.17.05.2010 |

SEKRETARIA - REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERITORIT

SEKRETARIA - REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERITORIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration - studio@archi-space.com

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | KISHA E SHEN MEHILLIT | II | Lekël | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | M.T.K.R.S.( Drejt Trashig Kulturore) nr.236/ dt.17.05.2010 |
| 18 | Rrënojat e Kishës së Dashajt | I | | | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/ Urdhëres/ 08.01.1977 |
| 19 | Banesa e Mufit Kaçubajt | I | Nivicë | Kurvelesh | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/ Urdhëres/ 08.01.1977 |
| 20 | Shtëpia e Selam Musait | I | Salari | Qendër Tepelenë | Tepelenë | Gjirokastër | 2.Ministria e Arsimit dhe e Kulturës/nr.1886/ dt.10.06.1973 |
| 21 | Ish Kampi i Internimit, Tepelenë | II | | | Tepelenë | Gjirokastër | Ministria e Kulturës/nr.465 dt.05.08.2019 |

*fig 15 – tabela e objekteve dhe zonave te klasifikuara ne pasuri kulturore te paluejteshme*

Ndërkohë, në vazhdim jepet lista e miratuar e monumenteve të natyres

**Monumentet e Natyrës**

- **Shpella Mëma e Ujit, Progonat** - një shpellë karstike e formuar në gëlqeroret në afërsi të fshatit Progonat, 1165 m mbi nivelin e detit;
- **Stera e Çikës** - ndodhet në lindje të fshatit Gusmar, në fundin e një hinke karstike, 890 m mbi nivelin e detit;
- **Shpella e Lek Petës** – pranë kanionit të Nivicës;
- **Shpella e Ujit Dhëmbel** - në afërsi të fshatit Lekël, 970 m mbi nivelin e detit;
- **Vrima e Shkëmbit** - një shpellë karstike e formuar në gelqeroret, në afërsi të fshatit Progonat, 1110 m mbi nivelin e detit;
- **Ujëvara e Progonatit** - në lindje të fshatit Progonat;
- **Shpella e Kasarit** - në juglindje të fshatit Progonat, në shpatin e djathtë të luginës së përroit;
- **Kanionet e Nivicës** - formuar nga erozioni në shkembinjtë karbonatike të përroit të Nivicës;
- **Përroi i Nivicës** - poshtë fshatit me të njëjtin emër, ka formuar një grykë me shtrat tepër të ngushtë, me gjatësi rreth 3 km;
- **Lugjet e Dhëmblanit** - pranë fshatit Dhëmblan, krijuar mbi konet e depozitimeve të gureve sjella nga pjesa e sipërme e shpatit të Malit të Gribës.
- **Buza e Bredhit, Luzat** - përbën një rrëpirë shkëmbore me lartësi disa qindra metra dhe gjatësi rreth 800 m.
- **Rrapi i Selam Musait** – pranë Kalasë së Tepelenës
- **Shpella e Mezhgoranit** - pranë fshatit Mezhgoran, në shpatin verior të Grykës së Këlcyrës, rreth 850 m mbi nivelin e detit.
- **Shpella e Leklit** - ndodhet në afërsi të fshatit Lekël, 400 m mbi nivelin e detit.
- **Burimet e Ujit të Ftohtë** - përgjatë rrugës interurbane, në jug të qytetit;
- **Tarraca Erozive e Bençës** -përgjatë luginës së përroit të Bëncës;
- **Shkëmbi i Prerë, Dukaj** - ndodhet pranë fshatit Dukaj të Bashkisë Tepelenë;

- **Rrapi i Progonatit**
- **Rrepet e Ujit të Ftohtë** - gjendet në të djathtë të rrugës automobilistike kombëtare Tepelenë-Gjirokastër, pak pas degëzimit të rrugës automobilistike për në Përmet.
- **Lisat e Luzatit**
- **Rrapi i Hormovës** - në qendër të fshatit Hormovë, me lartesi 20 m dhe diameter të trungut rreth 1,2 m.
- **Parku Natyror i Zagorisë** – zonë e mbrojtur, shpallur me me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 60, datë 26.1.2022 u miratua ndryshimi i sipërfaqes së ekosistemit natyror "Zagori", shpallur "park natyror" (kategoria IV e zonave të mbrojtura), nga 24 590 ha në 24 607.63 ha, ku përzihen peizazhe malore, fshatra të vegjël karakteristikë, monumente të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe vlera të botës bimore dhe shtazore.

Përveç listës së mësipërme, vlen të theksohet së një pjesë e konsiderueshme e territorit të Bashkisë Tepelenë prezanton cilësi dhe vlera natyrore, falë relievit, morfologjisë së terrenit, linjave hapësinore, sipërfaqeve të gjelbra, etj. Një pozicion thelbësor në këtë inventar ka korridori i Vjoses, i transformuar në koncept-idenë për krijimin e Parkut Kombëtar lumor të Vjosës. Edhe pse në fazë ideje, i propozuar si alternative potenciale për zhvillimin e Sistemit Natyror në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, ky projekt përbën një mundësi të jashtëzakonshme për vlerësimin, planifikimin dhe rikualifikimin mjedisor të territoreve të Bashkisë Tepelenë, që shtrihen përgjatë këtij korridori lumor.



*fig 16 – Pamje ajrore e kalasë së Tepelenës, në qender të qytetit*

Duke iu referuar listës aktuale të zonave të rëndësisë natyrore dhe kulturore, në rastin e Bashkisë Tepelenë spikat Parku Natyror i Zagorisë, i cili paraqet një potencial të madh për zhvillimin e ekoturizmit dhe atë të aventurës. Për sa i përket monumenteve kulturore, Plani thekson nevojën për hartimin e instrumenteve të nevojshme të menaxhimit për të gjitha

kalatë që ndodhen brenda territorit të Bashkisë. Elementi më i rëndësishëm në këtë listë

është kalaja e Ali Pashës, në qendër të qytetit, e cila, megjithë ndërhyrjet fizike të murit të jashtëm, ka nevojë urgjente për një ndërhyrje të studiuar në hapesirat e brendshme të saj.

Ndërkohë, për objektet e tjera të klasifikuara si pasuri të trashëgimisë kulturore materiale, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon që instrumente menaxhimi duhet të jenë në formën e planeve afatgjata të gërmimit arkelogjik, me qëllim evidentimin sa më të saktë të vlerave monumentale dhe historike të siteve arkeologjike, të kombinuar me zhvillimin e itinerareve potenciale të turizmit kulturor. Këto plane duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore Dhe Muzetë".

Referuar listës së monumenteve të natyrës, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë merr në konsideratë marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe mirë-administrimin e karakteristikave të veçanta natyrore, për të cilat është klasifikuar çdo monument. Plani propozon marrjen e masave periodike nga ana e Bashkisë për vlerësimin dhe mbrojtjen e pemëve të klasifikuara si monument natyre, duke kryer vlerësime teknike të vazhdueshme të gjendjes fizike të pemëve si dhe eliminimin e elementëve të rrezikshëm, paraziteve, etj.

Plani thekson nevojën që të merren masa urgjente për ruajtjen e urave metalike të Leklit dhe Dragotit, duke disiplinuar trafikun e rëndë që kalon mbi këto dy objekte të rëndësishme të trashgimisë kulturore të Bashkisë Tepelenë.

Rreth objekteve që klasifikohen si monumente kulture, sipas klasifikimeve të legjislacionit të posaçëm, përcaktohet një sipërfaqe toke si zonë mbrojtëse, në përputhje me vlerat e saj arkitektonike, me përshtatshmërinë e saj urbanistike, territoriale dhe estetike, me rrethinën dhe me rrethanat ekologjike e mjedisore. Përmasat e zonës mbrojtëse dhe rregullat e kushtet zhvillimore në të përcaktohen në përputhje me legjislacionin e posaçëm për trashëgiminë kulturore dhe me ligjin.

Në përgjithësi, procesi i zonimit të një sipërfaqeje të ZMM-së është kompleks, delikat dhe kërkon një analizë të hollësishme të shumë elementëve ekzistues që karakterizojnë zonën e mbrojtur. Duke iu referuar përcaktimeve të VKM Nr. 57, datë 6.2.2019 "Për Kriteret dhe Mënyrën e Zonimit të Territorit të një Zone të Mbrojtur Mjedisore", Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë thekson nevojën që procesi i përcaktimit të zonave të mbrojtura

për monumentet ekzistuese, por edhe ato që mund identifikohen në perspektivë të kenë parasysh:

a) Sigurimin e mbrojtjes për habitatet dhe llojet kritike apo tipike e simbolike të ekosistemeve, proceset ekologjike, si dhe për rastet unike gjeomorfologjike nga shqetësimi e keqpërdorimi për interesa publike e private;

b) Realizimin e ndarjes së përdorimeve të papajtueshme me njëri-tjetrin dhe të aktiviteteve konfliktuale të njerëzve;

c) Dhënien e prioritetit për përdorimet apo qëllimeve specifike në nënzona të ndryshme dhe ruajtja e zonave të përshtatshme për përdorime të veçanta nga njeriu, duke minimizuar dukuritë e këtyre përdorimeve në zonën e mbrojtur;

ç) Ruajtja e cilësisë peizazhore dhe/ose kulturore/arkeologjike e ZMM-së, duke lejuar një spektër përdorues të qëndrueshëm nga njeriu;

d) Ruajtja e zonave të përshtatshme për përdorime të veçanta nga njeriu, duke minimizuar dukuritë e këtyre përdorimeve në ZMM;

dh) Ruajtja e disa pjesëve të ZMM-së në gjendjen e tyre natyrore apo gjysmënatyrore, të pashqetësuara nga njeriu, vetëm për qëllime të hulumtimit shkencor apo edukimit.

Ndërkohë, procesi dhe metodologjia e zonimit të hapësirës së ZMM'së duhet të garantojë:

a) Ruajtjen e karakteristikave vizuale të hapësirave natyrore e bujqësore, pyjore, kullosore, liqenore, ujore, bregdetare, fushore-malore, urbane dhe rurale, me karakter mesdhetar;

b) Rritjen e mundësisë së përdorimit të aseteve biologjike e peizazhistë, nëpërmjet prezantimit të funksioneve që tërheqin njerëzit dhe turistët, si përdorues të tyre;

c) Sigurimin e zonave "tampon"/zonave mbrojtëse për uljen e dëmtimeve, të ndotjes, shkarkimeve, zhurmës, zjarreve, erës dhe faktorëve të tjerë njerëzorë e natyrorë;




*fig 17 - Fragment 1 PKK - Sistemi Natyror, territoret jugore të Shqipërisë*

Përveç elementëve të mesipërem të trashegimise kulturore dhe natyrore, elementët me rëndësi në nivel kombëtar në territorin e Bashkisë Tepelenë evidentohen si sinteze

permbajtesore e Planit të Përgjithshëm Kombëtar. Sipas këtij dokumenti baze të planifikimit, lumi Vjose perben ndoshta dhe elementin kryesor territorial të kesaj njësie vendore, me rëndësi shume të madhe në nivel rajonal dhe kombëtar.

Sipas PKK, i gjithë brezi i Vjoses, i cili karakterizon të gjithë kufirin Veri-Lindor të Bashkisë Tepelenë, konceptohet në formën e nje Korridori Natyror, statusi i të cilit do të jetë subjekt i planifikimit në nivel sektorial mjedisor. Sipas Sistemit Ujor, lumi Vjose klasifikohet si vije ujore e paster, e cila duhet domosdoshmerisht të mbetet në këtë status. Ky përcaktim imponon monitorimin e rregullt dhe marrjen e masave për eliminimin e ndotjes jo vetem në zonat urbane pergjate Vjoses, por edhe pergjate linjave ujore tributare të lumit në territorin e Tepelenës, ku me kryesoret janë Lumi i Bënçës dhe Lumi Drinos.



*fig 18 - Fragment PKK - Sistemi Infrastrukturor*

Per sa i perket komponentit të infrastrukturave, PKK përcakton disa elementë interesante për territorin e Bashkisë Tepelenë, të cilat jane:

- Projektimi dhe zhvillimi i aksit të hekurudhes, i projektuar si nje vazhdim i aksit Fier, Ballsh, pershkon territoret fushore të lugines së Vjosës në kufi të Bashkisë Memaliaj, kalon pranë qytetit Memaliaj për të vazhduar me pas drejt Tepelenës, Gjirokastres dhe Greqise.
- Aksi i rruges dytesore interurbane Tepelenë – Vlorë – propozim ky mjaft i rëndësishem në kontekstin e zhvillimit të territorit të Bashkisë Tepelenë, i cili mundeson ndjeshem permiresimin e komunikimit midis Shqipërise qendore si dhe asaj jugore, ndërkohë duke rritur ndjeshem fluksin e qarkullimit të njerezve dhe mallrave përmes territorit të Bashkisë Tepelenë.

## 1.1.5 ZONAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE URBAN

### 1.1.5.1 ZHVILLIMI EKONOMIK

Mirë-administrimi i të gjithë elementëve urbane, infrastrukturore dhe natyrore në funksion të përmirësimit dhe rritjes së standardit të jetesës së banorëve të Bashkisë Tepelenë është

objektivi kryesor i dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Për arritjen e këtij objektivi, Plani thekson rëndësinë e zbatimit të përcaktimeve të instrumentit të Strategjisë Territoriale të kësaj Njësie Vendore, në funksion të zhvillimit të hapësirave ekonomike të dedikuara në territorin administrativ të Bashkisë. Duke iu referuar metodologjisë së Stratëgjisë Territoriale, Plani i referohet Drejtimit të Dytë Strategjik të Zhvillimit, dhe konkretisht, promovimit të zhvillimit ekonomik nëpërmjet shfrytëzimit në mënyrë efektive të kapaciteteve dhe potencialeve ekzistues në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë.




*fig 19 - Harta e zonave të rëndësisë kombëtare në Bashkinë Tepelenë*

Niveli i ulët i zhvillimit social-ekonomik, mungesa e investimeve të rëndësishme kapitale si dhe komunikimi i vështirë fizik midis qendrës dhe zonave periferike të Bashkisë, ku mund të përmendim Lopësin apo Kurveleshin, janë ndër shkaqet kryesore që kanë ndikuar në procesin e migrimit të popullsisë lokale, kryesisht kjo nga zonat rurale dhe periferike të kësaj njësie vendore, në të cilat evidentohen aktualisht shumë hapësira të degraduara si dhe banesa të braktisura. Mungesa e vendeve të punës si dhe të ardhurat e ulëta paraqiten si problematikat kryesore të zhvillimit të Bashkisë Tepelenë. Gjithsesi, duke iu referuar aseteve e burimeve natyrore të saj, të trajtuar në mënyrë të detajuar gjatë procesit të Analizës së Përgjithshme të Territorit ekzistojnë ende mjaft mundësi për rivitalizimin e jetës ekonomike si dhe përmirësimin e standardit të jetesës së banorëve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA
Architecture - Interior Design - ARCHISPACE STUDIO - Urban Planning - Architectural Restoration
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT SEKRETARIA

Plani i Përgjithshëm Vendor ka vlerësuar përfundimet e analizës së përgjithshme në lidhje me dinamikat e zhvillimit ekonomik, duke evidentuar në hapësirën administrative të Bashkisë ato territore ku mund të stimulohet rritja në perspektivë. Këto territore janë konceptuar brenda Njësive Strukturore të posaçme në të gjithë hapësirën e Bashkisë Tepelenë, duke identifikuar për secilën prej tyre kriteret urbanistike të zhvillimit sipas rastit. Ky proces është detajuar në:




*fig 20 - Harta e Vizionit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Tepelenë*

- përcaktimin e zonave/njësive potenciale që mund të transformohen në hapësira ekonomike, duke përfshirë njësi të vogla prodhimi, fasoneri, magazinim, përpunim dhe shitje të produkteve. Kjo metodologji analizë është ndjekur në të gjithë territorin

e Bashkisë Tepelenë, duke u kujdesur që të shmangen diferencimet midis hapësirave qendrore dhe periferike, por edhe për të stimuluar aktivitetin ekonomik në zonat me zhvillim të ulët.

- krijimin e hapësirave të dedikuara për tregëtimin e produkteve lokale të Bashkisë Tepelenë, në pjesën veriore të qytetit dhe pranë aksit kryesor interurban, duke shërbyer kështu në një katalizator të rëndësishëm për prodhuesit vendas në zonat rurale të kësaj njësie vendore

- përcaktimin e saktë të zonave/njësive të Sistemit Bujqësor, dhe konkretisht të hapësirave të konsiderueshme për zhvillimin e pemëtarisë në zonat rurale të Bashkisë, të cilat, përveç efekteve pozitive në mjedis si rritja e sipërfaqes së pyllëzuar apo mbrojtja nga erozioni, ofrojnë mbështetje për degë të tjera të ekonomisë vendore në Bashkinë Tepelenë si agroturizmi, turizmi kulinar apo turizmi i aventurës, mjaft të nevojshme për rigjenerimin e ekonomisë së kësaj njësie vendore;
- zhvillimi i fermave blegtorale, e cila synon të shfrytëzoje kapacitetet ekzistuese të këtyre zonave, duke mundësuar krijimin e strukturave të specializuara për mbarështimin e bagëtive në mënyrë sa më natyrore, të kombinuar me kullotat në natyrë, si elementi më i fortë lidhur me zhvillimin ekonomik. Dokumenti i Strategjisë Territoriale identifikon zonat pilot për krijimin e fermave blegtorale, të cilat përkthehen në Planin e Përgjithshëm Vendor në Njësi Strukturore specifike, brenda Sistemit Bujqësor.
- krijimi dhe promovimi i turizmit kulturor, natyror si dhe të aventurës si një alternative mjaft e mirë për zhvillimin ekonomik, gjenerimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e të ardhurave të banorëve të zonave rurale të Bashkisë Tepelenë. Plani reflekton këtë metodologji nëpërmjet përcaktimit të Njësive Strukturore të dedikuara për agroturizëm.

Referuar dokumentit të Strategjisë Territoriale, agroturizmi në Bashkinë Tepelenë identifikon ato lloje aktivitetesh bujqësore apo blegtorale që stimulojnë fluksin e vizitorëve, kryesisht përgjatë muajve të pranverës dhe verës. Në këtë kontekst, agroturizmi që ka për qëllim të transmetojë njohuritë bujqësore, praktikat sociale dhe specialitetet e kuzhinës të një territori tek vizitorët. Kjo formë e turizmit, karakterizohet nga praktikat turistike që mbështeten kryesisht në mjedisin rural dhe jo vetëm në praktikat bujqësore. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë thekson nevojën për zhvillimin e këtij sektori, nepërmjet stimulimit të investitorëve vendas apo dhe të huaj drejt zonave periferike të Bashkisë, të cilat përballen çdo ditë e më shumë me largimin e popullsise, duke ofruar nga ana tjeter një alternativë ekonomike që garanton të ardhura më të larta për fermerët e zonës, nëpërmjet ruajtjes dhe promovimit të vlerave e traditave kulturore e sociale.

Zhvillimi dhe konsolidimi i produktit agroturistik në Bashkinë Tepelenë ka nevojë të mbështetet në elementët e fortë lokalë, ku vlen të theksohen karakteri specifik rural i territoreve periferike, peizazhet me vlera natyrore të zonave kodrinore dhe malore, elementët karakteristikë të terreneve të caktuara, produktet bujqësore, etj. Ky produkt kërkon zhvillimin e strukturave pritëse dhe akomoduese për vizitorët potenciale që do të vijnë të frekuentojnë këto destinacione, por edhe njësi shërbimesh që mbështesin aktivitetin

turistik të fermave, ku mund të përmendim:

- strukturat ekzistuese ose struktura të reja që përfshijnë në to elemente karakteristike rurale si stalla, hangare, kotece, plevica, etj, ku vizitoret potenciale mund të eksplorojnë elementë të jetës rurale, natyrën, blegtorinë, shpendët, etj.
- Sipërfaqe bujqësore të kultivuara me kultura autentike të terreneve kodrinore dhe malore në Tepelenë, në pemëtari, vreshtari, etj, në permasa jo shumë të mëdha dhe të aksesueshme nga vizitorët vendas dhe të huaj;
- Njësi shërbimi plotesuese si bare, restorante dhe dyqane që ofrojnë produkte dhe specialitete lokale të pijeve dhe ushqimeve.

Krahas strukturave të dedikuara për pritjen dhe shërbimin ndaj vizitorëve në zona të ndryshme në Bashkinë Tepelenë, rritja dhe konsolidimi i një rrjeti të suksesshëm të agroturizmit në këtë njësi vendore ka nevojë të domosdoshme për bashkëveprimin e strukturave prodhuese bujqësore dhe blegtorale të zonës. Një njësi agroturizmi ka nevojë për akses të vazhdueshëm me produkte cilësore të zonës, bujqësore dhe blegtorale, duke përmirësuar në këtë mënyrë jo vetëm kualitetin e markës së destinacionit agroturistike por edhe imazhin e të gjithë Njësisë Vendore, në këtë rast të Bashkisë Tepelenë.




*fig 21 - Pozicioni strategjik i propozuar për ferme blegtorale pranë fshatrave Progonat, Gusmar, Nivicë*




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
SEKRETARIA
Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
SPACE STUDIO
BASHKIA TEPELENË

*fig 22 - Pozicioni strategjik i propozuar për ferme blegtorale pranë fshatrave Dhëmblan dhe Sinanaj*

Për këtë arsye Plani i Përgjithshëm Vendor promovon mbështetjen e vazhdueshme për zhvillimi i kooperativave bujqësore dhe blegtorale, pikave të grumbullimit të produkteve, në funksion të përmirësimit dhe konsolidimit të të gjithë ciklit prodhues dhe përpunues të Sistemit Bujqësor në Bashkinë Tepelenë. Plani thekson domosdoshmërinë që zonat urbane të kesaj Njësie Vendore të furnizohen në mënyrë ekskluzive dhe të konsumojnë vetëm prodhime lokale bujqësore dhe blegtorale, duke krijuar në këtë mënyrë elementët e traditës, që është dhe thelbi i suskesit të agrobiznesit.




*fig 23 - Pozicioni strategjik i propozuar për ferme blegtorale pranë fshatrave Dukaj dhe Turan*

Zhvillimi i strukturave agroturistike, nuk mbështetet vetëm në avantazhet natyrore dhe rurale, traditën dhe kulturën e një zone, por i nevojitet edhe nevoja për zhvillimin e strukturave mbështetëse, të cilat rrisin aktivitetin ekonomik, shkurtojnë zinxhirin tregtar, ku prodhuesi lokal i ofron produktet e tij konsumatorit dhe garantojnë në mënyrë të qëndrueshme frekuentimin e zonës, falë produkteve cilësore bujqësore dhe turistike.

Përveç agroturizmit, një sektor me vlerë ekonomike që duhet të gjejë mundësi zhvillimi në territorin e Bashkisë Tepelenë është edhe **ekoturizmi**. Ky term i referohet aktiviteteve që kanë të bëjnë me promovimin dhe zhvillimin e degëve të turizmit të "gjelbër", i fokusuar në elementët karakteristikë të natyrës së Bashkisë Tepelenë, elementëve të veçantë të ekosistemeve lumore të Vjosës apo Bënçës, ekosistemeve kodrinore dhe malore të Kurveleshit, Kendrevices, etj, monumentet e natyrës, tipareve lokale të florës dhe faunës, kopshte ekologjike, hapësirat e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale ekologjike ose "bio", rezervat natyrore urbane, etj. Pozicioni gjeografik dhe morfologjia e relievit të Bashkisë Tepelenë ofron realisht shumë mundësi për zhvillimin e këtij sektori, i avantazhuar edhe nga ekzistenca e akseve rajonale dhe kombëtare të komunikimit, të cilat ofrojne një akses mjaft të mirë në këtë Njësi Vendore.

Përveç efekteve pozitive ekonomike, sektori i ekoturizmit, mbart në vetvete një rëndësi të konsiderueshme në sensibilizimin e opinionin publik vendas apo të huaj lidhur me domosdoshmërinë e ruajtjes së vlerave të habitateve natyrore. Në një kohë kur debati social

në të gjithë botën është thuajse tërësisht i fokusuar në mbrojtjen e mjedisit dhe në balancimin midis nevojës për zhvillim ekonomik me ekzigjencat e ekosistemeve të gjera natyrore, zhvillimi i ekoturizmit gjykohet si një ndërthurje e përsosur midis këtyre dy dinamikave, që ndryshe përkthehen zhvillim përmes natyrës.

Një nga elementët pozitive të këtij sektori është së ai nuk ka nevoja të mëdha për investime. Vizitorët e natyrës, të parqeve, monumenteve natyrore, korridoreve lumore, liqeneve etj, nuk kanë nevojë për sisteme komplekse infrastruktrash apo njësi akomodimi luksoze. Esenciale për këtë sektor në Bashkinë Tepelenë, ashtu si dhe në çdo njësi tjetër vendore, është mjedisi i pastër, jo i dëmtuar nga aktiviteti njerezor si dhe mundësi aksesi relativisht modeste. Gjithashtu, domosdoshmëri është nevoja për informacion të dedikuar për zona të ndryshme me vlera natyrore dhe peizazhistike.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë mbështet zhvillimin e sektorit të ekoturizmit, nëpërmjet rehabilitimit të terreneve të konsiderueshëm pyjore dhe natyrore, të cilat janë dhe zonat kryesore pritëse të fluksit të vizitorëve. Plani përcakton format e ndërhyrjes në këto zona, të specifikuara në tabelat e treguesve të territorit, ku fokusi kryesor është dhënë në rehabiltimin e hapësirave pyjore, zonave të degraduara apo terreneve pa frut. Gjithashtu, në planin e shërbimeve publike dhe në skemën e propozuar administrative, Plani i Përgjithshëm Vendor përcakton nevojat për riorganizimin e strukturave të emergjencave, dhe konkretisht atë të mbrojtjes nga zjarret në të gjithë territorin e Bashkisë. Gjithashtu, Plani përcakton zhvillimin e infrastrukturës së dedikuar komunikues për këtë lloj aktiviteti, dhe konkretisht të itinerareve të posaçëm, të cilët ndjekin gjurmët dhe linjat ekzistuese të terreneve natyrore, kodrinore dhe malore të Bashkisë Tepelenë.

Zhvillimi i sektorit të turizmit kulturor është një tjetër mundësi që mund të gjejë zhvillim në territorin e Bashkisë Tepelenë. Përveç kalave dhe disa banesave me vlerë kulturore dhe arkitektonike, Plani thekson rëndësinë e vlerësimit dhe promovimit të vlerave kulturore të luajtshme, duke përmendur këtu etnografinë, folklorin, kulinarinë, etj. Kësisoj, Plani thekson rolin mbështetës që Bashkia Tepelenë duhet të luaje rolin e vetë në këtë drejtim.

Konkretisht, studimi, projektimi dhe zhvillimi i PDV've, jo vetëm në qytetin e Tepelenës, duhet të marrë në konsideratë krijimin e destinacioneve kulturore brenda. Në rastin e qytetit të Tepelenës, Plani e gjykon si të domosdoshëm rikonstruksionin e plotë të muzeut etnografik. Projekti duhet të synojë përmirësimin e parametrave fizikë të godinës së muzeut, riorganizimin e ambienteve të brendshme të ekspozimit, si dhe kualifikimin e mjediseve të jashtme. Qëllimi final i projektit do të jetë përfshirja e suksesshme e këtij objekti në paketën turistike kulturore të Bashkisë Tepelenë, të kombinuar me Kalanë e qytetit si dhe me destinacionet e spikatura kulturore në të gjithë territorin administrativ.

Duke iu referuar analizës së dokumentit të Strategjisë Territoriale, Plani thekson nevojën për ndërtimin e muzeut etnografik të Kurveleshit. Bazuar në historinë e fshatrave të kësaj krahine si dhe në kuadër të propozimit strategjik për zhvillimin e turizmit në këtë zonë të Tepelenës,

qëllimi final i projektit është të rrisë numrin e destinacioneve turistike për vizitoret e zonës, dhe si rrjedhim, të ardhurat për komunitetin lokal dhe Bashkisë. Gjithashtu, në kuader të zhvillimit të turizmit kulturor propozohet r**estaurimi i shtëpisë së Ali Pashë Tepelenës në fshatin Beçisht.** Ky projekt synon të përfshijë në paketën turistike të Tepelenës shtëpinë e lindjes së personazhit më të shquar të historisë së trevave të Tepelenës[1] dhe jo vetëm. Gjithashtu propozohet **restaurimi i kishave të Leklit**. Ky projekt integrohet më së miri edhe me propozimin për zhvillimin e itinerarit turistik fshat Koder, Lekël, Hormovë, të propozuar në vazhdim në dokumentin strategjik[2].




*fig 24 – pamje ballore e muzeut etnografik te qytetit te Tepelenës*

Një tjetër projekt strategjik i propozuar edhe në kuadër të Strategjisë Territoriale është **restaurimi i shtëpisë së Selam Musait në fshatin Salari**. Ky projekt përbën ndoshta të vetmin element potencial kulturor për zonën e Salarisë, dhe propozohet të përfshihet në paketën e zhvillimit të produkteve turistike të Tepelenës[3].



*fig 25 - Pamje e gjendjes fizike ekzistuese të shtepise së Selam Musait në fshatin Salari.*

[1] *Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës*
[2] *Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës*
[3] *Ky projekt është kompetencë e Ministrisë së Kulturës*



*fig 26 – pamje e shtepise se Selam Musait, pas procesit te restaurimit dhe muzealizimit, ne fshatin Salari*

Në terma ekonomikë turizmi kulturor përbën rreth 8% - 20% të produktit të përgjithshëm turistik. Për këtë qëllim, Bashkia Tepelenë duhet të kombinojë elementët e turizmit natyror si dhe atë të agroturizmit, me hedhjen e hapave të parë drejt zhvillimit të produkteve të turizimit kulturor në territorin e vet. Mbështetja dhe promovimi trashëgimisë materiale dhe jo materiale shfaqet si një nevojë për të tërhequr vizitorë dhe krijimin e destinacioneve turistike me vlera kulturore.

Zhvillimi i turizmit kulturor ka si nevojë në radhë të parë ruajtjen dhe përmirësimin e aksesit dhe vizitës së monumenteve të kulturës. Në këtë kontekst restaurimi dhe mirëmbajtja e monumenteve të trashëgimisë kulturore është tejet e rëndësishme për zhvillimin e këtij lloj produkti. Vizita e monumenteve kulturore, është një nga aktivitetet kryesore të vizitorëve të tërhequr nga aspekti kulturor. Por, që produkti i turizmit kulturor të zhvillohet në mënyrë koherente ështe e nevojshme që këto monumente të promovohen. Krahas restaurimit të monumenteve të kulturës është e nevojshme të ofrohet një sinjalistikë shpjeguese dhe orientuese për monumentet e kulturës, të cilat synojnë të promovojnë kulturën lokale dhe rrisin interesin e vizitorëve në zonë.

### 1.1.5.2 MODELE TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT RURAL NË TEPELENË

Në kuader të programit kombëtar "100 fshatrat" në Bashkinë Tepelenë janë identifikuar dy fshatrat dhe zonat natyrore perreth të Nivicës dhe Peshtanit, si dy destinacione të mirefillta dhe modele të zhvillimit të turizmit rural në territorin e kesaj Njësie Vendore.

Qëllimi i kryesor i programit është krijimi i modeleve të zhvillimit të qendrueshem të ekonomive rurale të ketyre dy fshatrave, permes promovimit të formave alternative të turizmit, orientimit të investimeve në mbështëtje të vlerave historike, arkitektonike, natyrore dhe sociale. në këtë mënyrë, këto fshatra do të mund të kthehen në shembuj referues për mënyrën e investimit dhe ndërhyrjeve fizike, mënyrat e trajtimit të hapesirave publike dhe tipologjive arkitektonike, mbrojtjen dhe riperteritjen e mjedisit, etj.




*fig 27 – skeme koncept i ndërhyrjes në strukturen ndertimore të Nivicës*

Ne vitin 2018, me promovimin e Bashkisë Tepelenë dhe Agjencise Kombëtare të bregdetit, në fshatin Nivicë u krye nje studim i detajuar hapesinore e struktures urbane historike, duke identifikuar nje metodologji potenciale ndërhyrjeje. Ndërkohë, në vitin 2018 është finalizuar ndërhyrja fizike në sheshin e qendres së fshatit, permes adoptimit të teknikave autentike të ndertimit, tipologjise rurale të ndertesave dhe hapesirave si dhe përdorimit të gurit të zones

si element kryesor karakteristik i ndërhyrjes. Suksesi i kesaj ndërhyrjeje ka krijuar nje premise shume të mire edhe për fshatrat e tjere të zones së Kurveleshit por edhe me tej.

Sheshi i rinovuar i fshatit është transfomuar në qendrën publike të Nivicës, ku infrastruktura tregtare dhe sociale ofron një hapësirë të gjerë dhe të hapur për banorët dhe vizitorët. Kjo ndërhyrje mundesoi organizimin për here të pare në këtë fshat të nje panairi të hapur "Pan", aktivitet i cili pati nje jehone të gjere në rajonin juglindor të Shqipërise por edhe me gjere.
Ne përfundim të procesit, bazuar edhe në metodologjine e sheshit të fshatit, janë specifikuar disa udhëzime arkitektonike për rindërtimin potencial të objekteve të fshatrave malore të Bashkisë Tepelenë, të cilat mund të replikohen me sukses duke u bazuar në tipologjine e çdo vendbanimi. Konkretisht rekomandohet:

- Përdorimi i materialeve të njëjta që janë përdorur gjatë epokës së ndërtimit të çdo ndërtese.
- Përdorimi i pllakave të gurit të përdorura në çatinë e ndërtesave më të rëndësishme të vjetra, ndërkohë që për ndertesat e reja rekomandohen pllaka argjile të kuqe në ndërtesa të reja
- Përdorimi i gurit për fasadën; asnjë hapje e dritareve të reja.
- Hyrja (portiku) duhet të ruhet me të njëjtin material si pjesa tjetër e ndërtesës. Dritaret e dritareve duhet të ruhen në dru.
- Mbrojtja e detajeve të çatisë pasi ato tregojnë epokën në të cilën u ndërtua ndërtesa.


*fig 28 – pamje e sheshit te rikonstruktuar te Nivicës*


*fig 29 – tipologjia e baneses se gurit*

**1.1.5.3 ZHVILLIMI URBAN**

Bazuar në dokumentin e Strategjisë të hartuar për Bashkinë Tepelenë, Plani thekson nevojën për zbatimin me rigorozitet të projekteve të listuara sipas ***"Drejtimi Strategjik 1** - Kualifikimi i parametrave territorialë të Bashkisë Tepelenë në funksion të orientimit të rritjes urbane dhe levizjeve demografike në të ardhmen;"*

Synimi i parë kryesor i kësaj qasjeje strategjike është orientimi gradual i <u>rritjes së ardhshme urbane të Bashkisë drejt territoreve të qytetit të Tepelenës</u>, nëpërmjet promovimit dhe mbështetjes së inicativave të zhvendosjes së popullsisë së zonave periferike drejt qendrës. Ky

synim bazohet në principin e ekonomisë së shkallës, përcaktuar edhe në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, sipas të cilit, popullsia minimale që duhet të këtë një qendër urbane për të qënë e vetë-qëndrueshme është 30,000 banorë. Koncepti i vetë-qëndrueshmërisë ka të bëjë, në rradhë të parë, me aftësinë e një qëndre urbane për ti ofruar mundësi banorëve të saj që të ndërmarrin dhe të administrojnë sipërmarrje private, financiarisht rentabël. Nga ana tjetër, administrata publike e një qëndre urbane me një popullsi sipër limitit të përcakatuar prej 30,000 banorësh, ka mundësi që të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme fiskale që të përballojë kërkësat për shërbime dhe infrastrukturë.




*fig 30 – masterplani i propozuar i fshatit Nivicë si model ndërhyrjeje*

Megjithëse mund të vlerësohet si një proces disi radikal nga pikëpamja e marrëdhenies së individit me vendbanimin, procesi i urbanizimit, i përkthyer në terma praktikë si zhvendosja e popullsisë rurale drejt qendrave urbane, është provuar të jetë e vetmja alternativë në kushtet aktuale e cila garanton mundësi të rritjes ekonomike dhe sociale. Një Bashki e vogël, me një numër të ulët të popullsisë dhe të shpërndarë në shumë nukle të vogla rurale, të vendosura këto në distance të konsiderueshme nga njera tjetra, e ka praktikisht të pamundur që të garantojë shërbime dhe infrastruktura me cilësi dhe rentabilitiet nga pikëpamja financiare. Sasia e të ardhurave vendore që gjeneron një Bashki e tillë nga taksat vendore është potencialisht mjaft e vogël për të mbuluar nevojën e vazhdueshme për investime publike.

Kësisoj, një Bashki e tillë e vogël do të varet gjithnjë nga burimet alternative të financimit, që në shumicën e rasteve do të jenë financimet e qeverisë qëndore. Kjo situatë e vendos këtë Njësi Vendore në status **Jo-Rentabël**, duke bërë që qarkullimi i parasë publike dhe konkretisht i zbatimit të investimeve publike nga qeveria qëndrore, mjaft të domosdoshme për mirëqënien e banorëve, të jetë gjithnjë e ndikuar nga situata makro-ekonomike në nivel kombëtar si dhe nga balancat politike.



*fig 31- pamje 3-dimensionale e propozuar e qendres së Nivicës*

Plani thekson rëndësinë strategjike për ri-organizimin e strukturave urbane të Bashkisë Tepelenë, nëpërmjet:

- Rritje e sipërfaqes urbane të qytetit, kryesisht në pjesën veriore (zonën fushore) duke akomoduar rritjen e popullsisë prej 20%.
- Ruajtjen dhe konsolidimin e njollave urbane të fshatrave të Njësisë Kurvelesh, sipas kufijve ekzistues., duke shtuar elemente infrastrukturore që kanë të bëjnë me strukturat akomoduese potenciale për turizmin malor.
- Tkurrjen graduale të njollave urbane të zonave rurale periferike, duke garantuar nivelin e shërbimeve dhe infrastrukturave bazë të nevojshme.

Mëgjithë numrin e ulët të popullsisë në nivel qyteti apo në nivel Bashkie, Tepelena ka mundësi të mira që të vendosë një trend rritës demografik për vitet në vazhdim, duke marrë në konsideratë pozicionin gjeografik mjaft favorizues të qytetit. Kësisoj, drejtimi i parë strategjik i propozuar në dokumentin e Strategjisë Territoriale synon pikërisht që të orientojë tendencat afatgjata të lëvizjeve demografike në këtë Njësi Vendore, duke përcaktuar projekte konkrete të cilat mund të japin formë dhe të orientojnë këto tendenca. Gjithsesi, ajo që duhet theksuar në këtë rast është fakti që lëvizjet apo zhvendosjet demografike, jo vetëm në Bashkinë Tepelenë, janë dhe duhet të jenë rezultat i iniciatives private të lirë të banorëve. Pra, janë vetë banorët ata që do të vendosin nëse duhet apo jo të qëndrojnë në vendbanimin e tyre apo të zhvendosen drejt një qendre të re. Në këtë logjikë, Bashkia Tepelenë si institucion ka një rol promovues dhe mbështetës, dhe kurrsesi detyrues.




*fig 32 - Skema e transformimeve strategjike demografike në Bashkinë Tepelenë*

Synimi i dytë nëpërmjet artikulimit të drejtimit të parë strategjik të propozuar është që, përveç rritjes fizike të territoreve dhe popullsisë së qytetit të Tepelenës, të konsolidohen territoret e banuara të Njësise së Kurveleshit, duke evituar rënien e mëtejshme të popullsisë së kësaj krahine. Kjo qasje lidhet me potencialin që ka krahina dhe fshatrat e Kurveleshit për zhvillimin e turizmit natyror malor si dhe turizmin e aventurës. Ky potencial ka marrë një dinamikë të madhe kohët e fundit, kryesisht në kuadër të finalizimit të investimit nga ana e

qeverisë qëndrore për rikonstruksionin e rrugës Tepelenëë-Bënçë-Nivicë. Gjithashtu, sipas të dhënave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ky korridor i ri do të pasohet me zgjatimin e tij drejt fshatit Kuç, për të dale më pas në bregdet.

Kësisoj, me përfundimin e këtij projekti të rëndësishëm rajonal, zona e Kurveleshit do të gjendet e pozicionuar përgjatë një korridori me një potencial tërësisht të rivitalizuar, të konsideruar si nga më të bukurit dhe panoramikët e Shqipërisë Jug-Perëndimore. Në këtë kontekst, Strategjia Territoriale e Bashkisë Tepelenë propozon ruajtjen dhe përmirësimin e strukturës urbane ekzistuese të të gjithë fshatrave të kësaj krahine, për të mbështetur dhe motivuar kështu ruajtjen e numrit të popullsisë ekzistuese.

Strategjia Territoriale e Bashkisë Tepelenë e vlerëson si mjaft të rëndësishme përfshirjen e strukturave urbane të fshatrave të Kurveleshit në proceset e zhvillimit të programeve dhe projekteve turistike, në sinkron me metodologjinë e përdorur në Programin Kombëtar "Akademia 100 Fshatrat". Eshtë pikërisht kjo metodologji ndërhyrjeje, e cila propozohet që të replikohet në mënyrë të sukseshme edhe në fshatrat e tjerë të krahinës së Kurveleshit.

### 1.1.6 ZHVILLIMI I I NJËSIVE QË DO TË JENË SUBJEKT I PLANEVE TË DETAJUARA VENDORE.

#### 1.1.6.1 MËNYRAT E PROPOZUARA TË NDËRHYRJES

Lloji i zhvillimit ose kufizimit të zhvillimit në zona të caktuara të Bashkisë Tepelenë, reflekton në mënyrë indirekte objektivat që duhet të arrihen nëpërmjet ndërhyrjes së propozuar në zonën përkatëse. Vetë termi i përdorur në këtë rast pasqyron efektin e pritshëm të një ndërhyrje të propozuar. Në përputhje me metodologjinë e miratuar sipas kuadrit ligjor në fuqi për planifikimin e territorit, ndërhyrjet e propozuara në Njësitë Strukturore të Bashkisë Tepelenë do të kenë formulimet si në vazhdim:

**a) Rigjenerim/ Ripërtëritje:** procesi i përmirësimit të kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori apo ndërtimi.
**b) Dendësim:** procesi i rritjes së dendësisë së ndërtimit në një territor të caktuar.
**c) Konsolidim:** procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës e të strukturës urbane ekzistuese, duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara.
**d) Urbanizim:** procesi i ndërhyrjes në territor nëpërmjet zhvillimeve të reja, i cili sjell ndryshime të strukturës së popullsisë dhe territorit, në funksion të rritjes së sistemit urban.
**e) Rizhvillim:** procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një territori, i cili është i ndërtuar, por i degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore.
**f) Konservim:** procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar në formën e tij ekzistuese/aktuale.




*fig 33 - Harta e Njësive Strukturore të parashikuar për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore*

### 1.1.6.2 NJËSITË QË DO TË ZHVILLOHEN ME PDV

Metodologjia për përgatitjen e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë është bazuar në një vlerësim të detajuar të të gjithë elementëve territoriale, duke respektuar strukturën dhe terminologjinë e Rregullores së Planifikimit të Territorit. Sipas këtij instrumenti ligjor, e gjithë hapësira administrative e Bashkisë Tepelenë është konceptuar dhe ndarë në Njësi Strukturore përkatëse, për një pjesë të konsiderueshme të të cilave, Plani parashikon

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA

hartimin e Planeve të Detajuara Vendore (PDV). Për përcaktimin e Njësive Strukturore për hartimin e PDV, janë marrë në konsideratë kriteret si më poshtë vijon:

a. Hapësira e përcaktuar si Njësi Strukturore përfshin territore me përdorime bujqësore ose natyrore, të cilat planifikohen të konvertohen në territore të klasifikuara në kategori apo nënkategori të Sistemit Urban.
b. Hapësira e Njësisë Strukturore përfshin hapësira urbane të degraduara apo me tregues të ulët urban, të cilat do të jenë subjekt i programeve të Rizhvillimit/Urbanizimit, referuar përcaktimeve të mënyrave të ndërhyrjes.
c. Hapësira e Njësisë Strukturore së dhënë ka një përdorim të propozuar, i cili është i ndryshëm apo i papërputhshëm për përdorimet ekzistuese në njësitë strukturore kufitare;
d. Në hapësirën e Njësisë Strukturore të dhënë planifikohet zhvillimi i një projekti të rëndësishëm publik për Bashkinë Tepelenë, si impianti i pastrimit të ujërave të zeza, terminali multimodal, etj.

Kur njësitë e mësipërme janë pjesë e Zonave të Rëndësisë Kombëtare, referuar kuadrit ligjor ekzistues, çdo ndërhyrje zhvillimore duhet të paraprihet nga hartimi Plani i Detajuar i Zones së Rëndësisë Kombëtare (PDZRK).

Ne territorin e Bashkisë Tepelenë janë përcaktuar nje numër prej 27 Njësi Strukturore për të cilat do të jetë e nevojshme përgatitja e Planeve të Detajuara Vendore. Këto Plane do të përgatiten në referencë me treguesit përkatëse të bilancit të territorit, të listuar sipas pasaportave të çdo Njësie, në fund të Rregullores së Planit.

| Nr | SISTEMI | ZONA | Njesia | Sip Ha | Kategori_1 | Menyra e nderhyrjes | Fazat e Zhvillimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Urban | TP_UB_A_101 | TP_UB_A1_101/1 | 14.72 | A.Banim | Urbanizim | Afatgjate (+10 vjet) |
| 2 | Urban | TP_UB_A_101 | TP_UB_A1_101/2 | 11.84 | A.Banim | Urbanizim | Afatgjate (+10 vjet) |
| 3 | Urban | TP_UB_A_101 | TP_UB_A1_101/3 | 8.01 | A.Banim | Urbanizim | Afatgjate (+10 vjet) |
| 4 | Urban | TP_UB_A_112 | TP_UB_A1_112/1 | 2.47 | A.Banim | Urbanizim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 5 | Urban | TP_UB_A_112 | TP_UB_A1_112/6 | 2.24 | A.Banim | Urbanizim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 6 | Urban | TP_UB_A_112 | TP_UB_A1_112/2 | 8.93 | A.Banim | Urbanizim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 7 | Urban | TP_UB_A_112 | TP_UB_A1_112/3 | 13.11 | A.Banim | Urbanizim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 8 | Urban | TP_UB_A_141 | TP_UB_A1_141/1 | 4.56 | A.Banim | Konsolidim | Afatgjate (4-10 vjet) |
| 9 | Urban | TP_UB_IE_144 | TP_UB_IE3_144/2 | 1.63 | IE.Industri Ekonomi | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 10 | Urban | TP_UB_IE_152 | TP_UB_IE1_152/1 | 8.45 | IE.Industri Ekonomi | Konsolidim | Afatgjate (+10 vjet) |
| 11 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A2_154/2 | 1.78 | A.Banim | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 12 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_S1_154/38 | 0.53 | S.Shërbime | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 13 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A2_154/3 | 6.86 | A.Banim | Konsolidim | Afatgjate (4-10 vjet) |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A1_154/5 | 4.14 | A.Banim | Konsolidim | Afatgjate (4-10 vjet) |
| 15 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A2_154/34 | 1.11 | A.Banim | Rizhvillim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 16 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A2_154/7 | 0.63 | A.Banim | Rizhvillim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 17 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A2_154/13 | 2.41 | A.Banim | Konsolidim | Afatgjate (4-10 vjet) |
| 18 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_M1_154/19 | 8.22 | M.Monumente | Konservim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 19 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_IE3_154/21 | 5.10 | IE.Industri Ekonomi | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 20 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_AR1_154/22 | 7.53 | SHA.Aktivitete Shoqerore & Argëtimi | Rigjenerim | Afatgjate (4-10 vjet) |
| 21 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_IE3_154/23 | 11.60 | IE.Industri Ekonomi | Konsolidim | Afatgjate (4-10 vjet) |
| 22 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A2_154/25 | 7.65 | A.Banim | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 23 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_IE3_154/26 | 1.55 | IE.Industri Ekonomi | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 24 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_A2_154/27 | 5.71 | A.Banim | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 25 | Urban | TP_UB_A_154 | TP_UB_S1_154/30 | 1.86 | S.Shërbime | Konsolidim | Afatmesem (1-3 vjet) |
| 26 | Urban | TP_UB_A_167 | TP_UB_A1_167/1 | 8.99 | A.Banim | Urbanizim | Afatgjate (+10 vjet) |
| 27 | Urban | TP_UB_A_167 | TP_UB_A1_167/3 | 23.06 | A.Banim | Urbanizim | Afatgjate (+10 vjet) |

*fig 34 - Tabela e Njësive Strukturore të planifikuara për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore*

Ne tabelen me sipër janë listuar të gjitha Njësite për të cilat do të hartohet PDV. Njësite janë rradhitur sipas fazave kohore të hartimit të tyre, duke respektuar metodologjine zyrtare të përcaktimit të afateve. Ndërkohë duhet permendur fakti që nje pjesë e konsiderueshme e Njësive që konturojne zona banimi rurale periferike nuk janë evidentuar si subjekt PDV. në këto raste, adresimi i kerkesave për zhvillim do të behet nepermjet lejeve të zhvillimit, duke ruajtur treguesit urbanistike të përcaktuar në pasaporten e Njësise përkatëse, dhe konkretisht ato tregues që kane të bejne me permasat e parcelës, dendesine, tipologjine dhe si dhe llojin e zhvillimit.

Ndërkohë, për sa i perket distancave do të respektohen kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Planit si dhe në dokumentin ligjor të Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

### 1.1.7 SHPËRNDARJA E POPULLSISË NË TERRITORIN E BASHKISË TEPELENË

Analiza demografike dhe prognoza e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë ka marrë në konsideratë një sërë faktorësh kompleks, të vlerësuar me kujdes gjatë analizës së përgjithshme të territorit. Më pas këto përfundime janë trajtuar gjatë fazës së hartimit të Strategjisë Territoriale, në të cilën janë përcaktuar tendencat e zhvillimit demografik të Bashkisë në 15 vitet në vazhdim. Përgjatë këtij procesi janë identifikuar zonat e rritjes si dhe

zonat e rënies potenciale të popullsisë, dhe ky lloj trajtimi është shtrirë në çdo fshat të Njësive Administrative. Koefiçienti i ndryshimit rritës apo zbritës është marrë 0.5% në vit, që është gjykuar si vlerë e pranueshme dhe që mund të realizohet për të gjitha vendbanimet e Bashkisë Tepelenë

| **Shpërndarja e popullsisë në territorin e Bashkisë Tepelenë, sipas Njësive Administrative dhe fshatrave përkatës - Tetor 2019** | | | | | | **Prognoza e Popullsisë për 2034** | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Grup Moshat | | | | | | | |
| | | **TOTAL** | **0-14** | **15-64** | **65+** | **TOTAL** | **0-14** | **15-64** | **65+** |
| **NJËSIA ADMINISTRATIVE** | **KURVELESH** | **705** | **141** | **442** | **122** | **760** | **152** | **476** | **132** |
| **KURVELESH** | **LEKDUSH** | 61 | 12 | 38 | 11 | **66** | 13 | 41 | 12 |
| | **PROGONAT** | 335 | 66 | 209 | 60 | **361** | 71 | 225 | 65 |
| | **GUSMAR** | 129 | 25 | 81 | 23 | **139** | 27 | 87 | 25 |
| | **REXHIN** | 48 | 9 | 30 | 9 | **52** | 10 | 33 | 10 |
| | **NIVICË** | 132 | 25 | 82 | 25 | **142** | 27 | 88 | 27 |
| | | | | | | | | | |
| **NJËSIA ADMINISTRATIVE** | **LOPËS** | **723** | **138** | **487** | **98** | **622** | **119** | **419** | **84** |
| **LOPËS** | Sinanaj | 120 | 23 | 81 | 16 | **103** | 20 | 70 | 14 |
| | Matohasana j | 272 | 52 | 184 | 36 | **234** | 45 | 158 | 31 |
| | Dorez | 14 | 3 | 9 | 2 | **12** | 3 | 8 | 2 |
| | Dhëmblan | 212 | 45 | 136 | 31 | **182** | 39 | 117 | 27 |
| | Lab Martalloz | 105 | 22 | 67 | 16 | **90** | 19 | 57 | 14 |
| | | | | | | | | | |
| **NJËSIA ADMINISTRATIVE** | **QENDËR (TEPELENË)** | **3179** | **616** | **2086** | **477** | **3220** | **624** | **2113** | **483** |
| **QENDËR (TEPELENË)** | Dukaj | 429 | 83 | 281 | 65 | **462** | 89 | 303 | 70 |
| | Salari | 184 | 36 | 120 | 28 | **171** | 33 | 111 | 26 |
| | Turan | 198 | 39 | 129 | 30 | **213** | 42 | 139 | 32 |
| | Mamaj | 127 | 25 | 83 | 19 | **137** | 27 | 89 | 20 |
| | Veliqot | 449 | 88 | 294 | 67 | **484** | 95 | 317 | 72 |
| | Bençe | 238 | 47 | 156 | 35 | **256** | 51 | 168 | 38 |
| | Dragot | 322 | 64 | 211 | 47 | **347** | 69 | 227 | 51 |
| | Beçisht | 104 | 21 | 68 | 15 | **96** | 19 | 63 | 14 |
| | Mezhgoran | 210 | 42 | 138 | 30 | **195** | 39 | 128 | 28 |
| | Peshtan | 131 | 26 | 86 | 19 | **122** | 24 | 80 | 18 |
| | Hormovë | 350 | 70 | 230 | 50 | **325** | 65 | 213 | 46 |
| | Lekël | 45 | 9 | 30 | 6 | **48** | 10 | 32 | 6 |
| | Koder | 143 | 29 | 95 | 19 | **133** | 27 | 88 | 18 |
| | Luzat | 249 | 50 | 165 | 34 | **231** | 46 | 153 | 32 |
| | | | | | | | | | |
| **QYTET TEPELENË** | **QYTET TEPELENË** | **4342** | **801** | **2970** | **571** | **5844** | **1078** | **3997** | **769** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TOTAL | | 8949 | 1696 | 5985 | 1268 | 10446 | 1973 | 7006 | 1468 |

*fig 35 - Tabela e prognozës demografike Tepelenë 2034*

Duke iu referuar vlerësimit të detajuar të çdo njësie banimi në Bashkinë Tepelenë, Plani i Përgjithshëm Vendor llogarit që në vitin 2034, kjo Njësi Vendore do të ketë një popullsi totale prej 10446 personash, të klasifikuar sipas tre grupmoshave. Kjo ndarje e detajuar krijon mundësi për planifikimin sa më të saktë të nevojave për infrastruktura dhe shërbime publike të çdo vendbanimi, nga ana e administratës së Bashkisë.

### 1.1.8 PLANI I STREHIMIT

Analiza e nevojave të strehimit në Bashkinë Tepelenë është bazuar në të dhënat e gjendjes ekzistuese të popullsisë së pastrehë në këtë njësi vendore. Referuar Vendimit Nr. 28, datë 29 Mars, 2019, Këshilli Bashkiak Tepelenë ka miratuar listën e përditësuar të familjeve të pastreha, për të cilat është akorduar bonus i posaçëm strehimi. Sipas këtij vendimi, në Bashkinë Tepelenë në vitin 2019, evidentohen rreth 32 subjekte që kanë nevojë për strehim, kryesisht në territorin e qytetit teë Tepelenëës. Megjithatë, ky numër ende mund të gjykohet si i ulët, po të merret në referencë e gjithë shtrirja territorale e hapësirave të banuara të Bashkisë, për të cilin ka dy argumente kryesore:

- Familjet në vështirësi ekonomike, dhe në statusin "e pastrehë" për një kohë të gjatë gjatë këtyre viteve kanë preferuar të migrojne nga Bashkia Tepelenë,
- Niveli i lartë i migrimit ka bërë që në Bashkinë Tepelenë, si në qytet por edhe në territoret urbane periferike, të ketë mjaft njësi banimi bosh, në të cilat janë akomoduar familjët në nevojë strehimi, në marrëveshje me familjarët e tyre tashmë të larguar;

Megjithatë, referuar kritereve ligjore në fuqi, Plani i Përgjithshëm Vendor ka detyrimin që të parashikojë parametra bazë për Strehimin Social në Bashkinë Tepelenë. Këto kritere janë në referencë me Ligjin Nr.22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar. Lidhur me parametrat, kriteret dhe kerkesat teknike për strehimin social, PPV i Bashkisë Tepelenë është bazuar në kriteret e Ligjit të cituar, ku përcaktohen rregullat, procedurat si dhe metodologjia e planifikimit dhe administrimit të programeve sociale për strehimin, për të garantuar privatësi dhe siguri të individi. Objekti i strehimit duhet të sigurojë hapësira të mjaftueshme sipas standarteve, shërbimet bazë, siguri ndaj rreziqeve si dhe akses të përshtatshëm ndaj infrastrukturave dhe shërbimeve publike.

Sipas nenit 73 të Ligjit të cituar, Bashkia është përgjegjëse për zbatimin e politikave të strehimit në territorin që ajo administron. Për këtë arsye, Bashkia Tepelenë ka si detyrim:

- Identifikimin e nevojave për strehim;
- Hartimin e programeve 5-vjeçare për strehimin;
- Përcaktimin e zonave specifike brenda territorit në administrim, për zbatimin e programeve të strehimit;

- Evidentimin e banesave në rrezik shembjeje dhe përgatitjen e listës së tyre;
- Hartimin në mënyrë periodike të raportit të strehimit, duke perfshire nevojat për financime dhe subvencione nga buxheti i shtetit;
- Hartimin e planit të veprimit dhe projekt-buxhetin përkatës;

Për sa i përket fondit të banesave sociale, PPV i Bashkisë Tepelenë bazohet në kategorizimin ligjor të banesave të këtij lloji, dhe konkretisht:

- **"Banesë Sociale me Qira"** është banesa që jepet me qira, në pronësi publike apo private, që vihet në dispozicion të programit të banesave sociale me qira;
- **"Banesë me Kosto të Ulët"** është banesa që ndërtohet dhe që vihet në dispozicion të programeve të strehimit;
- **"Banesë e Përkohshme"** është banesa e dedikuar në kushtet e në kushtet e emergjencës së strehimit të individëve të pastrehë ose që kanë nevojë për strehim të menjëhershëm
- **"Banesë e Specializuar"** është banesa e përshtatur për të plotësuar nevojat funksionale, shëndetësore dhe të sigurisë fizike për grupet në nevojë.

Fondi i banesave sociale, sipas klasifikimit të mësipërm duhet të jetë në pronësi dhe administrim të institucionit të Bashkisë Tepelenë, dhe do të krijohen si rezultat i:

a) ndërtimeve të reja të dedikuara për banesat sociale;

b) blerje të banesave në treg të lirë ose pas ankandit të parë të banesave që shiten sipas parashikimeve të nenit 557 të Kodit të Procedurës Civile.

Ligji specifikon së nëse programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe nëse Bashkia (Tepelenë) nuk arrin të përmbushë detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme, zbatimi i programeve të strehimit për afatin e marrëveshjes i kalon ministrisë përgjegjëse për strehimin.

Ligji i cituar përcakton detyrimin eksplicit që **"çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, pra dhe Bashkia Tepelenë, të parashikojë në territorin që ka nën juridiksion, në përputhje edhe me planet vendore, sipërfaqen e truallit për ndërtimin e një numri të mjaftueshëm banesash sociale, bazuar në nevojat për strehim që evidentohen"**. Duke iu referuar nevojes së ulet për banesa sociale, Plani specifikon që kjo kerkese të adresohet prej Bashkisë Tepelenë permes skemave sociale të strehimit. Në terma teknikë, kjo e fundit mund ti realizojë këto projekte në:

- troje që janë pronë e shtetit ose private.
- zonat me ndërtime të palegalizuara, që nuk mund të legalizohen;
- zona me ndërtime të papërfunduara dhe të braktisura nga ndertuesit
- objekte të vjetra industriale, jofunksionale, të zëna nga individë të pastrehë, pa autorizime përkatëse për strehim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration

Ndërkohë, neni 19 i Ligjit përcakton detyrimin ligjor për ndërtimet me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, në të cilat detyrohet kalimi pa shpërblim të **të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale**, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale të çdo njësie vendore në territorin e të cilës kryhet zhvillimi. Në këtë rast, Bashkia Tepelenë është përgjegjëse për zbatimin rigoroz të këtij kriteri ligjor

Një element me rëndësi që trajton Ligji për Strehimin Social, dhe që është mjaft relevant në Bashkinë Tepelenë, ka të bëjë me programin për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore, të cilat mund të konvertohen dhe të përfshihen në fondin e banesave sociale. Këtu përfshihen:

a) objektet/banesat në rrezik shëmbjeje;

b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

Për shkak të largimit të popullsisë gjatë viteve të fundit, në Bashkinë Tepelenë evidentohet një numër i madh objektesh të braktisura.

Përveç zhvillimit të zonave specifike të strehimit social, Bashkia Tepelenë, duke iu referuar Ligjit të cituar, ka për detyrim hartimin dhe miratimin e programit 5 vjeçar të strehimit social.

Ky program, i cili përgatitet dhe miratohet në mënyrë periodike, duhet të përmbajë:

- burimet e financimit;
- nevojat për strehim në Bashkinë Memaliaj, sipas grupet e familjeve, të ardhurave dhe gjëndjes së tyre sociale;
- numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira, uzufrukt ose huapërdorje;
- numrin e përfituesve të banesa me kosto të ulët;
- mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;
- masën e subvencionimeve;
- trojet e pajisura me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash sociale, si dhe familjet që do të përfitojnë;
- numrin e strehëve të përkohshme dhe të banesave të specializuara që do të ndërtohen ose do të vihen në dispozicion të përfituesve;
- numrin e banesave ekzistuese ose të reja, që do të përfitojnë nga programi i granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit;
- numrin e banesave që do të përfitohen si rezultat i zbatimit të programit për zhvillimin e zonave me qëllim strehimin, për banesa sociale;
- numrin, vendndodhjen dhe profilin e familjeve që jetojnë në banesa që nuk mund të legalizohen dhe që preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese.

Ndërkohë, neni 19 i Ligjit përcakton detyrimin ligjor për ndërtimet me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, në të cilat detyrohet kalimi pa shpërblim të **të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale**, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale të çdo njësie vendore në territorin e të cilës kryhet zhvillimi. Në këtë rast, Bashkia Tepelenë është përgjegjëse për zbatimin rigoroz të këtij kriteri ligjor

Një element me rëndësi që trajton Ligji për Strehimin Social, dhe që është mjaft relevant në Bashkinë Tepelenë, ka të bëjë me programin për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore, të cilat mund të konvertohen dhe të përfshihen në fondin e banesave sociale. Këtu përfshihen:

a) objektet/banesat në rrezik shëmbjeje;

b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

Për shkak të largimit të popullsisë gjatë viteve të fundit, në Bashkinë Tepelenë evidentohet një numër i madh objektesh të braktisura.

Përveç zhvillimit të zonave specifike të strehimit social, Bashkia Tepelenë, duke iu referuar Ligjit të cituar, ka për detyrim hartimin dhe miratimin e programit 5 vjeçar të strehimit social.

Ky program, i cili përgatitet dhe miratohet në mënyrë periodike, duhet të përmbajë:

- burimet e financimit;
- nevojat për strehim në Bashkinë Tepelenë, sipas grupet e familjeve, të ardhurave dhe gjëndjes së tyre sociale;
- numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira, uzufrukt ose huapërdorje;
- numrin e përfituesve të banesa me kosto të ulët;
- mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;
- masën e subvencionimeve;
- trojet e pajisura me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash sociale, si dhe familjet që do të përfitojnë;
- numrin e strehëve të përkohshme dhe të banesave të specializuara që do të ndërtohen ose do të vihen në dispozicion të përfituesve;
- numrin e banesave ekzistuese ose të reja, që do të përfitojnë nga programi i granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit;
- numrin e banesave që do të përfitohen si rezultat i zbatimit të programit për zhvillimin e zonave me qëllim strehimin, për banesa sociale;
- numrin, vendndodhjen dhe profilin e familjeve që jetojnë në banesa që nuk mund të legalizohen dhe që preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese.

ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planning - Architectural Restoration
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA

### 1.1.9 INSTRUMENTAT PËR DREJTIMIN E ZHVILLIMIT

Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, përfaqëson kornizën orientuese për një zhvillim të qëndrueshëme e të balancuar, nëpërmjet përcaktimit të parimeve bazë, përgjegjësive dhe rregullave për planifikimin e territorit. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë thekson rigorozitetin e nevojshëm në zbatimin e instrumenteve të përcaktuara ligjore për drejtimin e zhvillimit në territorin që administron. Këto instrumente do të jenë subjekt zbatimi, sipas rastit, gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore dhe sidomos gjatë hartimit dhe miratimit të lejeve zhvillimore dhe lejeve të ndërtimit në Bashkinë Tepelenë.

Bazuar ligjit të sipërcituar në vazhdim listohen edhe instrumentat për drejtimin e zhvillimit, gjatë procesit të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

- **Intensiteti i ndërtimit me kushte** - është instrumenti i zhvillimit të territorit që synon të sigurojë kontribut për financimin e investimeve kapitale në infrastruktura dhe shërbime publike, përfshirë programet sociale të strehimit, në zona të parashikuara nga plani ipërgjithshëm vendor. Ky kontribut jepet nga kërkuesi i lejes së ndërtimit në këmbim të shtimit të intensitetit të ndërtimit, në marrëveshje me autoritetin vendor si dhe hapësirave publike.
- **Transferimi i së drejtës për zhvillimin** - Transferimi i së drejtës për zhvillim midis njësive strukturore realizohet, sipas rastit, nga autoriteti vendor i planifikimit, me qëllim ruajtjen e monumenteve të kulturës dhe zonave historike, tokës bujqësore dhe asaj natyrore, si dhe hapësirave publike
- **Zhvillimi i detyrueshëm i tokës** - Në rastet kur si rezultat i procesit të hartimit të planit të detajuar vendor një ose disa pronarë nuk bien dakord me përmbajtjen e tij, autoriteti vendor i planifikimit negocion me ta për arritjen e një marrëveshjeje
- **Pezullimi i zhvillimit** - Në rastet kur është marrë nisma për hartimin e një dokumenti planifikimi, autoriteti përgjegjës i planifikimit mund të vendosë pezullimin e zhvillimit, me qëllim ruajtjen e planifikimit për zonën objekt planifikimi.
- **Servituti publik** - është barra që i ngarkohet një prone në dobi të një prone tjetër për interes publik. Ai nuk përjashton përdorimin e pasurisë së paluajtshme ose të një pjesë të saj që nuk cenon realizimin e servitutit publik.)
- **E drejta e transferimit** - Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë transferimin e pasurisë së paluajtshme publike, prone e njësive të qeverisjes vendore, në favor të shtetit, për realizimin e investimeve publike ose private në infrastrukturën publike kombëtare, në përputhje me dokumentet në fuqi të planifikimit.)
- **E drejta e preferimit** - është e drejta në dobi të një autoriteti të planifikimit, në kuptim të këtij ligji, për t'u preferuar në radhë para çdo personi privat në blerjen, në të njëjtat kushte, të një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, që është objekt shitjeje dhe ndodhet në një zonë vendimtare për realizimin ose mbrojtjen e një interesi publik

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration

Instrumentat e kontrollit dhe drejtimit të zhvillimit janë përcaktuar për rastet e Njësive Strukturore që do të jenë subjekt i Planeve të Detajuara Vendore. në këtë rast, instrumenti i propozuar do të jetë Servituti Publik, që është edhe instrumenti kryesor që është planifikuar të zbatohet në territoret urbane të Bashkisë Tepelenë.

## 2.2 PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE

### 2.2.1. RRJETI I INFRASTRUKTURES SË TRANSPORTIT

Ndër komponentët kryesorë strategjik për përmirësimin dhe zhvillimin perspektiv të treguesve social-ekonomik të Bashkisë Tepelenë është përmirësimi i infrastrukturave dhe shërbimeve publike në qytet si dhe në zonat periferike. Për shkak të pozicionit të veçuar gjeografik të shumicës së vendbanimeve rurale, tendencës së largimit të popullsisë së fshatrave, por edhe asaj të qytetit, si dhe mungesës së investimeve nga ana e autoriteteve, thuajse në të gjitha fshatrat e kësaj Njësie Vendore evidentohen probleme të theksuara për sa i përket rrjeteve të infrastrukturave dhe shërbimeve.

Në Bashkinë Tepelenë figurojnë aktualisht 24 fshatra, një pjesë e mirë e të cilëve janë të pozicionuar nëpër kreshta apo kurrize kodrinore. Kjo strukturë urbane ka bërë që në territorin e kësaj Njësie Vendore të evidentohen shumë akse komunikuese rurale, pjesa më e madhe e të cilave vazhdojnë të funksionojnë dhe të mundësojnë lidhjen midis fshatrave apo lagjeve të tyre. Struktura urbane e qytetit të Tepelenës është e pozicionuar në shpatin e kodrës, me orientim nga lindja dhe që kulmon me kalanë e Ali Pashës. Qyteti ka një rrjet rrugor të rikonstruktuar në pjesën më të madhe të tij, si pasojë e investimeve të mundësuara nga Bashkia në vitet e fundit.

Në kuadër të integrimit të zonës fushore në veri të qytetit në strukturën qëndrore urbane, propozohet rikonceptimi i një skeme të re rrugore.

Sipas një vlerësimi morfologjik të rrjetit, evidentohet së struktura ekzistuese e skemës rrugore të Bashkisë Tepelenë dominohet nga një konfiguracion thuajse radial, i cili graviton në qytetin e Tepelenës. Aksi kryesor i rrjetit është ai interurban jugor Levan-Tepelenë-Gjirokastër. Ky aks përbën dhe boshtin kryesor të komunikimit të rajonit jug-perëndimor i cili mundëson lidhjen me portën jugore kombëtare të Gjirokastrës.

Me këtë aks lidhen tre akset kryesore rrugorë që përbëjnë dhe skemën e komunikimit të Bashkisë Tepelenë:

1. *Aksi Tepelenë – Bënçë – Kurvelesh* – është në proces rikonstruksioni dhe lidh Tepelenën me fshatrat e Kurveleshit. Mjaft i rëndësishëm në kontekstin e zhvillimit të sektorit të turizmit malor dhe agroturizmit në këtë zonë. Ka nevojë të lidhet me Himarën, për të siguruar komunikimin me Perëndimin dhe daljen në bregdet.

2. *Aksi Tepelenë – Dukaj – Sinanaj – Sevaster*: një nga rrugët më të vjetra në Shqipëri. Seksioni Dukaj – Sinanaj ka nevojë urgjente për ndërhyrje. Aktualisht për segmentin Dukaj – Sinanaj, në fund të vitit 2020, ka nisur procesi i tenderimit për rikonstruksionin e plotë të saj, duke krijuar kështu një mundësi shumë të mirë për banorët e fshatrave të Lopësit, në komunikimin dhe lidhjen e tyre me qendrën e Bashkisë Tepelenë si dhe qendrat kryesore urbane të Rajonit të Gjirokastrës. Ky seksion rruge po rikonstruktohet përmes një investimi të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. *Aksi Kthesë e Leklit – Dragot – Këlcyrë*: rrugë nacionale, me rëndësi strategjike për Bashkinë pasi konsiston në lidhjen me Bashkitë Lindore. Problematike është Ura e Dragotit (monument kulture) për shkak të rrezikut të dëmtimit nga mbingarkesa e tonazhit të lartë. Eshtë e nevojshme një urë e re. Projekti i By-Passit të Tepelenës planifikon një urë të re mbi lumin Vjosë, duke devijuar urën e Dragotit.

Ndërkohë për sa i përket rrugëve lokale dhe akseve të lidhjes së tyre me fshatrat, një pjesë e tyre janë në gjendje relativisht të mirë; ndërkohë nevojiten ndërhyrje përmirësuese për rrugën e Mezhgoranit, rrugën lidhëse të fshatit Lekël si dhe thuajse të gjitha rrugët e njësisë administrative Lopës.

Një tjetër propozim është përmirësimi i konektivitetit midis fshatrave të Bashkisë Tepelenë apo dhe me fshatrat e tjerë. Konkretisht propozohet përmirësimi i lidhjes Gusmar – Golem (Bashkia Gjirokastër) në mbështetje të turizmit malor dhe agroturizmit. Gjithashtu propozohet përmirësimi i lidhjes midis Nivicës dhe Salarisë për të krijuar një tjetër frymëmarrje për zonat e Lopësit, duke i integruar gradualisht në hapësirën agroturistike.

Në terma statistikore, Bashkia Tepelenë disponon një rrjet rrugor me gjatësi totale 350.7 km. Në tabelën e mëposhtme paraqiten gjatësitë e rrugëve sipas kategorisë bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

| Rruge Kategoria | Gjatesia Km |
|---|---|
| Kategoria B. Rruge Interurbane Kryesore | 16.156811 |
| Kategoria C. Rruge Interurbane Dytesore | 77.816508 |
| Kategoria D. Rruge Urbane Kryesore | 0.342301 |
| Kategoria E. Rruge Urbane Dytesore | 1.229501 |
| Kategoria F. Rruge Lokale | 255.168662 |
| TOTALI | 350.713783 |

Duke u nisur nga konfiguracioni ekzistues i komunikimit si dhe ekzistenca e shumë akseve, Plani propozon që zhvillimi në perspektivë i rrjetit rrugor në Bashkinë Tepelenë do të fokusohet kryesisht në rikonstruksionin e rrugëve dhe gjurmëve të vjetra ekzistuese, pa qënë nevoja për identifikimin dhe hapjen e rrugëve të reja.




*fig 36 - Skema e rrjeteve rrugore të propozuara në Bashkinë Tepelenë, sipas kategorive përkatëse*

Nëpërmjet kësaj metodologjie rehabiltuese synohet:

- Përmirësimi i kapaciteteve teknike të rrugëve ekzistuese për të përmbushur të gjitha nevojat e komunikimit midis qendrës së Bashkisë Tepelenë dhe zonave rurale me njëra tjetrën;
- Ulja e kohës së udhëtimit dhe kostos për të gjitha llojet e transportit;
- Mbështetja dhe promovimi i aktiviteteve ekonomike, bujqësisë, agrobiznesit si dhe turizmit natyror dhe të aventurës, sidomos në zonat e thella periferike të Bashkisë Tepelenë;
- Krijimin e një skeme të konsoliduar komunikimi brenda Njësisë Vendore, e cila do të

ndikojë pozitivisht në reduktimin apo edhe përmbysjen e tendencave negative migratore të popullsisë lokale të Bashkisë;

Bazuar në sa më sipër si dhe duke analizuar tendencat e zhvillimeve të pritshme demografike dhe ekonomike në Bashkinë Tepelenë, Plani propozon skemën e plotë të rrjetit rrugor, duke bërë klasifikimin e të gjithë akseve sipas kategorisë përkatëse, referuar Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Sipas metodologjisë së përmendur më sipër, skema implikon rikonstruksionin e akseve ku përfshihen zgjerimet dhe përmirësimet e seksioneve sipas klasifikimit të rrjetit rrugor, së bashku me sinjalistikën përkatëse.

Referuar skemës së akesve rrugore, Plani propozon ndërhyrje emergjente në disa akse kryesore, të vlerësuara si të domosdoshme për rivitalizimin gradual të treguesve infrastrukturore dhe social-ekonomike të të gjitha zonave të banuara të Bashkisë Tepelenë.

Në funksion të zhvillimit ekonomik, kryesisht turizmit, me rëndësi është rikonstruksioni i rrugëve që lidhin qendrën e Bashkisë me njësitë administrative, pikat turistike dhe Bashkitë e tjera përreth. Ndërhyrja fizike në akset rrugore, duke i sjellë në standardin e kërkuar sipas kategorizimit përkatës, do të lehtësojë lëvizjen e mjeteve dhe mallrave duke ulur kostot e transportit dhe rritjen e nivelit të ekonomisë lokale. Konkretisht, këto ndërhyrje emergjente, të konsultuara edhe me administratën e Njësise Vendore, si dhe me planet e investimeve fizike do të jenë:

- **Rikonstruksioni dhe shtrimi i rrugës Luadh – Mezhgoran**
- **Rikonstruksioni i rruges së Beçishtit**
- **Rikonstruksioni i rrugëve lidhëse të fshatrave të Golikut** – Kodër, Lekël dhe Hormovë, me rrugët kryesore interurbane Tepelenë – Gjirokastër si dhe Tepelenë – Përmet.
- **Rikonstruksioni i rruges së Lopësit** – konkretisht bëhet fjalë për aksin Dukaj – Sinanaj, dhe përbën një nga sfidat më të mëdha për sa i përket rikonstruksionit të rrjetit rrugor të Bashkisë Tepelenë, duke zgjidhur përfundimisht problematikën e komunikimit me Salarinë dhe fshatrat periferike të Lopësit.
- **Rikonstruksioni i rrugës Dukaj – Memaliaj** – ky aks do të mundësojë përmirësimin e lidhjes me lagjen Kordhaj, për të vazhduar më pas me daljen në aksin interurban Levan-Tepelenë-Gjirokastër, pranë Memaliaj fshat. Kjo dalje do të përmirësojë komunikueshmërinë e zonave të banuara përreth.
- **Rikonstruksioni i rruges Sinanaj – Dorëz** – bëhet fjalë për aksin më periferik të Bashkisë Tepelenë, e cila kalon përmes fshatit, tashmë thuajse të braktisur, të Dorëzit për të dalë deri në breg të lumit të Vjosës. Projekti propozohet në sinergji me projektin për plotësimin e urës së pambaruar mbi Vjosë. Kjo rrugë, si dhe lidhja e saj përmes urës së re me fshatin Leshnje të Bashkisë Memaliaj, do të mundësojë një komunikim shumë të shpejtë dhe të favorshëm për fshatrat e Lopësit me aksin interurban Levan-Tepelenë-Gjirokastër.

Përsa i përket qytetit të Tepelenës, në kontekstin e përmirësimit dhe rikualifikimit të rrjetit të komunikimit, Plani i Përgjithshëm i Bashkisë Tepelenë propozon hapjen e rrugëve të reja dhe

plotësimin e rrugëve ekzistuese, duke synuar finalizimin e ndërhyrjeve përmirësuese të ndërmarra vitet e fundit në qytet për rikualifikimin e rrjetit të rrugëve si dhe korridoreve të komunikimit. Konkretisht, ndërhyrjet e propozuara janë:

- **Ndërtimi i rrugës së re Kisha e Shen Thomait** – bypassi i Tepelenës. E planifikuar prej kohësh nga ana e Bashkisë, kjo rrugë synon që të përmirësojë komunikimin e brendshëm të qytetit.
- **Zgjatimi në veri i rrugës "Elmaz Teme Bilbili" dhe Bashkimi i saj me rrugën "Tafil Buzi"**, pranë Spitalit Bashkiak të qytetit – kjo rrugë propozohet të kthehet si unaza lindore e qytetit, e cila do të përmirësojë akoma më shumë lidhjen e spitalit me rrjetin e qytetit si dhe shfryrjen e rrugëve të brendshme.
- **Krijimi i shkallareve lidhëse midis zonave urbane të pozicionuara në disnivele**. Konkretisht propozohen shkallare panoramike që lidhin rrugën veriore "Elmaz Teme Bilbili" me fushën poshtë Tepelenës. Gjithashtu propozohen shkallare të cilat lidhin kryqëzimin jugor të qytetit me lagjen poshtë të lumit. Këto shkallare mund të orientohen edhe në drejtim të urës së Ali Pashës, për të lehtësuar lëvizjen e këmbësorëve drejt fshatit Beçisht, në faqen malore përballë Tepelenës.

Aktualisht, për shkak të tipologjisë së relievit natyror si dhe ekzistencës së trupave ujorë (lumenjve dhe përrenjve), në territorin e Bashkisë Tepelenë funksionojnë disa ura, të cilat mundësojne komunikimin e qendrave të banuara me njëra tjetrën. Nga analiza e gjëndjes ekzistuese mund të veçojmë:

- **Ura e qytetit të Tepelenës** – pjesë e aksit rrugor Levan – Tepelenë – Gjirokastër, ndodhet në pjesën veriore të qytetit, mbi lumin e Bënçës, pranë grykëderdhjes në lumin Vjosë. Është urë e re dhe në gjendje shumë të mirë teknike.
- **Ura e Leklit** – urë me strukturë metalike kapriate, prodhim francez, e montuar në vitin 1928 mbi lumin Drinos.
- **Ura e Dragotit** – urë me strukturë metalike, ndertuar në vitin 1936 – mbi lumin e Vjosës.
- **Ura e Bençes** – lidh qytetin e Tepelenës me Dukaj dhe fshatrat e Njësisë Administrative Lopës – mbi lumin e Bençes.
- **Ura e Peshtanit** – urë e re me strukture betonarme që lidh fshatin Peshtan me rrugen interurbane Tepelenë -Kelcyre – mbi lumen e Vjosës.
- **Ura e Hormovës** – urë e varur mbi lumin Drinos që lidh fshatin Hormovë me rrugën Tepelenë Gjirokastër.
- **Ura e Ali Pashes** – poshtë kalasë së qytetit, mbi lumin Vjosë. Është ura më e madhe në Bashkinë Tepelenë, me strukturë të varur dhe e përshtatshme vetëm për këmbësorët që shkojnë në Beçisht apo në Dragot.
- **Pasarela e Bençës** – ure me funksion blegtoral, shërben për kalimin e bagëtive në kullotat përballë fshatit të Bençes.

Gjithashtu, në territorin e Bashkisë Tepelenë gjenden edhe disa ura të vogla të pozicionuara përgjatë rrugës Tepelenë- Lopës si ura poshtë fshatit Turan, ura në Sinanaj etj.

Duke u bazuar në skemën e qarkullimit dhe në analizën e gjendjes ekzistuese të urave të Bashkisë Tepelenë, Plani i Përgjithshëm Vendor, referuar vlerësimeve të Strategjisë Territoriale, propozon ndërhyrjet e mëposhtëme:

- **Ndertimi i urës së re të Dragotit** – propozimi synon konservimin e urës ekzistuese të Dragotit i cili është monument kulture, nga rreziku që mund të shkaktojë trafiku i rëndë nëpërmjet ndërtimit të nje ure të re me strukture beton-arme. Kjo ure propozohet të ndertohet shume pranë urës ekzistuese metalike.
- **Ndertimi i urës së re të Leklit** – sikurse në rastin e urës së Dragotit, propozohet ndertimi i një urë të re, pranë urës së vjeter, me qellim konservimin e struktures metalike monument kulture.
- **Ndertimi i nje ure të re mbi përroin e Rrapeve** -Propozimi lidhet me projektin për rikostruksionin e rrugës Sinanaj-Dorëz-Vjosë, e cila do të shërbejë edhe si shkurtim i rrugës që lidh fshatrat e Lopësit me rrugën Levan-Tepelenë-Gjirokastër.

Përveç ndërhyrjeve rikonstruktuese, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon hartimin dhe miratimin e një plani veprimi operacional për mirëmbajtjen periodike të rrugëve në territorin që administron. Referuar analizës së përgjithshme të territorit, si dhe metodologjisë standarde të administrimit të aseteve publike, mirëmbajtja periodike jo vetëm e rrugëve por e të gjithë elementëve dhe rrjeteve të infrastrukturës është një element kyç që garanton cilësinë dhe mirëfunksionimin e tyre në terma afatgjatë. Nëse nuk bëhet kjo mirëmbajtje, atëhere kostot fizike dhe sociale do të jenë shumë herë më të mëdha në periudha afatgjata. Mirëmbajtja periodike do të mundësojë riparimin në kohë të dëmtimeve të vogla të rrjetit rrugor, të cilat në mungesë të mirëmbajtjes do të agravohen së tepërmi, dhe do të kenë nje kosto shumë herë më të lartë për rikonstruksion të plotë.

Plani i propozuar i mirëmbajtjes duhet të këtë strukturën e një inventari të plotë, ku të listohen akset e rrugëve, parametrat teknike, numrin e veprave inxhinierike përgjatë seksionit gjatsëor, si dhe gjendja e tyre teknike në çdo moment të kohës, të pasqyruar me raporte teknike të detajuar, foto dhe material hartografik. Në këtë mënyrë, Bashkia Tepelenë, do të ketë në përdorim një sistem të detajuar të planifikimit dhe kontrollit të rrjetit rrugor në territorin që administron, i cili do të mundësojë një llogaritje më të saktë të projekteve dhe fondeve të nevojshme si dhe do të ndikojë në një planifikim më real të Projekt Buxheteve Afatmesme.

Gjithashtu, në territorin e Bashkisë Tepelenë gjenden edhe disa ura të vogla të pozicionuara përgjatë rrugës Tepelenë- Lopës si ura poshtë fshatit Turan, ura në Sinanaj etj.

Duke u bazuar në skemën e qarkullimit dhe në analizën e gjendjes ekzistuese të urave të Bashkisë Tepelenë, Plani i Përgjithshëm Vendor, referuar vlerësimeve të Strategjisë Territoriale, propozon ndërhyrjet e mëposhtëme:

- **Ndertimi i urës së re të Dragotit** – propozimi synon konservimin e urës ekzistuese të Dragotit i cili është monument kulture, nga rreziku që mund të shkaktojë trafiku i rëndë nëpërmjet ndërtimit të nje ure të re me strukture beton-arme. Kjo ure propozohet të ndertohet shume pranë urës ekzistuese metalike.
- **Ndertimi i urës së re të Leklit** – sikurse në rastin e urës së Dragotit, propozohet ndertimi i një urë të re, pranë urës së vjeter, me qellim konservimin e struktures metalike monument kulture.
- **Ndertimi i nje ure të re mbi përroin e Rrapeve** -Propozimi lidhet me projektin për rikostruksionin e rrugës Sinanaj-Dorëz-Vjosë, e cila do të shërbejë edhe si shkurtim i rrugës që lidh fshatrat e Lopësit me rrugën Levan-Tepelenë-Gjirokastër.
- **Ndertimi (plotesimi) i urës mbi Vjosë që lidh Dorëzin me fshatin Leshnjë të Bashkisë Memaliaj** - Duhet theksuar së ky projekt varet nga ecuria e zhvillimit të projektit të hidrocentralit të Kalivaçit, ku pritet të krijohet një liqen artificial.

Përveç ndërhyrjeve rikonstruktuese, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon hartimin dhe miratimin e një plani veprimi operacional për mirëmbajtjen periodike të rrugëve në territorin që administron. Referuar analizës së përgjithshme të territorit, si dhe metodologjisë standarde të administrimit të aseteve publike, mirëmbajtja periodike jo vetëm e rrugëve por e të gjithë elementëve dhe rrjeteve të infrastrukturës është një element kyç që garanton cilësinë dhe mirëfunksionimin e tyre në terma afatgjatë. Nëse nuk bëhet kjo mirëmbajtje, atëhere kostot fizike dhe sociale do të jenë shumë herë më të mëdha në periudha afatgjata. Mirëmbajtja periodike do të mundësojë riparimin në kohë të dëmtimeve të vogla të rrjetit rrugor, të cilat në mungesë të mirëmbajtjes do të agravohen së tepërmi, dhe do të kenë nje kosto shumë herë më të lartë për rikonstruksion të plotë.

Plani i propozuar i mirëmbajtjes duhet të këtë strukturën e një inventari të plotë, ku të listohen akset e rrugëve, parametrat teknike, numrin e veprave inxhinierike përgjatë seksionit gjatsëor, si dhe gjendja e tyre teknike në çdo moment të kohës, të pasqyruar me raporte teknike të detajuar, foto dhe material hartografik. Në këtë mënyrë, Bashkia Tepelenë, do të ketë në përdorim një sistem të detajuar të planifikimit dhe kontrollit të rrjetit rrugor në territorin që administron, i cili do të mundësojë një llogaritje më të saktë të projekteve dhe fondeve të nevojshme si dhe do të ndikojë në një planifikim më real të Projekt Buxheteve Afatmesme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration

Seksionet tip të rrugëve të propozuara për Bashkinë Tepelenë, bazuar në kategoritë e Kodit Rrugor të Republikes së Shqipërise:

## RRUGE NDERURBANE DYTESORE C1




## RRUGE NDERURBANE DYTESORE C2




## RRUGE NDERURBANE DYTESORE C3



## RRUGE NDERURBANE DYTESORE C2/1




## RRUGE NDERURBANE DYTESORE C3/1




## RRUGE E KATEGORISE E1 RRUGE URBANE DYTESORE LAGJE



RRUGE E KATEGORISE E2     RRUGE URBANE DYTESORE QYTETI




RRUGE E KATEGORISE E2/1  RRUGE URBANE DYTESORE QYTETI




RRUGE E KATEGORISE E3     RRUGE URBANE DYTESORE




REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA TEPELENE
REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERITORIT SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration - studio@archi-space.com

## RRUGE E KATEGORISE F1/1 RRUGE INTERURBANE LOKALE




## RRUGE E KATEGORISE F1 RRUGE INTERURBANE LOKALE




*fig 37 - Prerjet terthore të rrjetit rrugor, sipas kategorive të Kodit Rrugor*

Sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor, përcaktimi i seksioneve tërthore të rrugëve në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë, është bërë duke analizuar mundësitë e aplikimit (zgjerimit) të këtyre seksioneve si dhe në ngarkesat e pritshme të trafikut në këtë Njësi Vendore. Në këtë rast duhet theksuar fakti që Bashkia Tepelenë ka një dinamikë të ulët të trafikut të brendshëm, për shkak të treguesve ekzistues social-ekonomik. Në këtë kontekst, brenda tolerancave teknike të Kodit Rrugor për kategoritë e akseve, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon seksione të moderuara tërthore, pa qënë nevoja për ndërhyrje masive apo zgjerime të seksioneve në mënyrë të panevojshme. I gjithë klasifikimi i rrugëve është bazuar në përcaktimet e Kodit, si më poshtë vijon;

**C. Rrugë Nderurbane Dytësore:** Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina, me funksion kryesor lidhjen e qyteteve me njëri tjetrin.
**E. Rrugë Urbane Dytësore:** Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës. Rrugë urbane dytësore ka si funksion shpëndarjen e

trafikut që vjen nga rrugët kryesore, zonat me funksione të ndryshme social-ekonomike dhe turistike.

**F. Rrugë Interurbane Lokale:** Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme. Rrugë lokale janë të gjitha rrugët e tjera me kapacitet të ulët dhe që bëjnë lidhjet midis njësive funksionale dhe për shkak të shpejtësisë së ulët mund të përdoren nga mjetet, këmbësorët dhe biçikletat.

Për shkak të morfologjisë tipike rurale të Sistemit Urban në Bashkinë Tepelenë projekteve teknike të rrugëve interurbane dytësore si dhe rrugëve lokale në perspektivë, të krijohen akse për lëvizjen e biçikletave, të gjykuara si esencialisht të domosdoshme për levizjen e sigurtë të banorëve të këtyre zonave.

| Lljet sipas Kodit | Kodi | Shtrirja territoriale | | Limiti i Shpejtesise | Nr i korsive për çdo drejtim | Ndarja e shpejtesise Limiti i poshtem | Limiti i sipërm | | Gjeresia Minimale ishullit të trafikut (m) | Gjeresia minimale e bankines në të majte (m) | Gjeresia minimale e bankines në të djathte (m) | Gjeresia e korsise së emergjences | Gjeresia minimale e kufirit të brendshem (m) | Gjeresia ma e kufirit anesor (m) | Niveli i Shërbimit | Shtrirja e Shërbimit për Korsi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| Autorruge | A | Nder Urbane | Rruge paresore | 130 | 2 ose me shume | 90 | 140 | 3.75 | 2.60 | 0.70 | 2.5***** | 3.00 | 4.0 (a) | 6.1 (b) | B (2 ose me shume korsi) | 1100 |
| | | | Rruge Shërbimi | 90 | 1 ose me shume | 40 | 100 | 3.50 ** | - | 0.50 | 1.25 | - | - | - | C (1 korsi) C (2 ose me shume korsi) | 650 (d) 1350 |
| | | Urbane | Rruge paresore | 130 | 2 ose me shume | 80 | 140 | 3.75 | 1.80 | 0.70 | 2.5***** | 3.00 | 3.2 (a) | 5.3 (b) | C (2 ose me shume korsi) | 1550 |
| | | | Rruge Shërbimi | 50 | 1 ose me shume | 40 | 60 | 3.00 ** | - | 0.50 | 0.50 | - | - | - | D (1 korsi) D (2 ose me shume korsi) | 1150 (d) 1650 |
| NderUrbane Paresore | B | Nder Urbane | Rruge paresore | 110 | 2 ose me shume | 70 | 120 | 3.75 | 2.50*** | 0.50 | 1.75 | - | 3.5 (a) | 5.3 (b) | B (2 ose me shume korsi) | 1000 |
| | | | Rruge Shërbim | 90 | 1 ose me shume | 40 | 100 | 3.50 ** | 2.0**** | 0.50 | 1.25 | - | - | - | C (1 korsi) C (2 ose me shume korsi) | 650 (d) 1200 |
| NderUrbane Dytesore | C | Nder Urbane | C1 | 90 | 1 | 60 | 100 | 3.75 | - | - | 1.50 | - | - | - | C (1 korsi) | 650 (e) |
| | | | C2 | 90 | 1 | 60 | 100 | 3.50 | - | - | 1.25 | - | - | - | C (1 korsi) | 600 (e) |
| | | | C3 | 60 | 1 | 40 | 70 | 3.50 | - | - | 1.00 | - | | - | - | < 400 |
| Urbane Kryesore | D | Urbane | Rruge paresore | 70 | 2 ose me shume | 50 | 80 | 3.25 * | 1.80 | 0.50 | 1.00 | - | 2.8 (a) | 3.3 (b) | Kapaciteti (c) | 950 |
| | | | Rruge Shërbimi | 50 | 1 ose me shume | 25 | 60 | 2.75 ** | - | 0.50 | 0.50 | - | - | - | Kapaciteti (c) | 800 |
| Urbane në Lagje | E | Urbane | | 50 | 1 ose me shume | 40 | 60 | 3.0 *** | - | - | 0.50 | - | 0.5 (sinjalet horizontale) | | Kapaciteti (c) | 800 |
| Lokale | F | Nder Urbane | F1 | 90 | 1 | 40 | 100 | 3.50 | - | - | 1.00 | - | - | - | C (1 korsi) | 450 (e) |
| | | | F2 | 90 | 1 | 40 | 100 | 3.25 | - | - | 1.00 | - | - | - | C (1 korsi) | 450 (e) |
| | | Urbane | | 50 | 1 ose me shume | 25 | 60 | 2.75 ** | - | - | 0.50 | - | - | - | Kapaciteti (c) | 800 |

*fig 38 - Tabela e klasifikimit të akseve rrugore sipas funksionit të tyre, treguesve të trafikut, si dhe parametrave teknike, sinjalistikes dhe shpejtesise*

Duhet pasur parasysh së në rrethana të veçanta, karakteristikat e paraqitura në tabelën më sipër mund të mos vlejnë për disa rrugë rurale. Këto rrethana përfshijnë rrugët e përdorura në bujqësi, pyje, dhe miniera, dimensionet e kurorave të të cilave nuk përzgjidhen sipas standardeve normale për rrugët rurale, por në përputhje me llojin e automjetit të përdorur në këto rrugë. Për rrugët e kategorisë D dhe E në këtë rregull teknik janë dhënë vetëm disa dimensione më të domosdoshme. Këto tipe rrugësh nuk janë pjesë e këtij rregulli teknik dhe disa nga konceptet dhe përqasjet projektuese nuk mund të aplikohen për këto tipe rrugësh. Për këto tipe duhet të hartohen rregulla teknike të tjera nga enti administrator i tyre.

### 2.2.2. SKEMA E TRANSPORTIT PUBLIK

Për sa i përket komponentit të transportit publik, referuar analizës së gjendjes ekzistuese, mund të thuhet së lidhja e qytetit të Tepelenës me zonat e saj rurale periferike kryhet nëpërmjet automjeteve private apo mikrobuseve që nisen nga qëndra Ali Pashë Tepelena. Nuk funksionon një sistem i strukturuar transporti publik për zonat periferike, problematikë kjo që përkeqëson akoma më tej situatën social ekonomike të fshatrave të Bashkisë. Situata vështirësohet kryesisht nga gjendja e vështirë e akseve rrugore lidhëse si edhe nga numri i ulët i banorëve të ngelur në këto fshatra.

Ndërkohë, transporti publik ndërqytetës është funksional, nëpërmjet linjave të autobuseve që lidhin qytetin e Tepelenës me qytetet fqinje. Qyteti i Tepelenës, për shkak të përmasave të vogla nuk disponon transport publik qytetes. Po ashtu nuk ekziston linja hekurudhore, edhe pse në Planin e Përgjithshëm Kombëtar parashikohet shtrirja e linjës hekurudhore Fier – Gjirokastër – Greqi.

| NR | Linja Kryesore | Nr. Orareve | Nr. Autobusave |
|---|---|---|---|
| 1 | TEPELENE – VLORË – TEPELENË | 1 (një) | 2 (dy) |
| **NR** | **Linja ushqyese** | | |
| 1 | TEPELENË - MEMALIAJ – TEPELENË | 6 (gjashtë) | 3 (tre) |
| 2 | TEPELENË – GJIROKASTËR- TEPELENË | 3 (tre) | 3 (tre) |
| 3 | TEPELENË – PËRMET – TEPELENË | 1 (një) | 2 (dy) |

*fig 39 - Rrjeti i linjave nderqytetese të Bashkisë Tepelenë – miratuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise*

Ajo që duhet theksuar në vlerësimin e transportit publik është mungesa e një stacioni multimodal gjithëpërfshirës, si për transportin ndërqytetës ashtu edhe për atë rural. Projektimi dhe zhvillimi i një stacioni të tillë është prerogativë e përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe në Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020




*fig 40 - Skema e transportit publik të ropozuar, Bashkia Tepelenë*

Referuar Nenit 23, pikës 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar , Bashkia Tepelenë ka si detyrim administrimin dhe mirëfunksionimin e transportit publik në territorin e saj. Në këtë kontekst, duke u bazuar në analizën krahasimore midis shtrirjes hapësinore të zonave urbane si dhe numrin e banorëve të fshatrave periferike të Bashkisë Tepelenë, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon ndërhyrjet e mëposhtëme:

- **Ndërtimi i stacionit multimodal të transportit në Tepelenë** – përbën ndërhyrjen kryesore për riorganizmin e të gjithë sistemit të transportit publik në Bashkinë

Tepelenë. Propozohet të ndërtohet në pjesën veriore të qytetit, duke akomoduar hapësirat e nevojshme edhe për ndertimin në perspektivë të stacionin e trenit.

- **Krijimi dhe konsolidimi i linjave të transportit lokal**, - dhe konkretisht lidhjeve të qytetit me fshatrat periferike. Aktualisht propozohet përcaktimi dhe vënia në funksionim i katër linjave të transportit publik;
  **- Linja Mamaj – Tepelenë (stacion) – Luzat – Hormovë** – një pikë qendrimi sekondare (ura e Leklit) si dhe dy pika qendrimi terciare (kthese e Luzatit dhe kthese e Hormovës)
  **- Linja Lekël – Dragot – Luadh - Mezhgoran**. Kjo linjë ndërkohë perfshin edhe "devijimet" Peshtan dhe Beçisht – parashikohet një pikë qëndrimi sekondare (Dragot) si dhe katër pika qendrimi terciare (Beçisht, kthesa e Mezhgoranit, kthesa e Peshtanit, kthesa Kodër)
  **- Linja Tepelenë (stacion) - Nivicë** – përfshin 5 pika qendrimi terciare (Bënçë, Lekdush, Progonat, Gusmar dhe Nivicë)
  **- Linja Tepelenë (stacion) – Lopës** – përfshin të gjitha fshatrat që kalojne pergjate rruges Tepelenë – Lopës si Veliqot, Turan, Dukaj, Salari, Lap-Martalloz, Dhëmblan, Matohasanaj, Sinanaj. Gjithashtu parashikohen edhe 6 pika qendrimi terciare.

Këto linja synojnë të përmbushin nevojat bazë të transportit publik, duke synuar mbulimin me komunikimin për pjesën më të madhe të zonave periferike me një kosto transporti të ulët. Megjithatë, Plani merr në konsideratë autoritetin e Bashkisë Tepelenë, e cila mund të ketë përmirësuar skemën e transportit publik të sipërpërmendur, duke shtuar numrin e linjave të nevojshme apo edhe të kapaciteteve e mjeteve të shërbimit.

### 2.2.3. RRJETI I INFRASTRUKTURAVE INXHINIERIKE

#### 2.2.3.1 ENERGJIA ELEKTRIKE DHE ALTERNATIVE

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë ka analizuar skemën potenciale të rrjetit të furnizmit me energji elektrike, duke u bazuar kontekstin strategjik të këtij sektori, trajtuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar. Në mënyrë kronologjike përmbajtësore, ky dokument themelor i planifikimi të territorit në nivel kombëtar, është bazuar në parimet kryesore të Strategjisë së Energjisë, të përmbledhura si më poshtë:

- Ristrukturimi i plotë i sektorit energjitik kombëtar bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe në zhvillimin e një politike bashkohore energjitike;
- Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë në furnizimin me energji në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë rajonal;
- Krijimi i një sektori energjitik të aftë si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo teknike.
- Krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe rregullator dhe ristrukturimi i plotë i kompanive të energjisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
SEKRETARIA AGJENCIA

- Rritja e eficiencës së energjisë, si gjatë prodhimit ashtu dhe gjatë përdorimit të burimeve energjitike, me synim ndotjen minimale të mjedisit.
- Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjitike duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis.

Përcaktimet e Strategjisë Kombëtare të Energjisë kanë efekt në kontekstin social ekonomik si dhe atë territorial të Bashkisë Tepelenë. Konkretisht, duke iu referuar këtyre përcaktimeve, Strategjia Territoriale e Bashkisë Tepelenë dhe Plani i Përgjithshëm Vendor marrin në konsideratë:

- Rikonstruksionin e rrjeteve të brendshme të shpërndarjes së energjisë, me qëllim rritjen e performancës së shërbimit si dhe uljen e nivelit të humbjeve teknike në rrjet. Plani propozon një ndërhyrje graduale në zonat urbane në Bashkinë Tepelenë, duke u fokusuar në territoret më me shumë gravitet urban si qyteti Tepelenë, apo zonat urbane përgjatë aksit interurban SH4 – Levan – Tepelenë – Gjirokastër.
- Konsolidimin e qendrave urbane dhe rurale – ky nocion ka të bëjë me rritjen e eficiencës së shfrytëzimit të rrjeteve të energjisë. Teknikisht, furnizimi me energji i zonave urbane të vogla apo grupeve të vogla të banesave periferike kërkon investime të mëdha kapitale dhe mirëmbajtjeje të rrjeteve të shpërndarjes së rrymës. Këto procese të bartjes dhe shpërndarjes së rrymës shoqërohen me humbje përkatëse të fuqisë dhe energjisë. Vlera e këtyre humbjeve në sistemet elektroenergjetike është e konsiderueshme dhe rëndom gjendet diku në intervalin prej 8-14% të bruto sasisë së energjisë së prodhuar elektrike, pjesa më e madhe e të cilave shkaktohet në rrjetin distributiv, ndërsa ajo më e vogël në rrjetin bartës. Lidhur me këtë komponent Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon konsolidimin dhe dendësimin e qëndrave urbane, duke evituar njësitë e vogla periferike, apo shtëpitë e shkëputura nga blloqet konvencionale të banimit;
- Aplikimin dhe promovimin e teknologjive të energjive të rinovueshme si panele diellore, sidomos në zonat periferike të Bashkisë. Këto propozime duhet të gjejnë edhe mbështetjen teknike dhe financiare të institucionit të Bashkisë Tepelenë

Plani i Përgjtihshëm Vendor nuk parashikon linja të reja furnizimi me energji elektrike për zonat qëndrore apo periferike të Bashkisë Tepelenë. Në vend të kësaj, Plani propozon ristrukturimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrjetit ekzistues shpërndarës. Konkretisht, furnizimi me energji elektrike i zonave të banuara të Bashkisë Tepelenë mundësohet nëpërmjet një nënstacioni, 110 KV, konkretisht ai i Tepelenës. Nga ky nënstacion dalin 3 Fidera 10 KV, sipas tabelës në vazhdim.

| Nenstacioni | Emertimi i Fiderit | Tensioni në Hyrje KV | Tensioni në Dalje KV |
|---|---|---|---|
| Nst 110/10kV Tepelenë | Dragot | 110 | 10 |
| Nst 110/10kV Tepelenë | Kalaja | 110 | 10 |
| Nst 110/10kV Tepelenë | Stadiumi | 110 | 10 |

*fig 42 - Lista e Fiderave që dalin nga nenstacioni në Bashkinë Tepelenë*

Vlera e tensionit 10 KV që del nga nënstacioni nuk është shumë e përshtatshme për transmetimin e rrymave të tensionit të mesëm. në kontekstin ekzistues të zhvillimit social ekonomik të Bashkisë Tepelenë, mund të konsiderohet si e panevojshme rritja e kapaciteteve transmetuese të fiderave shpërndarës. Referuar objektivave strategjike të propozuar, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon rritjen e kapacitetit të fiderave për të arritur një vlerë më të përshtatshme për transmetimin e tensionit të mesëm në 20 KV.



*fig 41 – skema e furnizimit me energji elektrike të Bashkisë Tepelenë*

Në vazhdimësi të kësaj linje veprimi, Plani propozon rikonstruksionin total të fiderave furnizues si dhe të të gjitha kabinave elektrike të brendshme, të përshtatshme për rrjetin 20 KV. Ndryshimi nivelit të tensionit nga 10 KV në 20 KV do të nisë që nga nënstacioni elektrik. Ky rikonstruksion propozon zëvendësimin e transformatorëve të tipit 20/04, si dhe instalimin e çelave 20 KV. Numri dhe tipi i kabinave të reja do të zgjidhen në përshtatje me pozicionin gjeografik dhe terrenin, me vendet ku rrjeti ekzistues nuk i përballon nevojat dhe në vendet ku parashikohet të ketë zhvillim. Ndërkohë duhet pasur parasysh edhe ndërrimi i transformatorit të nënstacionit, pra nga 110/10 KV në 110/20 KV. Në momentin që do të zëvendësohet transformatori duhet të bëhet dhe llogaritja e fuqisë së tij, ndërkohë që përveç transformatorit, do të ndryshojnë dhe të gjithë aksesorët e tjerë të nevojshëm për ndryshimin e tensionit dalës nga nënstacioni.

Ndërhyrjet e propozuara pritet të sjellin zvoglimin e humbjeve në rrjet, dhe do të minimizojnë shërbimet e mirëmbajtjes për shkak të defekteve nga mbingarkesat e rrjetit elektrik.

Gjithashtu ato synojne të rrisin cilësinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit në qytetin e Tepelenës, si qëndra kryesore social-ekonomike e Bashkisë.

Linjat e reja të tensionit 20 KV do të rrisin në mënyrë të konsiderueshme mundësitë e furnizimit të zonave të ndryshme të qytetit, ndërkohë që krahas shpërndarjes së linjave nëntokësore të TM do të shtrihen edhe linjat e fibrës optike duke krijuar bokse të veçantë për mbikqyrjen dhe kontrollin e tyre.

Skema e organizimit të qarqeve duhet të jetë e tille që të mundësojë kompensimin e humbjeve në rrjet, duke mbyllur në qark të caktuar nga lidhje të tjera. Në parim parashikohet një numër minimal prej tre lidhjesh, duke mundësuar kështu një rivendosje të linjave në ngarkesë në kohën e duhur. Në aspektin teknik, zvogëlimi i humbjeve elektrike do të ketë të nevojshme instalimin e kapacitorëve, të cilët do të bëjnë të mundur që faktori i fuqisë të jetë jo më pak së 95%. Nëpërmjet kësaj zgjidhje teknike, bëhet i mundur reduktimi i fuqisë së kondensatorëve në periudhat e pikut të konsumit, apo në zona specifike, duke shkaktuar një rritje të tensionit në qark, jo më të madh së 3%. Në rastet kur qarku është shumë i ngarkuar, është e nevojshme të instalohen rregullatorë të linjës, duke siguruar kështu një rritje të tensionit. Gjithsesi, kjo zgjidhje nuk duhet konsideruar si një zgjidhje afatgjatë. Për sa i përket mirëmbajtjes së rrjetit shpërndarës, duhet pasur parasysh që nëse një seksion linje kërkon më shumë së 2 riparime brenda një distance prej 1 km atëherë linja duhet të zevendësohet. Linjat duhet të jenë prej bakri, ndërkohë që duhet parashikuar ndërrimi periodik i linjave të vjetra.

Rritja potenciale e konsumit të energjisë, dhe si rrjedhojë e ngarkesës në rrjetin shpërndarës duhet të shoqerohet me një mbikqyrje të sistemit të mbrojtjes në nën-stacion. Propozohet që sistemi automatik i mbrojtjes të mbulojë deri në 75 % të ngarkesës për të shmangur çkyçjet e panevojshme të linjës për shkak të difekteve të mundshme.

Për sa i përket rrjetit shpërndares së tensionit të ulët, duhet theksuar së gjatë dëgjesave publike është evidentuar një problematike mjaft e madhe që ka hasur dhe insistencën e banorëve. Për shkak të pozicionimit gjeografik dhe karakterit të relievit, Tepelena gjendet në pjesën më të madhe të kohës nën ndikimin e korrenteve ajrore të forta. Ky faktor ndikon negativisht dhe përbën rrezikshmëri të lartë përsa i përket dëmtimit të rrjetit shpërndarës, duke vënë në rrezik dhe sigurinë e vet banorëve. Për këtë arsye, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon që furnizimi nga kabinat elektrike deri tek konsumatori të bëhet nëpërmjet linjave nëntokësore. Përjashtim të vetëm përbëjnë rastet kur kjo ndërhyrje e ka të pamundur të aplikohet. Realizimi i këtij propozimi synon garantimin e përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, si dhe rritjen e sigurisë për furnizim me energji elektrike të tyre.

### 2.2.3.2 ENERGJIA DIELLORE

Shqipëria ka një potencial të madh energjetik diellor, ku shumë zona kanë një rrezatim që luhatet nga 1185 kËh/m² dhe 1700 kËh/m² në vit. Ky kapacitet mundëson përdorimin e energjisë diellore për të prodhuar ujë të ngrohtë për nevojat sanitare të teknologjisë si dhe për prodhimin e energjisë elektrike. Territori i Bashkisë Tepelenë përfshihet në territoret me diellzim që luhaten nga 2100 deri në 2500 kËh/m² në vit, duke ofruar kështu mundësi të mëdha për instalimin e impianteve fotovoltaike për prodhimin e energjisë nga energjia diellore. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë nuk propozon zona specifike të ndërtimit potencial të impianteve të tilla në territorin e kësaj Njësie Vendore, pasi ato kanë nevojë për një studim të thelluar inxhinerik, mjedisor dhe financiar, në kontekstin e fizibilitetit të tyre. Gjithsesi, edhe në këtë rast Plani propozon që zonat që mund të identifikohen si potenciale për ndërtimin e impianteve diellore për prodhimin e energjisë, nuk duhet kurrsesi të okupojnë terrene bujqësore, të çfarëdo lloj kategorie të bonitetit të tokës.

### 2.2.3.3 ENERGJIA E ERES

Shpejtësia mesatare e erës në Shqipëri ndryshon nga 1.6 m/sek në 4.6 m/sek. Ndërsa për sa i përket drejtimeve të erës, shpejtësia më e madhe u takon drejtimeve Jug, Jug-Perëndim dhe Veri-Perëndim. Për sa i përket energjisë së erës, Shqipëria ka potencial të madh për të ngritur parqe ere me kapacitet total deri në 2000 MË. Duke qenë kaq afër me detin, por në të njëjtën kohë duke qenë edhe një vend malor, në disa zona rikthimi i investimit të turbinave me erë, parashikohet të jetë relativisht i lartë. Sipas të dhënave të bëra publike nga Shoqata Shqiptare e Energjisë, parashikohet që deri në vitin 2025, 4% e totalit të sasisë së energjisë elektrike e prodhuar në Shqipëri (rreth 400 GËh/në vit) do të prodhohet nga era.

Zonat me potencial më të madh për energjinë e erës janë identifikuar në zonën e bregdetit, ku parashikohet që të merret 0.7% e prodhimit total kombëtar të energjisë elektrike. Shpejtësia mesatare vjetore e erës në këto zona është 4-6 m/s (lartësia 10 m), ndërkohë që dendësia vjetore e energjisë është 100-250 Ë/m2.

Aktualisht, në Bashkinë Tepelenë nuk rezultojnë të jenë bërë studime apo matje lidhur me potencialin e zhvillimit të impianteve eolike. Megjithatë, duke marrë në konsideratë relievin kodrinor të territorit si dhe dendësinë mjaft të ulët të popullsisë, sisteme të tilla eolike mund të gjejnë zbatim në këtë njësi vendore. Plani propozon që projekte të tilla ku hartimi dhe miratimi i tyre bëhet në nivel qëndror, të respektojnë specifikat natyrore të Bashkisë, pa dëmtuar elementët mjedisorë, faunën apo dhe vetë sigurinë e banorëve të zonës.




**Infrastruktura e Energjise PKK 2030**

## 2.2.3.4 ENERGJIA HIDRIKE NË BASHKINË E TEPELENËS

Për sa i përket prodhimit të energjisë, në territorin e Bashkisë Tepelenë gjenden të miratuara disa instalime (HeC) të prodhimit të energjisë nga burimet ujore. Konkretisht kemi 4 kontrata koncesionare për ndërtimin e 8 HEC' ve:

1. Kompania "**Gusmari**" shpk:
    1. Hec Meshaniku – 2009 – 35 – 300 kë (energjia e projektuar për prodhim)
    2. Hec Guva – 2009 – 35 – 1350 kë (energjia e projektuar për prodhim)

Hec Meshaniku ka katër vepra marrje që fillojnë nga Llufa, përfshijnë dhe rezervuarin e Nivicës, ndërsa godina e HEC'it pozicionohet poshtë rezervuarit. Nga aty, nëpërmjet kanalit që kalon midis Nivicës dhe Rexhinit i bashkohen edhe dy vepra marrje nga përroi i Gusmarit.

Objekti i HEC Guva ndodhet poshtë kalasë së Nivicës (në anën jugore) në vendin e quajtur Guve.

2. Kompania **"Kendrevic Energy"** shpk:

1. Hec Driza1, kontrata koncensionare Nr.10225 Rep, Nr.3309 Kol, e lidhur në datën 06.09.2013. HEC Driza1 ka 3 vepra marrje, duke filluar nga përroi i Ademit poshtë kalasë së Nivicës (ne Kanion), e dyta fillon mbi ujëvarën që është mbi shpellën me qiell (Sterra e Çikës) që është monument natyre, dhe me kanale dhe derivacione nëpërmjet tubave bashkohet me veprën e marrjes 3 tek guva (pasi del nga HEC Guva). Godina e HEC Driza është afër Bashkimit me Lumin e Progonatit (Përroi i Gurrës).

3. Kompania **"Radichi Energy"** shpk: (ne listen e konçensioneve rezulton me emrin GEOALBANIA UNO)

1. HEC Lekdush-Progonat – 2009 – 35 – 2700 kë (energji e projektuar për prodhim)
3. HEC Bënçë e sipërme – 2009 – 35 – 4000 kë (energji e projektuar për prodhim)

Për Hec-et e kësaj kontratë nuk ka shumë të dhëna; janë kryer vetëm disa punime të vogla në burimin e Gurrës në Lekdush dhe në Progonat, dhe nga informacionet jo-zyrtare firma është tërhequr.

4. Kompania **"Ferar Energy"** shpk:

1. Hec Bënçë – 2009 - 35 vjet – 1735 kë (energji e projektuar për prodhim)
2. Hec Tepelenë (Tepelenë) – 2009 - 35 vjet – 3670 kë (energji e projektuar për prodhim)

Kontrata koncesionare BOT, nr.266 Rep, nr.116 Kol, date 16.06.2009. HEC Benca ka 1 vepër marrje në luginën e Bënçës në vendin ku ka qënë diga e vjetër dhe nëpërmjet një kanali godina e HEC Bënça do të ndërtohet poshtë fshatit Bënçë, pranë një objekti kulti (mekamet e Baba Shehut), nga këtu, pasi bëhet dekantimi, uji devijohet nëpërmjet një tuneli 3.4 km (nga punimet e të cilit mund të dëmtohet edhe akuadukti i Bënçës - Ujesjellesi i Ali Pashës).

Godina e HEC Tepelenë do të ndërtohet rreth 1 km në jug të qytetit të Tepelenës në parkun e qytetit dhe mbi lagjen **Gurëz** (e cila në fakt mund të shkaktoj përmbytje të kësaj lagje në periudhën e dimrit kur Vjosa Del Nga shtrati).

Fillimisht është prezantuar një tjetër projekt, planvendosja e të cilit është sipas kontratës koncesionare, sipas të cilit do të ndërtoheshin dy diga dhe uji do të merrej me kanal përgjatë shtaratit të lumit. Hec-et Meshanik, Guva, Benca dhe Tepelena kanë leje ndërtimi të vitit 2010 dhe afatet e përfundimit të ndërtimit sipas kontratave koncesionare kanë përfunduar edhe pse kanë marr shtyrje afati.

Edhe pse këto vepra nuk janë ndërtuar ende, në analizën e bilancit të energjisë, dhe duke konsideruar kohëzgjatjen e Planit të Përgjithshëm Vendor, këto vepra do të llogariten si prurje (prodhim) të energjisë. Si përfundim, nga lista e HeC've të projektuar për tu ndërtuar në tërritorin e Bashkisë Tepelenë, kemi një sasi energjie të planifikuar për prodhim

| | EMRI i HeC | Kompania | Fuqia e Instaluar kë |
|---|---|---|---|
| 1 | HeC Meshaniku | GUSMARI shpk | 300 |
| 2 | HeC Guva | GUSMARI shpk | 1350 |
| 3 | HeC Driza | KENDREVIC ENERGY shpk | nuk ka informacion |
| 4 | HeC Driza 1 | KENDREVIC ENERGY shpk | nuk ka informacion |
| 5 | HeC Lekdush - Progonat | GEOALBANIA UNO | 2700 |
| 6 | HeC Bençe e sipërme | GEOALBANIA UNO | 4000 |
| 7 | HeC Bencë | FERAR ENERGY shpk: | 1735 |
| 8 | HeC Tepelenë | FERAR ENERGY shpk: | 3670 |
| TOTAL | | | |

### 2.2.3.5 KOMUNIKIMI ELEKTRONIK

Në epokën moderne të teknologjisë, mjetet e komunikimit masiv kanë ndryshuar jashtëzakonisht shumë, ku interneti është kthyer në një instrument tërësisht revolucionar në mediumet e komunikimit personal dhe publik. Në ditët tona, informatika luan një rol themelor në shoqërinë bashkëkohore dhe mendohet së në të ardhmen numri i përdoruesve të internetit sa do të vijë e do të rritet, pasi interneti është shndërruar në një mjet komunikimi të fuqishëm masiv. Në këtë kontekts, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon që në periudhën 15 veçare në zbatim të Planit, duhet të:

1. Duhen marrë masa për krijimin e aksesit dhe linjave operative të komunikimit elektronik të shpejtësisë së lartë në të gjithë zonën qendrore të Bashkisë Tepelenë, dhe konkretisht në zonat urbane përgjatë rrugës interurbane SH4 Levan – Tepelenë – Gjirokastër si dhe ato përgjatë korridorit të rrugës interurbane SH76 Tepelenë-Vlorë.
2. Plani përcakton si domosdoshmëri krijimin dhe konsoldimin e linjave të komunikimit elektronik në të gjtiha objektet e rëndësishme institucionale ekonomike dhe social kulturore duke përfshirë shkollat, qendrat shëndetësore, zyrat, etj.
3. Qyteti Tepelenë duhet të akomodojë zona të dedikuara për komunikimin elektronik. Për këtë Plani propozon fillimisht qendrën e rikonstruktuar të qytetit si zonë të komunikimit të lirë WIFI, praktikë kjo që mund të replikohet edhe në zona apo rrugë të tjera të qytetit. Përveç përmirësimit të parametrave të komunikimit, kjo ndërhyrje do të mundësojë edhe rivitalizimin e jetës sociale të qytetit Tepelenë, një element ky thelbësor në të gjithë kontekstin e zhvillimit strategjik urban, ekonomik dhe social të Bashkisë.

4. Plani thekson nevojën e mbështetjes së operatorëve privatë të këtyre shërbimeve në territorin e Bashkisë Tepelenë, duke krijuar incentiva financiare apo teknike për shtrirjen e rrjetit të komunikimit elektronik në të gjitha zonat e kësaj Njësie Vendore.

Ndërkohë, për sa i përket rrjetit të antenave të komunikimit, miratimi i pozicionit të vendosjes së tyre, jo vetëm për Bashkinë Tepelenë bëhet në nivel qëndror. Duke iu referuar përcaktimeve të VKM Nr.686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar,Plani i Përgjithshëm Vendor thekson se:

- Përzgjedhja e pozicionit të ngritjes së antenave të komunikimit elektronik duhet të bëhet në referencë me legjislacionin e posaçëm për infrastrukturën përkatëse, në mënyrë që të minimizojë numrin e tyre dhe ndikimet negative pamore, akustike dhe shëndetësore për njerëzit dhe të garantojë sigurinë publike. Konkretisht baza ligjore kryesore për këto projekte konsiston në:
    - Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar
    - Ligji Nr. 10469, date 13/10/2011 "Për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jo-Jonizuese", i ndryshuar;
    - VKM Nr. 743, date 16/10/2012 "Për Miratimin e Rregullores për Mbrojtjen e Publikut nga Rrezatimet Jo-Jonizuese" e ndryshuar;
    - Ligji Nr. 10440, date 07/07/2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"[4]
    - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë e ndryshuar;
- Për të zvogëluar ndikimin pamor të kullave dhe antenave, strukturat përkatëse fshihen dhe maskohen.
- Kullat e telekomunikacionit, që janë të larta mbi 25 metra, nuk lejohen të ndërtohen e të vendosen brenda zonave të përcaktuara si zona banimi. Distanca e tyre minimale nga kufizimi i pronës më të afërt të ndërtuar është 30 metra.
- Pozicionet e kullave dhe antenave në qytete duhet të jenë në përputhje me udhëzimet dhe standardet e komisionit për radiofrekuencat në autoritetin publik përkatës dhe të garantojnë mbrojtjen e shëndetit të banorëve.
- Kullat dhe shtyllat e antenave të komunikimit elektronik nuk lejohen të ndërtohen ose të vendosen brenda zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore

Rritja e vazhdueshme e telefonisë celulare në ditët e sotme ka tërhequr vëmendjen e publikut mbi rreziqet potenciale të cilat shkaktohen nga ekspozimi ndaj fushës elektromagnetike të radio frekuencave.

Ndikimi i fushave të dobëta elektromagnetike në trupin e njeriut arrihet si pasojë e disa ngjarjeve të cilat përfshijnë ekspozimin nga rrezatimet elektromagnetike i cili pasi përthithet

[4] Shtojca II e Ligjit i klasifikon antenat si aktivitet që i nenshtrohet procedures paraprake te Ndikimit në Mjedis dhe pajisja me vendim për VNM paraprake specifikohet në piken 10 "prodhime infrastrukture/ a) projekte për zhvillimin e pasurive te patundshme industriale"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
SEKRETARIA

ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
info@archi-space.com NIPT: L31903012A

modulon strukturat biologjike, akumulon energji në lëngjet e trupit, shkakton ndryshime në aktivitetet funksionale të qelizës të cilat me pas shkaktojnë disa sëmundje. Numri i përdoruesve të celularëve është rritur eksponencialisht së fundmi dhe celulari është bërë një mjet i domosdoshëm për njerëzit. Kjo gjë ka rritur dhe rrezatimin elektromagnetik të mjedisit në tërësi. Vlerësimet e ekspozimit në radio frekuencë nga fusha elektromagnetike mund të ndahen në dy kategori:

- vlerësimi i fushës rënëse, domethënë kuantifikimi i fushës elektromagnetike
- kuantifikimi i fushës elektromagnetike të induktuar nga trupat biologjikë

Ekziston një numër rregullash ndërkombëtare, standarte sigurie dhe rekomandime të cilat janë të lidhura me ekspozimin radiofrekuencë për stacionet radio bazë. Limitet brenda këtyre standarteve janë të ngjashme dhe shpesh janë të bazuara në udhëzime ndërkombëtare të caktuara nga komisioni ndërkombëtar për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese (ICNIRP) dhe nga organizata botërore e shëndetësisë (ËHO). Kufizimet bazë për ekspozimin profesional dhe publik ndaj fushave elektromagnetike të cilat nuk duhen tejkaluar në asnjë situatë ekspozimi të fushave të afërta ose të largëta janë zhvilluar nga ICNIRP

Distanca e sigurisë është largësia minimale që duhet të mbahet midis antenës dhe një personi për të siguruar që kufijtë e ekspozimit nuk janë tejkaluar. Për të instaluar një antenë stacioni radio bazë në mënyrën e duhur është e rëndësishme që distancat e sigurisë të ekspozimit radio frekuencë të jenë të përcaktuara dhe nivelet e ekspozimit RF të jenë nën kufijtë e specifikuar në mjediset e aksesueshme nga publiku i përgjithshëm. Distancat e sigurisë përgjithësisht janë të ndryshme në drejtime të ndryshme nga antena. Metodat e vlerësimit analitik të ekspozimit radio frekuencë mund të përdoren për të përcaktuar distancat e pajtueshmërisë si për punonjësit ashtu dhe për publikun e përgjithshëm.

### 2.2.3.6 ADMINISTRIMI I UJIT

Bashkia Tepelenë disponon një seri trupash të rëndësishëm ujore në territorin që ajo administron. Konkretisht lumi i Vjosës, lumi i Bënçës dhe lumi i Drinos përbëjnë elementët më të rëndësishëm territor-formues të kësaj zone, duke ndikuar në skemën e shpërndarjes së zonave të banimit, në organizimin e formave të komunikimit, si dhe në atë që është ndoshta më e rëndësishme, në zhvillimin dhe konsolidimin e burimeve ujore si një aset vital dhe të domosdoshëm në zhvillimin aktual dhe perspektiv të Bashkisë. Së bashku me rrjedhat e shkurtra tributare, këta lumenj ofrojnë një potencial të konsiderueshëm për mbështetjen e të gjitha aktiviteteve që kanë lidhje me bujqësinë, agrobiznesin, blegtorinë, por edhe turizmin natyror dhe atë të aventurës në territorin e Bashkisë Tepelenë.

Lidhur me këtë komponent të rëndësishëm, Plani i Përgjithshëm Vendor është bazuar në objektivat strategjikë të sektorit të ujit dhe kanalizimeve, të cilat në mënyrë të përmbledhur rradhiten si vijon:

- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve;
- Sigurimi i nje furnizimi të plotë dhe të sigurte me uje të pijshem për popullsinë urbane dhe rurale;
- Lidhja e të gjitha zonave të banuara urbane dhe rurale të njësise vendore me rrjetet e ujërave të zeza;
- Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i cili është i lidhur me një impiant përpunimi.
- Hartimi dhe realizimi periodik i vrojtimit të nevojave kombëtare për të përcaktuar projektet prioritare për investime.

Edhe pse Bashkia Tepelenë disponon burime ujore të konsiderueshme, është e nevojshme të konsolidohen praktika eficiente të shfrytëzimit dhe administrimit të aseteve, duke evituar shpërdorimet e panevojshme. E gjithë kjo duhet të bazohet në vlerësimin dhe inventarizimin e kujdesshëm të burimeve ujore, në analizën e gjendjes së tyre si dhe shfrytëzimin sipas planeve të mirëfillta të biznesit. Ndërkohë, për sa përmendur më lart lidhur me burimet, institucioni i Bashkisë mund të mbulojë nevojat për ujë që kanë familjet e varfra dhe në nevojë. Gjithashtu, Plani propozon që orientimi i skemave të furnizmit me ujë të pijshëm dhe shkarkimit të ujërave në Bashkinë Tepelenë duhet të orientohet drejt:

- Rikuperimit të plotë të kostove operacionale dhe të mirëmbajtjes së sistemeve të furnizimit dhe shkarkimit të ujerave në të gjitha territoret e banuara, duke përfshirë këtu shlyerjen e borxheve potenciale si dhe shpenzimet kapitale për riparime dhe zëvendësime;
- Fokusimit të investimeve në reduktimin e humbjeve dhe në eliminimin e formave të konsumit të ujit që nuk gjeneron të ardhura në aspektin ekonomik;
- Krijimin e një sistemi organizimi, monitorimi dhe dokumentimi të aseteve për të gjitha shërbimet e licencuara që përdorin ujin në Bashkinë Tepelenë, të cilat duhet të zhvillojnë, prezantojnë dhe përditësojnë vit pas viti një plan biznesi pesë vjeçar.
- Zhvillimin dhe zbatimin e një programi subvencionimi për familjet e varfra në Bashkinë Tepelenë, të cilat kane pamundesi financiare për të përballuar kostot e përdorimit të sistemeve të furnizimit dhe kanalizimeve

Për sa i përket pikës së fundit, është e pranueshme që tarifat të mos jenë të njëjta për të gjithë ofruesit e shërbimeve, pasi kjo reflekton kostot e ndryshme të shërbimit. Operatorët mund të zgjedhin midis një game të gjerë strukturash tarifash, megjithatë duhet të synohet drejt kalimit gradual në tarifa uniforme që janë transparente, të barabarta dhe lehtësisht të kuptueshme për konsumatorin. Do të ishte e preferueshme një strukturë tarifash që bazohet në vlera fikse dhe në volum, pasi kështu operatorit i garantohen hyrje të parashikueshme parash gjatë të gjithë periudha të vitit

Në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të konsumatorëve si edhe për të arritur efiçencën afatgjatë të sektorit, tendenca e vënies së çmimeve duhet të jetë për aplikimin e tarifave të njëjta për njësi për të gjitha kategoritë e klientëve. Kjo duhet të bëhet gradualisht në periudhën 7-vjeçare.

Të gjitha planet dhe investimet në perspektivën e zbatimit të PPV, lidhur me furnizimin me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Bashkinë Tepelenë duhet të bazohen në riorganizimin hapësinor të njësive urbane të propozuara sipas Planit, duke minimizuar ndikimet negative në terrenet natyrore apo zonat e ndjeshme mjedisore. Synimi është furnizimi me ujë të të gjithë popullates së Njësisë Vendore, nëpërmjet shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve ujore që disponon.

Për ofruesit e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve duhet të aplikohet parimi i rikuperimit të plotë të kostos, gjë që është në përputhje me Direktivat e BE-së për Ujin. Ky është proces gradual, bazuar në të dhënat për aftësinë e konsumatorëve për të paguar në të gjitha zonat e shërbyera të vendit, dhe duhet të zbatohet kurdo dhe kudo që është i mundur. Është detyrë e Entit Rregullator të Ujit që të bëjë vlerësim periodik të mundësisë praktike të rikuperimit të plotë të kostos nga tarifat dhe të përfshijë vlerësimin dhe rekomandimet e veta në Raportin Vjetor.

Një pikë e rëndësishme e Planit të Përgjithshëm Vendor lidhur me sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizime në Bashkinë Tepelenë ka të bëjë me zbatimin e politikës nr 6 të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore 2017-2027, e cila ka të bëjë pikërisht me inventarizimin e aseteve dhe vlerësimi i sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve. Duke iu referuar gjendjes ekzistuese të inventarizimit të rrjeteve ekzistuese, dhe sidomos të gjendjes fizike të këtyre rrjeteve, Plani propozon që brenda një periudhe 3 vjeçare të kryhet inventarizimi i aseteve dhe vlerësimi i të gjithë sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në Bashkinë Tepelenë. Ky proces inventarizimi dhe vlerësimi duhet të kryhet në bazë të kritereve që përcakton Enti Rregullator i Ujit dhe pastaj t'i dorëzohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP). Të gjitha ndryshimet në inventar duhet të pasqyrohen dhe të raportohen çdo vit në ZQRPP.

Aktualisht, shërbimi i furnizimit me ujë të territoreve të banuara të Bashkisë Tepelenë mundësohet nga Shoqëria Ujësjellës – Kanalizime Tepelenë. Sha, duke përrllogaritur një kapacitet furnizimi aktual prej rreth 16.800 personash.

Në Korrik 2017, është kryer riorganizimi i Ujësjelles Kanalizime Sha Tepelenë, në strukturën e të cilës funksionojnë rreth 22 rrjete furnizimi me ujë për qytetin e Tepelenës dhe të fshatrave, dhe konkretisht:

- Ujësjellësi PROGONAT
- Ujësjellësi LEKDUSH

- Ujësjellësi REXHIN
- Ujësjellësi GUSMAR
- Ujësjellësi NIVICË
- Ujësjellësi DOREZ
- Ujësjellësi SINANAJ
- Ujësjellësi MATOHASANAJ
- Ujësjellësi LAB MARTALLOZ
- Ujësjellësi DHËMBLAN
- Ujësjellësi MEZHGORAN
- Ujësjellësi DRAGOT
- Ujësjellësi KODER
- Ujësjellësi VELIQOT
- Ujësjellësi LUZAT
- Ujësjellësi PESHTAN
- Ujësjellësi SALARI
- Ujësjellësi DUKAJ
- Ujësjellësi TURAN
- Ujësjellësi HORMOVË
- Ujësjellësi BENÇE
- Ujësjellësi Q.TEPELENË

Sasia e ujit që prodhohet dhe që hyn në sistemin e shpërndarjes është rreth 2,178,000 m3 në vit, që korresponodon me një vlerë të përafert prej 130 m3 ujë për person në vit, ose 356 litra/person/dite. Kjo është një vlerë e konsiderueshme, ndërkohë që norma e agreguar e kërkesës për ujë llogaritet në 150 l/person/dite. Sipas të dhënave të Njësise së Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues prodhimi mesatar i ujit në nivel kombëtar është mesatarisht 300 litra për frymë në ditë, ndërkohë që shitja mesatare e ujit ishte 110 litra për frymë në ditë. Diferenca mes këtyre dy shifrave tregon qartë masën e "ujit të pafaturuar" sipas kërkesës, dhe përfaqëson sasinë e ujit "që prodhohet por nuk faturohet" për çdo person të furnizuar.

Rrjeti i Ujësjellesit të Tepelenës ka një gjatësi totale prej 85 km, nga të cilat 25 km janë linja të rrjetit kryesor, ndersa linjat e rrjetit shpërndarës kanë 60 km gjatësi. Në vitin 2017, është llogaritur që në të gjithë rrjetin ekzistojnë rreth 547 çarje të tubacioneve, ku një pjesë e mirë e tyre rezultojnë ndërhyrje të parregullta.

Skema e furnizimit me ujë të qytetit të Tepelenës, duhet të marrë në konsideratë ndarjen nga linja e furnizimit të përbashkët me Memaliaj. Volumet e furnizimit duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të akomodojnë një rritje të popullsisë të qytetit prej 20% për perspektiven 15 vjeçare të Planit të Përgjithshëm Vendor. Linjat e furnizimit me ujë të fshatrave duhet të

rikonstruktohen sipas skemave ekzistuese, pa marrë në konsideratë shtim potencial të popullsisë ekzistuese.

Ndërkohë, për sa i përket shërbimit të kanalizimeve të ujërave të zeza, shërbimi është më i kufizuar në vetëm 14,900 persona. Problemi kryesor që lidhet me rrjetet e kanalizimeve të ujërave të zeza në Bashkinë Tepelenë janë mungesa e strukturave/impianteve të posaçme për trajtimin e ujërave të përdorura. Aktualisht, asnjë nga zonat e banuara në këtë njësi vendore nuk disponon linja apo infrastrukturë përkatëse për trajtimin dhe purifikimin e ujerave. Situata është mjaft problematike në qytetin e Tepelenës, ku ujërat e zeza derdhen direkt në lumin Vjosë.

Për shkak të morfologjisë së territorit, rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit të Tepelenës duhet të pajiset me impiant teknologjik të pastrimit të ujerave, duke shmangur derdhjen e ujërave në Lumin Vjosë. Pozicionimi i këtij impianti propozohet të pozicionohet në pjesën veriore të territorit të qytetit. Ndërkohë për pjesën tjetër të zonave të banuara të Bashkisë, dhe konkretisht për fshatrat periferike Plani propozon instalimin e impianteve të vegjël teknologjike të depozitimit - filtrimit të ujerave, të cilët kanë kosto të ulët instalimi, kohë të gjatë përdorimi si dhe eliminojnë tërësisht ndotjen.



*fig 43 - Skeme grafike e sistemeve të propozuara të filtrimit të ujerave në zonat rurale*

Për sa i përket ndërhyrjeve emergjente, Plani i Përgjithshëm Vendor reflekton propozimet e dokumentit të Strategjisë Territoriale, duke i dhënë rëndësi zgjidhjes së problematikave të rrjeteve sipas një shpërndarjeje territoriale të caktuar. Kjo shpërndarje i referohet prioriteteve të zhvillimit të zonave të ndryshme urbane, në sinkron me Vizonin e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkisë Tepelenë. Konkretisht, Plani propozon:

1. Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë të fshatrave Lekdush, Progonat dhe Gusmar, Njësia Administrative Kurvelesh
2. Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatrave Sinanaj, Matohasanaj dhe Dhëmblan të Njësisë Administrative Lopës.
3. Rikonstruksioni i rrjetit të furnizmit me ujë të fshatrave Hormovë, Kodër dhe Lekël

4. Rikonstruksion i rrjetit të furnizmit me ujë të fshatrave Beçisht, Mezhgoran dhe Dragot

Ndërkohë për sa i përket rrjeteve të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe problematikave që paraqesin, në Bashkinë Tepelenë, Plani propozon ndërhyrjet e mëposhtëme:

1. Ndërtimi i impiantit të pastrimit të ujërave të zeza urbane të qytetit të Tepelenës – (propozohet të instalohet në pjesën veriore të qytetit, dhe pikërisht në zonën fushore në krah të lumit të Vjosës. Në këtë impiant mund të akomodohet edhe trajtimi i ujërave të zeza të fshatrave Veliqot dhe Mamaj)
2. Rikonstruksioni i rrjetit të kanalizimeve si dhe impianti septik teknologjik në fshatin Dragot.
3. Rikonstruksioni i rrjetit të kanalizimeve si dhe impianti septik teknologjik në fshatin Bënçë.
4. Rikonstruksioni i rrjeteve të kanalizmeve dhe impiantet septike teknologjike të fshatrave të krahinës së Kurveleshit.

Në referencë me përcaktimet e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2017–2027, menaxhimi i burimeve ujore në Bashkinë Tepelenë duhet të jetë një proces që nxit zhvillimin social ekonomik të kësaj Njësie Vendore, nëpërmjet menaxhimit të bashkërenduar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, për të rritur në maksimum mirëqënien sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore. Kësisoj Plani thekson përcaktimet e dokumentit të Strategjisë në nivel kombëtar, i cili do të shërbejë si një udhëzues për të gjitha politikat dhe masat që do të merren në Bashkinë Tepelenë lidhur me menaxhimin e burimeve ujore në perspektivë. Strategjia është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë gjithëpërfshirëse të burimeve ujore, duke përbërë një kuadër mjaft relevant për zhvillimin dhe administrimin e territoreve të Bashkisë Tepelenë, bazuar kjo në burimet ujore që kjo njësi disponon. Në kontekstin strategjik, Plani i referohet politikave dhe objektivave në nivel kombëtar, dhe konkretisht:

1. **Sasia e Ujit** përdorimi i drejtë dhe i balancuar i të gjitha burimeve ujore, që i shërben interesave të të gjithë aktorëve
   a. Menaxhimi i burimeve ujore në nivel baseni
   b. Përcaktimi i masave të rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike
   c. Përmirësimi i shpërndarjes së ujit dhe marrja e masave konservative për depozitimin efikas dhe me barazi
   d. Shpërndarja e barabartë e përfitimeve
   e. Përfshirja publike, shpërndarja e informacionit
2. **Cilesia e Ujit** ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së të gjitha burimeve ujore në nivel kombëtar, duke arritur statusin e "gjendjes së mirë të ujit"
   a. Përcaktimi i masave parandaluese ndaj ndryshimeve klimatike

b. Përcaktimi i "gjendjes së ujit me cilësi të mirë", si dhe i objektivave të përputhshmërisë
c. Hartimi dhe zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore si dhe programet e masave
d. Përfshirja publike, shpërndarja e informacionit

3. **Rreziqet nga uji** ulja e rreziqeve që kanë lidhje me ujin si përmbytjet apo thatësirat, përmes investimeve serioze dhe afatgjata në territorin e Bashkisë

a. Menaxhim i integruar i pasurisë ujore në vendor, duke marrë parasysh katastrofat e ndryshme natyrore;
b. Sigurimi i mbrojtjes nga permbytjet
c. Përgatitja për thatësirat dhe mungesën e ujit
d. Program masash për siguri efektive dhe rezistente në përputhje me ndryshimet klimatike

4. **Informacion mbi ujin** krijimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të përditesuara të informacionit për burimet ujore në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë

a. Sigurimi dhe mirëfunksionimi i sistemeve të monitorimit të ujit;
b. Lehtësimi i sistemeve të kërkimit dhe rritja e kapaciteteve për të zhvilluar njohuritë e nevojshme për monitorimin, vlerësimin e burimeve ujore dhe formulimin dhe marrjen e zbatimin e masave;
c. Përmirësimi i aksesit në informacion dhe në mbledhjen e të dhënave;
d. Ngritja e një strukture organizative dhe koordinuese të ujit dhe klimës;

5. **Administrimi i ujit** menaxhimi i burimeve ujore në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse

a. Përcaktimi i roleve dhe objektivave të qarta për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore
b. Arritja e përputhshmërisë së plotë me parimet e BE për ujin dhe mjedisin, në lidhje me parandalimin, subvencionimin, proporcionalitetin dhe solidaritetin që duhet të zbatohet;
c. Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve, roleve dhe përgjegjësive ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve ujore;
d. Konsolidimi i bashkërendimit dhe planifikimit vendor, sektorial dhe ndërsektorial;
e. Krijimi i institucioneve ekonomike dhe financiare për rikuperimin e kostove
f. Praktikimi i integritetit dhe transparencës në të gjitha politikat ujore, institucioneve të ujit dhe kuadrove të qeverisjes së ujit, duke rritur përgjegjshmërinë dhe besimin në vendimmarrje;
g. Sigurimi i pjesëmarrjes së të gjitha paleve të interesit në trajtimin e çështjeve që kane të bëjnë me menaxhimin e burimeve ujore dhe promovimi i përfshirjes publike dhe ndryshimi shoqeror në lidhje me kulturën e përdorimit të integruar të ujit;
h. Arritja e marrëveshjeve të përshtatshme kufitare;

i. Zbatimi i monitorimit dhe vlerësimit të adminstrimit të ujit aty ku është e përshtatshme, ndarja e rezultateve me publikun e gjerë;

Në kuader të zbatimit të poltikave dhe Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë duhet të trajtojë ujin jo si lëndë të parë konsumi, por si një element thelbësor në zhvillimin dhe ruajtjen e balancave zhvillimore midis sistemeve të ndryshme territoriale. Për shkak të pozicionit gjeografik dhe karakteristikave natyrore, Bashkia Tepelenë disponon një fluks uji të konsiderueshëm, e cila nuk duhet trajtuar kurrsesi si një aset lokal dhe i rëndësisë sekondare.

Masat apo mënyrat e trajtimit të ujit në kanë një efekt të konsiderueshëm në territoret e njësive vendore fqinje si dhe ekosistemet. Konkretisht, mirëadministrimi strategjik i territorit të Bashkisë konsiston në eliminimin e efekteve negative ndotëse ndaj aseteve pozitive dhe potenciale që ky territor disponon, si dhe maksimalizimin e përfitimeve që rrjedhin prej tij.

### 2.2.3.7 MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE

Ndër objektivat kryesorë strategjikë që propozon Plani i Përgjithshëm Vendor, përsa i përket sistemit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Tepelenë, listohen:

1. Përmirësimi gradual i sistemit ekzistues të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, duke përfshirë skema të grumbullimit të diferencuar, si një mundësi shumë e mirë e Bashkisë Tepelenë për të ulur kostot e shërbimit si dhe në uljen e sasisë së mbetjeve që përfundojnë në destinacionin final. Aktualisht, referuar numrit të ulët të banorëve, sistemi aktual i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve nuk është financiarisht rentabël, për shkak të bazës shumë të ulët të taksapaguesve për shërbimin. Grumbullimi i diferencuar do të mundësonte kështu të ardhura për Bashkinë, gjithnjë në favor të përmirësimit të performancës financiare të shërbimit. Ky proces mund të aplikohet kryesisht në materialet si: qelq, plastik, alumin dhe letër/karton, materiale të cilat për momentin ndahen dhe mund të ripërdoren menjëherë.
2. Krijimin e një sistemi të kontrollit, kapjes dhe trajtimit të mbeturinave lundruese, të cilat identifikohen përgjatë rrjedhave të lumit Vjosë, lumit të Bënçës dhe Drinos. Ky sistem është i nevojshëm për kapjen e materialit solid të prodhuar ose të përpunuar, të asgjësuar ose të braktisur përgjatë rrjedhave ujore në tërritorin e Bashkisë Tepelenë. Pjesa më e madhe e këtyrë mbeturinave lundruese përbëhet nga materiale sintetike të tilla si plastike, metali, qelqi dhe gomë, të cilat e kanë origjinën nga hedhja e pakontrolluar pranë zonave urbane dhe rurale. Këto mbeturina akumulohen në lokacione të ndryshme të njohura si pikat fundore – mbeturinat e zhytura ose mbeturinat e bllokuara. Një ndërhyrje e tillë ka një efekt mjaft pozitiv në uljen e nivelit të ndotjes së trupave ujorë. Kjo masë do të ketë një efekt pozitiv jo vetëm në kontekstin e pastrimit të territorit të Bashkisë Tepelenë, por edhe në pastrimin nga ndotja të korridorit blu të Vjosës, i cilësuar si një nga lumenjtë e fundit të egër të Evropës.
3. Shtrirjen e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë.

Aktualisht, shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Tepelenë ofrohet vetëm në qytetin e Tepelenës, në Veliqot, si dhe në një pjesë të korridorit përgjatë rrugës interurbane Levan – Tepelenë – Gjirokastër. Ndërkohë pjesa tjetër e territorit të Bashkisë, pra zonat rurale periferike, nuk e kanë këtë shërbim. Në këto territore, mbetjet urbane të prodhuara thjesht hidhen në pika të caktuara informale, duke shkaktuar ndotje të mjedisit. Gjithsesi duhet thënë se, për shkak të numrit të ulët të popullsisë si dhe të nivelit të ulët ekonomik, sasia e mbetjeve të gjeneruara nga zonat rurale është relativisht e ulët. Një pjesë e banorëve të zonave periferike i djegin mbetjet, e cila shton rreziqet për ndotjen e ajrit apo për shpërthimin e zjarreve sporadike.

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në Bashkinë Tepelenë mundësohet vetëm nga një makinë teknologjike, e cila është aktualisht në gjëndje të amortizuar. Ndërkohë që problemi themelor në këtë shërbim të kufizuar mbetet pika e depozitimit të mbetjeve, e cila ndodhet në pjesën veriore të qytetit, buzë lumit Vjosë. Eliminimi i kësaj pike është evidentuar edhe si sfida kryesore nga ana e Bashkisë, përveç zgjerimit të shërbimit aktual edhe në zonat periferike.

Duke iu referuar përcaktimeve strategjike në nivel kombëtar, mbeturinat e Bashkisë Tepelenë do të kenë si destinacion final landfillin rajonal të Bajkaj në Bashkinë Delvinë. Ky landfill është në shfrytëzim, por shfrytëzimi i tij nga ana e Bashkisë Tepelenë do të mundësohet vetëm pas finalizimit të aksit të ri interurban Kardhiq – Delvinë, i cili do të shkurtojë në mënyrë të ndjeshme distancen e zhvendosjes së mbetjeve. Ndërkohë, një skenar i tillë do të kërkojë në mënyrë të domosdoshme uljen e konsiderueshme të sasive të mbetjeve të gjeneruara në territorin e Bashkisë Tepelenë, dhe si rrjedhim uljen e kostove të transportit dhe të depozitimit në landfillin rajonal.

Dumpsite'i aktual në Bashkinë Tepelenë është mjaft problematik për shkak të pozicionit të tij pranë lumit të Vjosës, si dhe mungesës së parametrave teknike për mbrojtjen e zonave përreth tij nga ndotja. Mungesa e këtyre parametrave bën që shumë mbeturina plastike, kryesisht qese, të përfundojnë në zonat përreth si dhe në lumin Vjosë. Po ashtu problematike mbetet mungesa e masave teknike ndaj ndotjes së ujërave nga filtrimet që shkaktohen gjatë periudhës së shirave.

Referuar propozimeve të dokumentit të Strategjisë Territoriale, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon eliminimin e plotë të këtij dumpsite'i si dhe ndërtimin e një pike të re depozitimi për të gjithë Bashkinë Tepelenë, në distance nga trupat ujore si dhe e mbrojtur nga korrentet ajrore të forta, karakteristike për grykën e Vjosës.

Ndërkohe propozohet ndërtimi i një serie pikash tranzit të depozitimit të mbetjeve, në të cilat do të grumbullohen mbetjet e gjeneruara nga grupet e fshatrave, në varësi të afërsisë midis

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
Architecture - Interior Design - Urban Planning - Architectural Restoration - ARCHISPACE STUDIO

tyre dhe skemës së grumbullimit. Më pas, mbeturinat nga këto pika do të transportohen drejt pikës qëndrore të re të depozitimit, dhe më pas në drejtim të landfillit rajonal të Bajkaj, Pozicionimi i pikave është konceptuar në mënyrë të tillë duke marrë të mirëqenë së i gjithë rrjeti rrugor rural është në gjendje të rikonstruktuar dhe në kushte të përshtatshme për levizjen e mjeteve të pastrimit. Pikat tranzitore nuk mund të instalohen në rast së rrjeti rrugor është jo i rikonstruktuar. Konkretisht, Plani propozon:

- **Ndërtimi i pikës së re qëndrore të depozitimit të mbetjeve** – pika e re propozohet që të pozicionohet në grykën e përroit të Turanit. Pika është në një pozicion qëndror referuar struktures hapësinore të Bashkisë, afër akseve qëndrore të komunikimit si dhe e mbrojtur ndaj korrenteve të erërave të grykës së Vjosës. Propozimi konsiston në krijimin e një pike depozitimi të mbuluar me strukturë të lehtë, duke penguar depërtimin e ujërave të shiut si dhe me hapësirat dhe infrastrukturën e posaçme për ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve.
- **Eliminimi i pikës aktuale të depozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pranë lumit Vjosë**. - Projekti ka rendësi specifike duke i vënë fokusin pastrimit të plotë të terrenit të dumpsite'it ekzistues si dhe zonave të ndotura. Gjithashtu projekti duhet të ketë në konsideratë rivitalizimin mjedisor të terrenit, dhe sidomos nëpërmjet pyllëzimit.
- **Ndërtimi i pesë pikave tranzit të depozitimit të mbetjeve për zonat rurale** – dhe konkretisht:

1. **Në Pllajën e Kurveleshit** – në zonen midis fshatrave Progonat dhe Gusmar. Në këtë pikë do të depozitohen mbetjet e fshatrave të Njësisë Administrative Kurvelesh;
2. **Përgjatë korridorit midis fshatrave Dragot dhe Luadh** – propozohet pranë rrugës kryesore, pranë fshatit Luadh. Pika do të shërbejë për depozitimin e mbetjeve të fshatrave Mezhgoran, Luadh, Peshtan, Beçisht dhe Dragot.
3. **Pranë urës së Leklit** – në këtë pikë do të depozitohen mbeturinat e fshatrave Koder, Lekël, Hormovë dhe Luzat.
4. **Përgjatë korridorit midis Dukaj dhe Salarise** – propozohet pranë rrugës së vjetër Tepelenë – Lopës dhe do të depozitohen mbeturinat e fshatrave Salari, Dukaj si dhe territoreve të banuara midis fshatit Dukaj dhe lagjes Kordhë.
5. **Në grykën e Lopësit** – propozohet midis fshatrave Dhëmblan dhe Matohasanaj dhe do të shërbejë për depozitimin e mbetjeve të fshatrave Dhëmblan, Matohasanaj, Lap-Martalloz dhe Sinanaj.

Duke iu referuar përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar, Plani i Përgjithshëm Vendor thekson së masat dhe veprimet në vazhdim për përmirësimin e sistemit në përgjithësi duhet të bazohen në një sërë parimesh bazë, si më poshtë vijon:

**1. Parimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm**

Zhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të integruar të mbetjeve nënkupton së burimet natyrore do të përdoren me eficiencë, duke nxitur zvogëlimin e gjenerimit të mbetjeve,

ripërdorimin e materialeve të riciklueshme, përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, duke shkaktuar ndikimin më të vogël të mundshëm mbi mjedisin.

2. **Përdorimi i teknologjisë më të mirë të mundëshme bazuar mbi efektivitetin e kostos dhe pranueshmërinë mjedisore.**
Shkarkimet nga objektet e trajtimit të mbetjeve dhe landfill-et, duhet të zvogëlohen maksimalisht dhe në mënyrën më eficiente në aspektin teknik dhe ekonomik.

3. **Parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit të mbetjeve**
Gjeneruesve të mbetjeve i kërkohet të mbajnë përgjegjësi për koston e parandalimit, dhe depozitimit, si dhe të gjitha kostot e menaxhimit të mbetjeve të cilat nuk mbulohen nga të ardhurat që mund të krijohen prej riciklimit të mbetjeve. Këta gjenerues janë gjithashtu përgjegjës për zbatimin e masave parandaluese dhe rekuperuese në lidhje me dëmet që shkaktojnë ose që mund të shkaktojnë në mjedis nga mbetjet që ata gjenerojnë.

4. **Parimi "Ndotësi paguan"**
Ata që ndosin mjedisin, përfshirë dhe ekonomitë familjare, do të jenë përgjegjës për mbulimin e kostove për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë edhe pranimin e masave për parandalimin dhe eleminimin e dëmeve që shkaktohen nga mbetjet që ata shkarkojnë në mjedis.

Parime të tjera për menaxhimin e integruar të mbetjeve në territorin e Bashkisë Tepelenë do të zbatohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar.

### 2.2.3.8 MBROJTJA KOMBËTARE, CIVILE DHE KUNDRA ZJARRIT

Në Korrik të vitit 2019, Kuvendi i Shqipërisë miraton Ligjin Nr. 45 "**Për Mbrojtjen Civile**". Referuar neneve 1 dhe 2 të tij, ky ligj ka për qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe operacionalizimin e mbrojtjes civile, si një proces kompleks për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit. Gjithashtu, ky ligj rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin. Sipas këtij ligji, Bashkia Tepelenë dhe çdo njësi tjetër vendore në Republikën e Shqipërisë, duhet të alokojë jo më pak së 4% buxhetit vjetor që kanë në dispozicion për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive si dhe për mbrojtjen civile.

Gjithashtu, sipas këtij Ligji, Bashkia Tepelenë duhet të hartojë dhe të zbatojë dokumentin vendor të **Strategjisë së Zvogëlimit të Riskut ndaj Fatkeqësive**, si një detyrim ligjor brenda rolit dhe përgjegjësisë së saj. Ky dokument strategjik vendor duhet të ketë të integruar në të edhe Planin e Emergjencave Civile për Bashkinë Tepelenë, të koordinuar me planin përkatës

në nivel Prefekture. Ky Plan duhet të ketë një fokus të posaçëm për sa i përket mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe infrastrukturës kritike në të gjithë tërritorin e Bashkisë.

Duke iu referuar përcaktimeve të ligjit të cituar, Plani i Përgjithshëm Vendor thekson së Planet për Emergjencat Civile në Bashkinë Tepelenë nuk duhet të kufizohen vetëm në nivelin e institucionit të Bashkisë por duhet të shtrihen edhe për subjektet private që operojnë në sektorët e shëndetësisë, të arsimit, mirëqenies sociale, kulturës, të mjedisit dhe turizmit. Po ashtu këto plane duhet të jenë të detyrueshme për subjektet që prodhojnë dhe magazinojnë materiale të rrezikshme, karburante apo derivate të tyre, apo që mund të kryejnë veprimtari me mjete të rrezikshme në brendësi të territorit të Bashkisë. Pikërisht Ligji Nr. 45 "**Për Mbrojtjen Civile**", ndan qartë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve, të subjekteve private, të organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile dhe të shtetasve në tërësi, bashkë me detyrimet specifike që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të parashikuara në përputhje me Kuadrin Sendai[5]. Ky kuadër ndërkombëtar për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030, pranon së shteti ka rolin kryesor në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, megjithatë, përgjegjësia duhet të ndahet me aktorë të tjerë, duke përfshirë qeverisjen lokale dhe sektorin privat. Platformat kombëtare dhe lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë janë të njohura në Kuadrin Sendai si aktorë kryesorë për të arritur një zbatim të koordinuar të strategjive, planeve dhe veprimeve të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë.

Plani i Emergjencës Civile të Bashkisë Tepelenë duhet të përmbajë sanksione të qarta për të gjithë institucionet publike, por edhe subjektet private, që kanë të bëjnë me marrjen dhe zbatimin e masave për zvogëlimin e riskut dhe të fatkeqësive natyrore. Për përballimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave civile në territorin e vet, Bashkia Tepelenë duhet të krijojë struktura mbi baza të përkohshme dhe të përhershme, në varësi të situatës. Plani nuk propozon masa që kanë të bëjnë me territorin apo që ndikojnë në rrjetet e infrastrukturave në kontekstin e emergjencave civile. Ndërkohë, për sa i përket automjeteve të posaçme, duke iu referuar shtrirjes hapësinore të Bashkisë, Plani propozon një numër minimal prej **3 mjetesh** të posaçme për shuarjen e zjarreve.

Për sa i përket mbrojtjes nga zjarri, Bashkia Tepelenë duhet të respektojë dispozitat e përcaktuara në Ligjin Nr.152/2015 datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Sipas këtij ligji, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në Bashkinë Tepelenë duhet të jetë një strukturë e specializuar, në gatishmëri të përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në

[5] Kuadri SENDAI për Reduktimin e Rrezikut nga Katastrofat 2015-2030, është marreveshje multilaterale në nivel global, e cila perfshin shtate objektiva specifike si dhe kater prioritete për veprim për tu respektuar nga te gjitha vendet anetare te Asamblese. Ajo është miratuar nga Asambleja Nacionale e Kombeve te Bashkuara në vitin 2015, në kuader te Konferences se Trete Boterore te Kombeve te Bashkuara për Reduktimin e Rrezikut nga Katastrofat

aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut, në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë.

Sektori i shërbimit të MZSHsë në Bashkinë Tepelenë është në varësi të kryetarit të Bashkisë, dhe përfaqëson strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në të gjithë territorin e kësaj njësie vendore. Sipas detyrimeve ligjore, ky sektor duhet të jetë i aftë që të mbulojë dhe të përballojë me shërbim zjarrfikes të gjithë territorin e Bashkisë. Duke iu referuar kontekstit ekzistues të shpërndarjes së zonave urbane dhe rurale, si dhe mundësive të kufizuara financiare Plani nuk propozon stacione të tjera zjarrfikëse në territorin e Bashkisë, duke qënë së në territorin e kësaj Njësie Vendore nuk specifikohen objekte strategjike specifike, të cilat sipas ligjit do të kenë nevojë për stacione të shërbimit të MZSH-së.

Sektori i shërbimit të MZSH-së në Bashkinë Tepelenë ka këto detyra:

a) marrjen e masave të inspektimit, parandalimit dhe ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin në territorin e Bashkisë;

b) drejtimin e shërbimit të MZSH-së për gatishmërinë e personelit, të automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse;

c) zbatimin e ligjshmërisë, zbatimin e masave inspektuese dhe parandaluese për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në të gjitha objektet në territorin e Bashkisë;

ç) bashkëpunimin, koordinimin e veprimeve të strukturave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin me strukturat e tjera operuese dhe inspektuese që veprojnë në territorin e Bashkisë;

d) mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të shërbimit të MZSH-së, si dhe përpilimin e statistikave për aktivitetin dhe veprimtarinë e shërbimit në nivel vendor, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike;

e) drejton dhe përgjigjet për rritjen e aftësive profesionale të personelit të MZSH-së, të shërbimit vullnetar, për zbatimin e programit të përgatitjes së tyre profesionale, dhe zhvillon mësime treguese për dhënien e njohurive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë thekson rëndësinë e konsolidimit të masave kuadër për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, në projektimin dhe ndërtimin rutinë të objekteve të reja civile apo publike. Në këtë kuadër

- Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është pjesë përbërëse e dokumentacionit që kërkohet për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit për çdo objekt civil apo publik në territorin e Bashkisë Tepelenë
- Objektet e çdo lloji, sipas shkallës së qëndrueshmërisë ndaj zjarrit dhe rrezikshmërisë ndaj tij, ndahen në kategori, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit.

- Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve dhe administrimin e zonave të mbrojtura etj., përfshijnë edhe projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

### 2.2.3.9 INFRASTRUKTURA ARSIMORE DHE SHËNDETËSORE

Referuar analizës së gjendjes ekzistuese të sistemit arsimor, në territorin e Bashkisë Tepelenë funksionojnë:

- 1 Shkollë e Mesme e Përgjithshme – në qytetin e Tepelenës
- 24 Shkolla 9-Vjeçare – në qytetin e Tepelenës dhe në fshatrat Veliqot, Mamaj, Turan, Dukaj, Salari, Dhëmblan, Matohasanaj, Sinanaj, Nivicë, Gusmar, Progonat, Lekdush, Bënçë, Luzat, Hormovë, Lekël, Kodër, Beçisht, Dragot, Peshtan, Mezhgoran
- 16 Kopshte - në qytetin e Tepelenës dhe në fshatrat Veliqot, Bënçë, Turan, Hormovë, Luzat, Dragot, Mezhgoran, Kodër, Dukaj, Salari, Sinanaj, Dhëmblan, Progonat

Qyteti Tepelenë si dhe ish-komunat, tashmë pjesë administrative të Bashkisë, të përfshira në të në saj të Reformës së re Administrative Territoriale, kanë trashëguar një infrastrukture shkollore të plotë, për sa i përket numrit të shkollave, shtrirjes së tyre si dhe hapësirave mësimore. Ndërkohë, rënia e konsiderueshme e numrit të nxënësve për shkak të migrimit të banorëve të fshatrave ka rezultuar në shumë raste në shkolla thuajse të boshatisura, me shumë pak nxenës dhe mësues.

Referuar propozimeve të dokumentit të Strategjisë Territoriale, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon rigrupim të strukturave arsimore, e cila do të rezultojë në uljen e numrit të përgjithshëm të shkollave, por do të ndikojë në rritjen e cilësisë. Megjithatë këtu duhet pasur parasysh së ky rigrupim, mund të shkaktojë një devijim nga normativat urbanistike. Për përcaktimin e distancave midis institucioneve arsimore dhe zonave të mbulimit janë marrë në konsideratë përcaktimet urbanistike empirike, pasi as kuadri rregullator në fuqi për planifikimin e territorit, dhe as Ligji Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nuk identifikojne përcaktimet orientuese territoriale. Duke iu referuar këtyre vlerave bazë, distancat e shkollave në territorin e Bashkisë Tepelenë duhet të jenë:

- Shkolla fillore dhe 9-vjeçare në vijë ajrore është 500-600 metra në zona urbane dhe 1,000-1,500 metra në zona rurale
- Shkolla e mesme në vijë ajrore është 1,000-1,500 m në zona urbane dhe 2000 – 4,500 m në zona rurale




*fig 44 - Harta e shpërndarjes së shërbimit arsimor dhe shëndetësor*

Në këtë konstekst propozohet rigrupimi i shkollave funksionale, nëpërmjet orientimit të nxënësve drejt shkollave të përqëndruara, duke rritur në këtë mënyrë numrin e nxënësve nëpër klasa, efiçiencën e mësimdhënies si dhe uljen e kostove administrative. Më pak shkolla nënkupton më pak mësues të nevojshem, më pak kosto administrative si dhe mirëmbajtje. Konkretisht, propozohet konsolidimi i nukleve të shërbimeve arsimore si më poshtë:

- Konsolidimi i shkollës "Selam Musa" në fshatin Sinanaj si shkolla e vetme 9-vjeçare në Lopës, duke akomoduar edhe nxënësit e shkollave "Halim Ramo" në Dhëmblan si dhe "Sali Beqiri" në Matohasanaj.
- Konsolidimi i shkollës 9-vjeçare "Memo Nexhipi" në fshatin Dukaj si strukturë qëndrore, duke akomoduar nxënësit e shkollës "Kordhaj" në lagjen Kordhaj pranë Vjosës, shkollës "Ferit Çela" në fshatin Turan dhe shkollen "Mustafa Zoto" në fshatin Salari.

- Konsolidimi i shkolles 9-vjeçare "Asim Zeneli" në fshatin Progonat, duke akomoduar edhe nxenesit e shkollës "Çobo Mërkuri" në fshatin Gusmar, shkolles "Shuko Dalipi" në fshatin Nivicë si dhe shkolles "Sinan Kërpi" në Lekdush
- Konsolidimi i shkolles 9-vjeçare "Polo Bezhani" në Lekël duke akomoduar nxenesit e shkollave "Misto Shumeli" në Koder dhe "Nevro Selimi" në Hormovë
- Konsolidimi i shkolles 9-vjeçare "Jaçe Banushi" në Dragot duke akomoduar nxënësit e shkollave "Llukan Ceka" në Peshtan, "Xhaferr Bani" në Mezhgoran dhe "Anashor Halimi" në Beçisht.

Ndërkohe shkollat "Fato Kuçi" në Bënçë, "Brahim Mama" në Mamaj dhe "Seit Demiri" në Luzat mund të akomodohen në shkollat "7 Marsi" dhe "Avni Rustemi" në qytetin e Tepelenës.

Shërbimi shëndetësor në Bashkinë Tepelenë ofrohet nëpërmjet Spitalit Bashkiak si dhe 32 qëndrave shëndetësore primare, nga të cilat 14 prej tyre ndodhen në njësinë administrative Qendër Tepelenë, e motivuar kjo për shkak të numrit më të madh të fshatrave, në krahasim me njësitë e tjera administrative. Për shkak të rënies së popullsisë, një pjesë e madhe e qendrave të vogla shëndetësore janë mbyllur, ndërsa shërbimet janë fokusuar në qendrat shëndetësore në ish qendrat e Komunave.

Në mungesë të Qendrave Shëndetësore banorët detyrohen të shkojnë drejt spitalit të Tepelenës, apo të Gjirokastrës. Mungesat në shërbimin shëndetësor ndihen kryesisht në fshatrat Kodër, Veliqot, Salari, Beçisht, Turan, Lekël, etj. Në përgjithësi evidentohet mungesa e specialisteve për shumë nga shërbimet e kërkuara nga banorët. Ka mungesë të mjekëve kirurgë, specialistëve ORL, mjekeve të reanimacionit, obstetër etj. Aktualisht spitali i qytetit disponon vetëm tetë mjekë të specialitetit të përgjithshëm. Në nivel kombëtar, shërbimi i shëndetit publik është i organizuar në tre nivele. Në nivel Qarku funksionojnë spitalet dhe ambulancat qëndrore, në ish qendrat e rretheve funksionojnë spitalet ndërsa në qytezat e vogla funksionojne shërbimet ambulatore. Zonat periferike dhe ato të thella rurale kanë nga 1 mjek e nga 1 infermier, sa për vizita të pergjithshme, shërbim parësor dhe injeksione.

Normativa e shërbimit është (ka qënë) mesatarisht 1 mjek dhe 1 infermier për 10 mijë banorë. Sipas skemës së shërbimit shëndetësor, spitalet në qëndrat e të 12 Qarqeve do të vazhdojnë të kryejnë këtë funksion shërbimesh komplekse shëndetësore. Ndërsa spitalet e tjerë, përfshire spitalin e Tepelenës, do të shërbejnë për rastet e urgjencave. Koncepti në këtë skemë bazohet në idenë e krijimit të niveleve hierarkike të shërbimit shëndetësor, duke ulur kostot e shërbimit në nivel kombëtar.

Bazuar në të njëjtin koncept ndërhyrës të rigrupimit të shërbimeve si dhe nevojave të konstatuara më emergjente, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë, për sa i përket shërbimt shëndetësor propozon:

- Rikonstruksioni i plotë i Q.SH. Lopës, në fshatin Sinanaj – kjo qëndër mbulon nevojat për fshatrat e Lopësit
- Ndërtimi i një qëndre të re shëndetesore në fshatin Dragot – për të siguruar shërbimin për popullsinë e fshatrave Dragot, Beçisht, Luadh, Mezhgoran, Peshtan, Koder dhe Lekël
- Ndërtimi i një qëndre të re shëndetësore në Dukaj – praktikisht ndërtesa e qëndres është terësisht jashtë funksionit. Kjo qendër mund të shërbejë për fshatrat Dukaj, Kordhaj (Dukaj), Turan dhe Salari.

Propozimet strategjike marrin parasysh faktin që Q.SH. Tepelenë, Q.SH. Qendër si dhe Q.SH. Kurvelesh janë rikonstruktuar së fundmi me investim të qeverisë shqiptare.

## 3.3. PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Në koherencë me propozimet e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Tepelenë, është detajuar platforma e mbrojtjes së mjedisit, e cila përcakton normat dhe standardet mjedisore dhe peizazhistike për çdo zhvillim apo aktivitet të lejuar në territorin e Njësise vendore. Ky instrument synon përmirësimin e parametrave mjedisore, estetike dhe peizazhistike gjatë fazës së zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, dhe konkretisht gjatë hartimit të projekteve teknike të infrastrukturës apo Planeve të Detajuara Vendore (PDV).

**Plani i Mbrojtjes së Mjedisit** (PMM) është menduar si një instrument operacional dhe guide referuese në funksion të zgjidhjes dhe menaxhimit të problematikave ekzistuese dhe potenciale të mjedisit në Bashkinë Tepelenë, dhe pikërisht nëpërmjet adaptimit të një metodologjie të integruar të elementëve të menaxhimit urban me komponentët mjedisorë dhe peizazhistikë.

### 3.3.1 KUADRI RREGULLATOR PËR MBROJTJEN E PEIZAZHIT

Kuadri rregullator referues lidhur me peizazhin në Shqipëri është ende në fazë të pakonsoliduar. Ligji për Planifikimin dhe Menaxhimin e Territorit si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij nuk kanë të integruar elemente specifike të trajtimit të peizazhit urban apo peizazhit mjedisor, rural, industrial, etj. Aktualisht Shqipëria ende nuk është pjesë e Konventës Europiane të Peizazhit, (Firence 2000), e cila peërbën edhe dokumentin themelor në nivel evropian që i kushtohet në mënyrë të dedikuar administrimit të të gjithë elementëve të peizazhit evropian. Në mënyrë të përmbledhur, çdo palë anëtare e kësaj konvente ka detyrimin që:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration

a) te njohë juridikisht peizazhin si një komponent themelor të kontekstit jetësor të popullatave brenda kufijve europiane, si nje shprehje të larmisë së trashëgimisë së tyre të përbashkët kulturore e natyrore, dhe themel të identitetit të tyre;
b) të përcaktojë e të zbatojë politika të tilla për peizazhet që të synojnë mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e tyre nëpërmjet marrjes së masave të veçanta parashikuar nga neni 6 i Konventës;
c) të krijojë procedura pjesëmarrjeje të publikut, të autoriteteve lokale e rajonale, dhe të protagonistëve të tjerë të interesuar për hartimin dhe realizimin e politikave të peizazhit në çdo nivel;
d) te përfshijë peizazhin në kuadrin e politikave që kanë të bëjnë me menaxhimin e territorit e të urbanizmit, dhe në kuadrin e politikave kulturore, mjedisore, bujqësore, shoqërore e ekonomike, si dhe në kuadrin e politikave të tjera që mund të kenë një efekt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi peizazhin;

Nëse i referohemi parimeve të Konventës, termi "Peizazh" ka të bëjë me të gjitha hapësirat natyrore, rurale, urbane dhe periurbane të një territori të caktuar. Përfshin hapësirat tokësore, ujërat e brëndshme dhe detare të një shteti, rajoni apo zonë specifike. Po ashtu, ky term ka të bëjë si me peizazhet që mund të konsiderohen të veçanta, ashtu dhe me peizazhet e mjedisit të përditshëm si dhe peizazhet e degraduara.

Për efekt të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë, "Menaxhimi i Peizazhit" do të nënkuptojë të gjitha ato veprime që garantojnë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e qëndrueshme të elementëve të një peizazhi, në harmonizim me ndryshimet që rrjedhin nga proceset dinamike sociale, ekonomike dhe mjedisore. Plani trajton masat e nevojshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e:

- peizazhit urban dhe industrial
- përmirësimin e cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e elementëve lumore
- përmirësimin e cilësisë së ajrit
- shtimin e hapësirave të gjelbra
- zgjidhjen e problematikës mjedisore dhe vatrave të evidentuara;

### 3.3.1.1 GJELBËRIMI I PEISAZHIT URBAN NË BASHKINË TEPELENË

Peizazhi urban në qytetin e Tepelenës, falë ndërhyrjeve fizike të viteve të fundit ka pësuar një transformim të konsiderueshëm pozitiv, me ripërtëritjen e elementëve të mobilimit urban të qëndrës së qytetit, fasadave të qëndrës si dhe një pjesë të mirë të rrugëve të brendshme. Këtu vlen të përmendim ndërhyrjen në sheshin kryesor të qytetit, me një kompozim bashkëkohor midis elementëve historikë arkitektonikë të Kalasë së Ali Pashës dhe elementëve moderne të mobilimit urban.

Ndërkaq, nuk mund të flitet njësoj për zonat rurale apo fshatrat periferike të kësaj njësie vendore, të cilat vazhdojnë të paraqesin një panorame problematike të peizazhit urban, të

shkaktuar nga mungesa e investimeve fizike për periudha të gjata kohore. Në këtë kontekst Plani i Përgjithshëm Vendor thekson domosdoshmërinë për ndërhyrje graduale peërmirësuese në të gjitha elementët e peizazhit të zonave rurale periferike, sidomos nëpërmjet ndërthurjes së përbërësve të peizazhit natyror në brendësi të zonave urbane, gjithnjë duke ruajtur dhe fuqizuar elementët karakteristikë të çdo vendbanimi.

Në kuadër të ndërhyrjeve specifike për peizazhin urban si në qytetin e Tepelenës, ashtu edhe në zonat periferike rurale, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon:

1. Intensifikimin e gjelbërimit ekzistues përgjatë rrugëve si dhe plotësimin e segmenteve jo të gjelbëruara me pemë të reja. Ndërkohë, Plani thekson rëndësinë e ruajtjes së konfiguracionit dhe struktures së gjelbërimit ekzistues, pa qënë nevoja për zëvendësimin e të gjitha pemëve në një ndërhyrje të caktuar. Konkretisht, nëse përgjatë një segmenti rrugor identifikohen pemë që i kanë rezistuar kohës dhe efekteve klimatike, gjatë hartimit të projekteve teknike apo PDV've, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon ruajtjen e tyre, me qellim ruajtjen e tipareve karakteristike të peizazhit dhe të memories së gjelbër të rrugës. Ndërkaq, trajtimi teknik i shtretërve të pemëve duhet të ndjekë një tipologji përgjatë të gjithë segmentit të rrugës, si në aspektin e materialit të përdorur, përmasave dhe formës. Hapësira filtruese në rrëzë të pemëve duhet të jetë e mjaftueshme për të lejuar depërtimin e ujit, por pa penguar lëvizjen e lirshme të këmbësorëve. Rekomandohet që në rrugët kryesore të qytetit të Tepelenës si dhe përgjatë trotuareve të ngushtë në brendësi të lagjeve të përdoren zgara metalike, të cilat vendosen mbi hapësirën filtruese të bazës së pemës.



*fig 45 - Foto ilustruese të zgarave filtruese metalike në rreze të pemeve pergjate rrugëve*

2. Përcaktimi i llojeve të pemëve për tu mbjellë përgjatë segmenteve rrugore jo të gjelbëruara duhet të bazohet në përzgjedhjen e jo më shumë së dy lloje drurësh, të cilët mund të aplikohen të ndarë në mënyrë specifike në të dy anët e rrugës, ose në të dy anët e një trotuari, nëse ai disponon gjerësi të mjaftueshme. Nuk rekomandohet përdorimi i tipeve të ndryshme të drurëve nga njëra anë e një trotuari të rrugës, i cili formohet prej

intersektimit të aksit të rrugës me dy akse të tjera, pasi dëmton konsolidimin e një karakteri dallues dhe referues të aksit. Ndër llojet e pemëve të përshtatshme për tu marrë në konsideratë janë:



*fig 46 - Shembull ilustrues i gjelbërimit të nje korridori kembesor me dy tipe të veçanta pemesh – Shanghai, Kinë*

- ***Pemët me strukture piramidale***, këtu mund të përmenden llojet e ndryshme të bredhave, të cilët kanë një konfigurim të dallueshem vertikal, me degët që dalin prej trungut në forma relativisht të rregullta. Këto lloj pemësh kanë një efekt estetik shumë të fortë, dhe rekomandohet të aplikohen në hapësira të gjera dhe lulishte, ndërkohë që nuk janeë shumë të rekomandueshme për gjelbërim trotuaresh.
- ***Pemët me strukture ovale*** si bliret, rrepet apo manjolat, të cilat përshtaten më së miri në rrugët e qytetit pasi ato rriten në vertikalitet duke mos ndikuar në trafikun e automjeteve. Gjithashtu këto lloj drurësh mund të mbillen në afërsi të ndërtesave duke krijuar keshtu elemente interesant të peizazhit urban. Gjithsesi aplikimi këtyre lloj drurëve duhet bërë me kujdes pasi ato mund të arrijnë lartësi të mëdha, dhe të krijojnë perde të gjelbra për silueta të caktuara urbane. Gjithashtu, mbjellja e tyre mund të ndikoj tek infrastruktura nëntokësore që kalon pergjate trotuareve
- ***Pemët me strukturë të qartë vertikale***, ku mund të përmendet selvia apo kavaku (një lloj plepi) të cilët kanë një konfiguracion të dukshëm vertikal dhe një gjatësi të konsiderueshme. Këto pemë vlerësohen për gjerësinë e tyre të ngushtë e cila i mundëson atyre të mbillen në hapësirat e ngushta ku nuk ka vend të mjaftueshëm për një pemë me një strukturë ovale apo të rrumbullakët.
- ***Pemët me strukturë të rumbullakët***, ku një nga llojet me karakteristike është ai i pishës së butë. Këto lloje pemësh krijojnë një volum dhe identitet të konsiderueshëm në rrugët apo hapësirat që aplikon. Për shkak të përmasave të mëdha që merr kurora,

këto lloj pemësh propozohen përgjatë rrugëve me seksion të gjerë tërthor, dhe sidomos në ato korridore ku kurora e pemëve nuk bllokon tërësisht fasadat e ndërtesave. Gjithsesi, ky lloj druri është një nga llojet më të fortë dhe të durueshëm në kohë, e përdorur gjerësisht në gjelbërimin urban në qytetet mesdhetare, ndërkohë që me rritjen e plotë krijon momente peizazhistike unike.



*fig 47 - Shembuj të aplikimit të pishes si gjelbërim urban – Romë, Itali*

- *Pemët me strukture vazore* mund të jenë më të përshtatshme për tu mbjellë në rrugët e qytetit pasi rriten lartë dhe hapen përsëgjëri. Këto forma pemësh kanë tendencën të harkohen mbi rrugë dhe trotuare duke i hijëzuar ato dhe njëkohësisht ruajtur pastërtinë vizuale dhe lartësinë e nevojshme pët të mos penguar rrugë kalimin e automjeteve.

3. Në hapësirat e gjera publike apo në hapësirat midis pallateve të qytetit të Tepelenës rekomandohet mbjellja e pemëve në mënyrë të grupuar sipas të njëjtës familje, ndërkohë që morfologjia hapësinore e tyre mund të varioje duke ndërthurur grupe drurësh me rradhe të dallueshme pemësh sipas një frekeunce të përcaktuar apo me drurë të vetmuar (solitaire). Këto hapësira mund të projektohen si zona të dedikuara për banorët e bllokut të banimit, me aktivitet të ulët dhe me gjelbërim kompleks, duke krijuar kështu edhe mini-ekosisteme të përshtatshme për zogjtë e këngës.

4. Plani i Përgjithshëm Vendor i jep një rëndësi të konsiderueshme zonave të konservimit mjedisor, në të cilat përfshihen ato hapësira të gjelbra karakteristike, me vlerë të lartë peizazhike, mjedisore e turistike të qytetit të Tepelenës apo të fshatrave rurale. Në përputhje me termin e ndërhyrjes, në këto zona nuk lejohet ndërtimi i objekteve apo strukturave që ndikojnë negativisht në identitetin specifik të zonave. Ndërkohë, Plani

propozon restaurimin e objekteve ekzistuese, duke respektuar karakteristikat dhe tiparet ekzistuese urbanistike dhe arkitektonike të objekteve, si dhe ndërthurjen me elementë estetikë të gjelbërimit të brendshëm.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë nuk përcakton kritere strikte lidhur me gjelbërimin e ulët, ndërkohë që thekson së të gjitha zgjidhjet urbanistike dhe mjedisore, si në qytetin e Tepelenës dhe në zonat rurale, duhet të bazohen në traditën e deritanishme të sektorit të gjelbërimit publik, duke stimuluar variacione të ngjyrave dhe llojeve të ndryshme të bimësisë.

### 3.3.1.2 ELEMENTE TË PEIZAZHIT TË ZONAVE EKONOMIKE DHE RURALE

Një nga elementët që neglizhohet më shumë gjatë projektimit dhe ndërtimit të zonave ekonomike është gjelbërimi plotësues, i cili shpesh konsiderohet si një kosto e panevojshme pasi nuk përputhet me funksionin primar të këtyrë zonave. Si rezultat këto hapësira kthehen shpesh në ishuj artificialë, të dallueshëm nga strukturat tipike urbane, ku mbizotëron betoni dhe asfalti, dhe duke mos ofruar terrene të përshtatshme të hijezuara për punonjësit apo klientelën.

Plani i Përgjithshëm i Bashkisë Tepelenë propozon një trajtim më "mjedisor" të zonave ekonomike, dhe sidomos zonës në veri të qytetit të Tepelenës e cila propozohet që të transformohet në hapësirën kryesore ekonomike dhe industriale për të gjithë territorin e Njësisë Vendore. Plani propozon përfshirjen në masë të konsiderueshme të elementëve të gjelbër në këto hapësira, nëpërmjet mbjelljes së drureve të familjeve të ndryshme, me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike. Një element interesant për përmirësimin e peizazhit të strukturave ekonomike janë perdet e gjelbra apo brezat e pemëve bllokuese, të cilat krijojne fasha tampon që fshehin apo zbutin ndikimin negativ vizual të strukturave dhe infrastrukturave ekonomike.

Për zonat ekonomike dhe industriale Plani propozon përdorimin e drurëve gjethegjërë dhe me push, si dhe të atij lloj vegjetacioni që bllokon efektet potenciale ndotëse, apo edhe asimilojnë një pjesë të konsiderueshme të ndotjes që mund të krijohet nga aktivitetet ekonomike. Këto zona duhet të jenë subjekt i vazhdueshëm i monitorimit nga ana e autoriteteve të Bashkisë Tepelenë, përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe gjelbërimin në këtë Njësi Vendore.

Për sa i përket elementëve peizazhistike në zonat rurale të Bashkisë Tepelenë, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon mbrojtjen e elementëve dallues të identitetit të gjelbër të këtyre zonave, si dhe ndërthurjen me tiparat dallues të peizazhit natyror rrethues. Gjatë projektimit apo ndërhyrjes në këto zona rekomandohet:

- Integrimi i elementëve karakteristikë peziazhistikë në projektet apo programet e posaçme për zhvillimin e bujqësisë apo strukturave blegtorale. Në këtë mënyrë, ndërhyrjet do të kenë mundësi të kombinohen në mënyrë graduale me elementë të peizazhit natyror ekzistues si dhe të krijojnë një rrjedhshmëri natyrale dhe të pafragmentuar midis elementëve vizuale të Sistemit Natyror me atë Bujqësor.

- Gjelbërimi i kontureve gjatësore të gjithë kanaleve vaditës/kullues në territorin e Bashkisë Tepelenë, duke krijuar në këtë mënyrë fasha të dallueshme të gjelbra përgjatë parcelave bujqësore, të përbëra kryesisht me shkurre apo rradhë të dallueshme pemësh.

- Shfrytëzimin e hapësirave ujore të rezervuarve, dhe konkretisht të lagështirës së nevojshme që ato garantojnë, për të gjelbëruar në mënyrë natyrale brigjet e tyre. Në këtë mënyrë do të mund të krijohen sipërfaqe të reja të pyllëzuara, në formën e parqeve të vogla natyrale me vlera peizazhistike, shumë të përshtatshme për faunën dhe mikrofaunën e këtyre hapësirave.

Në brendësi të zonave të banuara rurale Plani propozon ndërhyrje relativisht të kufizuara, të orientuara kryesisht në hapësirat e lira midis banesave si dhe përgjatë korridoreve rrugore apo rrugicave që do të jenë subjekt rikonstruksioni gjatë periudhës së zbatimit të Planit. Rekomandohet që llojet e drurëve të jenë kryesisht frutore, të përshtatshëm për vetë karakterin prodhues të hapësirave rurale, duke përmendur këtu arrat, shegët për fshatrat e pozicionuar në lartësi gjeografike si në Kurvelesh, Lopës, etj. Ndërkohë në zonat më të ulëta mund të aplikohen kultura të tjera si kumbullat, mollët, dardhët, etj.

Një tjetër ndërhyrje për këto zona që propozon Plani është ai i krijimit të brezave kufizues të gjelbër përreth njësive urbane periferike, të cilat transformohen gradualisht në parqe të vogla rurale, me vlera estetike peizazhistike, dhe me rëndësi në kontekstin e zhvillimit të sektorit të agroturizimit dhe turizmit të aventurës.

### 3.3.1.3 ELEMENTE të PEIZAZHIT NATYROR

Procesi i analizes dhe vlerësimit të propozimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë për komponentët territorial të Sistemit Natyror është referuar në përcaktimet e Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT" *i ndryshuar*. Metodologjia qëndrore në këtë analizë qëndron në balancimin e zhvillimit të ardhshëm urban, ekonomik dhe social me domosdoshmërinë për mbrojtjen e mjedisit natyror të Bashkisë Tepelenë. E gjithë filozofia bazohet gjithashtu në faktin së ndikimet në mjedis nuk janë të kufizuara në terma hapësinore. Në këtë logjikë, dëmtimet e shtresave vegjetative të hapësirave brenda territorit të një Bashkie të caktuar apo ndotja e shkaktuar nga aktivitetet njerëzore kanë ndikim edhe në

territoret fqinje të rajonit, ku në rastin konkret mund të përmendim territoret e Bashkive Memaliaj, Gjirokastër, Këlcyrë, Selenicë, etj.

Kjo dinamikë bëhet shumë relevante nëse marrim në konsideratë pozicionin si dhe marrëdhënien e ngushtë të territorit dhe hapësirave të banuara të Bashkisë Tepelenë, me korridorin ujor-natyror të Vjosës. Në këtë rast, ndikimet negative në Sistemin Natyror të Tepelenës, si erozioni, ndotja, etj kanë ndikim potencial në të gjitha territoret përgjatë lumit, si edhe në Adriatik. Propozimet e Planit të Përgjtihshëm Vendor për këtë Sistem, referuar kuadrit Ligjor në fuqi janë bazuar në:

- **Principin e ruajtjes dhe konservimit të burimeve natyrore** – ky princip i referohet përdorimit me efektvitet të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përftuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve. Duke iu referuar dinamikave të uleta të zhvillimit social ekonomik të Bashkis Tepelenë, përcaktimet strukturore të Planit të Përgjithshëm Vendor ndikojnë në konservimin dhe rritjen e burimeve natyrore, duke përmendur këtu propozimet për Njësitë Strukturore me funksione Parqe Urbane apo sipërfaqe pyjore me ndërhyrje të tipit Rehabilitim. Këto lloj ndërhyrjesh të propozuar ndikojnë në rritjen potenciale në perspektivë të hapësirës pyjore të Bashkisë Tepelenë, si një nga elementët më të spikatur të Sistemit Natyror në këtë Njësi Vendore si dhe një nga mundësitë më të mira ekonomike në perspektivë, e konsideruar në aspektin e ekonomive pyjore apo zhvillimit të turizmit natyror dhe të aventurës.
- **Principin e ndërhyrjes së integruar** – ky është një komponent esencial lidhur me trajtimin e gjithë Sistemit Natyror në Bashkinë Tepelenë, sipas të cilit promovohen ndërthurja e proceseve të parandalimit dhe/ose reduktimit të rreziqeve potenciale ndaj mjedisit me proceset e zhvillimit dhe promovimit të vlerave të peizazhit natyror. Falë karakteristikave ekzistuese natyrore, Bashkia Tepelenë disponon mundësi mjaft të mëdha për vënien në zbatim të këtij principi, ku propozimet për rehabilim mjedisor dhe konservim ndërthuren me projektet strategjike për zhvillim të turizmit natyror, agroturizmit, apo dhe ato të aventurës. E gjithë kjo nën moton "mbro, promovo dhe zhvillo" të elementëve të Sistemit Natyror të kësaj Njësie Vendore.

Në përputhje me përcaktimet e Nenit 19 të Ligjit Nr.10 431, datë 9.6.2011 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT" i ndryshuar, propozimet për Njësitë strukturore të territoreve brenda Sistemit Natyror të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë synojnë në:

- Mbrojtjen dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve natyrore, duke respektuar kufijtë e parcelave ekzistuese pyjore si dhe shtimin e tyre nëpërmjet procesve të Rehabilitimit të terreneve me shkurre, zonave të përdorura si dhe hapësirave të degraduara;
- Mbrojtjen dhe promovimin e elementëve karakteristike të biodiversitetit vegjetativ, si dhe të ekosistemeve apo mini-ekositemeve të peizazhit natyror;

- Mbrojtjen dhe zhvillimin e florës dhe faunës, si nje rezultat potencial i rritjes së sipërfaqeve pyjore dhe ato me shkurre të rehabilitura

Për shkak të pozicionit gjeografik dhe karakteristikave natyrore të relievit, Bashkia Tepelenë prezanton një potencial mjaft të mirë për sa i përket elementëve të peizazhit dhe mundësisë reale për përmirësimin e tyre në perspektivë. Në këtë kontekst, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon marrjen e masave mbrojtëse lidhur me përmirësimin e peizazhit natyror të kësaj Njësie Vendore, të cilat do të fokusohen në:

- Ripyllëzimin e territoreve të shpyllëzuara pranë fshatrave periferike si dhe të hapësirave të degraduara nga erizioni apo nga aktiviteti njerëzor. Këto ndërhyrje do të sillnin një ndikim pozitiv jo vetëm në shtimin e sipërfaqeve të pyjeve të Bashkisë Tepelenë, por edhe në përmirësimin e imazhit të saj si një destinacion mjaft potencial për turizmin natyror dhe të aventurës. Plani përcakton zonat e ndërhyrjeve mjedisore, të klasifikuara si Njësi Strukturore në Sistemin Natyror, si dhe përcakton mënyrat e ndërhyrjeve në tabelat përkatëse të Rregullores së Planit. Gjatë projekteve të ripyllëzimit duhet treguar kujdes në përzgjedhjen e kulturave të aplikuara, duke respektuar llojet e drureve tradicionale. Një rëndësi të madhe në këtë proces ka përcaktimi i kontureve të qartë dallues midis territoreve të Sistemit Natyror (pyjet) me ato të Sistemit Bujqësor, duke konsoliduar në këtë mënyrë kufijë definitive midis pyjeve, kullotave dhe terreneve bujqësore.

- Mbjelljen e drurëve të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të shërbejnë si mbrojtëse të tokës nga erozioni dhe që nuk përbëjnë rrezik për të prishur balancat me bimët e tjera.

- Ruajtjen, krijimin dhe mirëmbajtjen e brezave repariane të lumenjve Drinos, Vjosë dhe Bënçë, të cilet përbëjnë tre nga elementët më të rëndësishëm dhe karakteristike territor-formues të Bashkisë Tepelenë. Për vetë shtrirjen që ato kanë këto zona do të kenë një rol të konsiderueshëm në Sistemin Natyror të kësaj Njësie Vendore, duke mundësuar mbrojtjen e tokave nga erozioni lumor, krijimin e zonave ndërmjetëse mbrojtëse midis aktiviteteve të Sistemit Bujqësor dhe atij Ujor si dhe zhvillimin e habitateve për florën dhe faunën lokale, të cilat kanë një varësi të theksuar për mbijetesë nga korridoret ujore.

### 3.3.1.4 MBROJTJA E ELEMENTËVE UJORE DHE PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË UJIT

Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore është detyrim ligjor për Bashkinë Tepelenë, në baze të Ligjit Nr. 139/2015 "**Për Vetëqeverisjen Vendore**" i ndryshuar, sipas të cilit Bashkia ka përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen dhe promovimin e një mjedisi cilësor për qytetarët në territorin e saj. Ndërkohë, kuadri rregullator përkatës për Sistemin Ujor bazohet në

përcaktimet e Ligjit nr. 111/2012 "**Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore**" i ndryshuar, Ligjit Nr. 81/2017 "**Për Zonat e Mbrojtura**"i ndryshuar, apo edhe instrumentë të tjerë ligjore që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo përbërësve specifikë të tij. Ligji Nr. 111/2012 "**Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore**" ka për qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, si dhe mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja apo shpërdorimi. Ai bazohet në principet e:

- përdorimit racional të burimeve ujore për nevojat e territoreve urbane, sistemeve ekonomike industriale si dhe proceseve bujqësore dhe blegtorale;
- kontrollit të vazhdueshëm dhe periodik të burimeve ujore si dhe zhvillimit të baseneve përmes proceseve të planifikimit të territorit apo hartimit të projekteve specifike,
- mbrojtjen e cilësisë së burimeve ujore, nëpërmjet reduktimit apo eliminimit të plotë të ndotjes që në burim të ujërave sipërfaqesore si dhe atyre nëntokësore;
- mbrojtjen e integritetit të baseneve ujore nëpërmjet kufizimit të ndërhyrjeve të jashtme të cilat pengojnë funksionimin e ciklit të plotë të këtyre baseneve, si dhe garantimin e furnizimit të mjaftueshëm të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- zbatimin e principit "ndotësi paguan" për krijimin e mundësive financiare për rikuperimin e kostove të shërbimeve ndaj mjediseve ujore;

Ndërkohë, Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 "**Për Zonat e Mbrojtura**", përcakton kuadrin e masave të nevojshme për mbrojtjen e ekosistemeve karakteristike ujore, duke përfshirë këtu:

- përcaktimin dhe sanksionimin e zonave higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm për popullaten vendase;
- identifikimin dhe planifikimin e habitateve ujore si dhe zonave të dedikuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve të këtij Sistemi
- përcaktimin e zonave të dedikuara për peshkim natyror, rritjen dhe mbareshtimin artificial të peshkut si dhe rritjen e butakëve;
- përcaktimin e zonave të dedikuara për rekreacion apo për funksione kurative;
- përcaktimin e zonave të prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratet e nitritet;

Për sa i përket zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare ato përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe trajtojnë masat e nevojshme për tu ndërmarrë nga Bashkia Tepelenë përreth burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore që furnizojnë popullsinë urbane e rurale me ujë të kësaj Njësie Vendore. Nga pikëpamja teknike, këto zona ndahen në:

a) **zona e parë e mbrojtjes** përreth burimit të ujit, e cila duhet të jetë tërësisht e survejuar dhe e rrethuar për efekt sigurie;
b) **zona e mbrojtjes së afërt**, brenda së cilës ndalohen të gjitha ndërtimet dhe aktivitetet urbane, ekonomike dhe industriale, aktivitetet bujqësore e blegtorale si hapja e

puseve, hapja e kanaleve ujites apo vaditës, përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, shkarkimi i ujërave të ndotura, i substancave kimike e toksike, përdorimi si varrezë apo groposja e kafshëve të ngordhura;

c) **zona e mbrojtjes së largët**, ku veprimtaritë e parashikuara në pikën "b" janë objekt i autorizimeve të posaçme administrative.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë merr në konsideratë trajtimin e zonave të lira përgjatë brigjeve të trupave ujore, referuar Ligjit Nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" i ndryshuar. Sipas këtij ligji, Plani propozon që në të gjitha ato territore përgjatë brigjeve të trupave ujore, duhet të:

a) përcaktohen dhe sanksionohen breza të lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga kufijte e sipërfaqeve ujore. Në rastin e Bashkisë Tepelenë, gjerësia e këtyre mund të shtrihet më tej, sipas konfiguracionit të territorit, duke shkuar deri në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit. Për mbrojtjen e cilësisë së ujrave dhe zonave akuifere në territorin e Bashkisë Tepelenë, Plani i Përgjitshëm Vendor propozon:
    a. krijimin dhe mbrojtjen e zonave higjeno-sanitare përreth të gjitha pus-shpimeve të furnizimit me ujë të popullsisë së Bashkisë, referuar përcaktimeve të Ligjit 111/2012 "**Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore**" i ndryshuar dhe VKM nr.145, datë 26.2.1998 "Për **Miratimin e Rregullores Higjeniko-Shëndetësore për Kontrollin e Cilësisë së Ujit të Pijshëm, Projektimin, Ndërtimin dhe Mbikqyrjen e Sistemeve të Furnizimit me Ujë të Pijshëm**".
    b. Krijimin e një database operative ku identifikohen pus-shpimet legale dhe ilegale në territorin e Bashkisë Tepelenë, me qëllim monitorimin e cilësisë apo nivelit të ndotjes së shkaktuar të këtyre ujrave. Gjithashtu, ky sistem monitorimi do të orientojë masat e nevojshme për shmangien e konflikteve potenciale të aktiviteteve të tjera që përdorin ujin dhe që shkaktojnë ndotje potenciale. Pus-shpimet në këtë database do të klasifikohen sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore.
    c. Zonimin e territorit sipas klasifikimit të ndjeshmërisë ndaj ndotjes sipërfaqësore të zonave akuifere. Ky zonim do të mundësojë identifikimin e saktë të zonave ku lejohen apo nuk lejohen shpimet. Në rast të kundërt, rekomandohet krijimi i një liste në të cilën pus-shpimet renditen sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore me qëllim ushrimin e kontrollit të tyre të herë pas hershëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planning - Architectural Restoration

b) përcaktohen breza të lirë përdorimi, për zhvillimin e aktiviteteve që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m. Eliminohen të gjitha shkarkimet e ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara. Plani propozon ngritjen e sistemeve të purifikimit të ujërave të ndotura urbane për qytetin e Tepelenës, si dhe për territoret e banuara rurale të pozicionuara pranë trupave ujorë. Sipas kuadrit ligjor ekzistues shkarkimet e ujrave urbane në Bashkinë Tepelenë duhet t'i nënshtrohen detyrimisht trajtimit mjedisor paraprak, nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme. Këto shkarkime duhet ti nënshtrohen një trajtimi të rrepte fizik dhe kimik, ku veç trajtimit parësor e dytësor, në raste të veçanta, duhet bërë dhe trajtimi purifikues përkatës. Në zonat më pak të ndjeshme mjedisore, trajtimi i ujrave u nënshtrohen procedurave të trajtimit parësor, me kusht që të mos ketë rritje të ndikimeve negative në mjedisin pritës. Shkarkimet e lëngëta urbane në zonat malore, për arsye të temperaturave të ulëta, ku është i vështirë të zbatohet impianti i trajtimit biologjik, i nënshtrohen trajtimit fiziko-kimik, me kusht që të mos rriten ndikimet negative në mjedis

c) kontrollohet si dhe të minimizohet nxjerrja e materialeve inerte, rërë, zhavorr nga shtretërit lumorë. Në të gjitha rastet që paraqiten me leje, Bashkia Tepelenë duhet të ushtrojë autoritetin e saj për monitorimin me skrupolozitet të plotësimit të kushteve mjedisore të aplikuara sipas rastit.

d) Minimizohet dhe të eliminohet plotësisht hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gërmimeve të ndryshme, si dhe veprimtarive të tjera që gjenerojnë mbetje;

e) Ndalohen dëmtimet e vegjetacionit reparian përgjatë brigjeve të lumenjeve

Sipas Ligjit nr. 111/2012 "**Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore**" i ndryshuar, për të gjitha veprimtaritë që gjenerojnë ujëra të ndotura është e detyrueshme të lidhen dhe të përdoren kanalizimet e ujërave të ndotura, në përputhje me legjislacionin që rregullon shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe me aktet nënligjore që zbatohen në këtë fushë. Kur disa persona përdorin një sistem të përbashkët për kanalizimet, përgjegjës para organeve të administrimit të burimeve ujore është enti që i shërben sistemit kolektiv të kanalizimeve. Në rastin e një sistemi individual kanalizimesh, shkarkuesi është përgjegjës para organeve të administrimit të burimeve ujore, qoftë ky familjar ose jofamiljar.

Duke iu referuar VKM Nr. 177 datë 31/03/2005 "Per **Normat e Lejuara Lidhur me Çështjet e Shkarkimit të Ujrave dhe Kriteret Zonale të Organeve Marrëse**", Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë përcakton që:

- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit dhe të fshatrave duhet të mundësojë procese të trajtimit mjedisor paraprak, duke sanksionuar kështu nevojën për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të ndara të kanalizimeve për ujërat e zeza urbane si dhe ujërat e bardha të shirave;

- shkarkimet e ujërave të zeza urbane të qytetit të Tepelenës duhet ti nënshtrohen një trajtimi të veçantë, i cili përveç trajtimit parësor e dytesor, kërkon edhe trajtimin purifikues përkatës. Ky kriter ka një rëndësi të madhe në raport me pozicionin delikat që ka Bashkia, përgjatë korridorit të lumit Vjosë, si një nga lumenjtë më karakteristikë të rajonit të Ballkanit. Ndërkaq, në zonat periferike rurale më pak të ndjeshme këto shkarkime do t'i nënshtrohen vetëm trajtimit parësor.
- shkarkimet e ujërave në zonat mbi 1 500 m mbi nivelin e detit, i nënshtrohen një trajtimi më pak rigoroz por pa shkaktuar rritje të ndikimeve negative në mjedisin pritës.

Për sa i përket klasifikimit të ndjeshmërisë mjedisore të zonave, Plani i është referuar kritereve ligjore përkatëse. Sipas këtyre kritereve, në territorin e Bashkisë Tepelenë, klasifikimi i zonave ujore ndjek përcaktimet si më poshtë:

**Zonat e ndjeshme ujore**

Këtu klasifikohen të gjithë trupat e mëdhenj ujorë që përshkojnë territorin e Bashkisë Tepelenë, si lumenjtë Vjosë, Drinos, Bënçë si dhe linjat ujore tributare. Gjithashtu, në këtë klasifikim përfshihen sipërfaqet e rezervuareve të ujitjes, të cilët përveç rolit të tyre ekonomik në Sistemin Bujqësor, kanë një rol të konsiderueshëm në sistemin natyror dhe konkretisht në ekosistemet e faunës vendase. Këta rezervuare mund të kthehen në eutrofike, nëse nuk merren masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre nga prurjet e ngurta si dhe për garantimin e furnizimit të vazhdueshëm me ujë të freskët.

**Zonat më pak të ndjeshme ujore**

Në këto zona klasifikohen ato hapësira ujore në të cilat shkarkimet e ujërave të ndotura nuk ndikojnë në mjedisin përkatës në kuptim të kushteve specifike morfologjike, hidrologjike ose hidraulike.

Duke iu referuar këtij kuadri rregullator si më sipër, për sa i përket burimeve ujore për përdorim bujqësor Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon masat si vijon:

- hartimin e një një plani të detajuar për menaxhimin e ujit dhe infrastrukturës përkatëse për ujitje në të gjithë territorin e Bashkisë;
- rikonstruksionin e plotë të rrjetit ekzistues të depozitimit të ujit dhe ujitjes, duke garantuar mbulimin me shërbim të të gjitha territoreve bujqësore të kësaj Njësie vendore si dhe eliminimin e humbjeve aktuale të rrjetit shpërndarës të ujit për ujitje. Një rëndësi të konsiderueshme në këtë propozim ka ripërtëritja e kapaciteteve depozituese të rezervuareve të Nivicës, Gusmarit dhe Dukaj, duke mundësuar pastrimin e tyre nga depozitimet inerte afatgjata;
- Eliminimin e ndërhyrjeve të parregullta në rrjet nga ana e fermerëve nga zonat periferike rurale.

Dhënia në përdorim e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit bëhet nëpërmjet kontratave specifike ndërmjet Bashkisë Tepelenë si dhe subjektit që i transferohet infrastruktura, për jo më pak së 10 vjet. Sipas ligjit, institucioni përgjegjës administrative për kullimin në Bashkinë Tepelenë duhet të marrë masat e nevojshme për të ruajtur dhe mirëmbajtur infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara në to, përfshirë edhe sipërfaqet e tokës bashkëngjitur.

### 3.3.1.5 PERMIRESIMI I CILESISE SË AJRIT

Mbrojtja e cilësisë së ajrit është detyrim ligjor për Bashkinë Tepelenë, si detyrim i Ligjit Nr. 139/2015 "**Për Vetëqeverisjen Vendore**" i ndryshuar, i cili ngarkon institucionin vendor me përgjegjësinë për të ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj, në të gjitha parametrat perkatës. Ndërkaq, Ligji Nr. 162/2014 "**Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis**" ngarkon Bashkinë Tepelenë me përgjegjësinë e përmirësimit të cilësisë së ajrit, si një element thelbësor në rritjen e cilësisë së jetesës së banorëve të kësaj Njësie Vendore. Sipas këtij ligji, Bashkia Tepelenë duhet të:

- Hartojë Planin Afatshkurtër të Veprimit për monitorimin e niveleve të PM10[6], dhe të NO2[7] në territorin administrativ. Gjithsesi, në rastin e Bashkisë Tepelenë, duke marrë në konsideratë nivelin e ulët të popullsisë, trafikut apo aktiviteteve social ekonomike, ky Plan i propozuar mund të kufizohet vetëm në territorin e qytetit të Tepelenës.
- Krijojë një stacion të përhershme të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në qytetin e Tepelenës
- Ndërmarrë nisma periodike për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore (të llojit A, B dhe C) në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë;
- Garantojë që gjatë aktiviteteve ndërtimeve të çdo lloj kategorie apo niveli investimi në territorin e Bashkisë, të merren masa mbrojtëse për ajrin;
- Menaxhojë në mënyrë të qëndrueshme mbetjet urbane të gjeneruara, duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre, deri në momentin e zhvendosjes së tyre drejt landfilleve rajonale të depozitimit.

Përveç sa më sipër, për përmirësimin e cilësisë së ajrit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon konkretisht:

- -krijimin e Parkut Malor të qytetit të Tepelenës, në të cilin përfshihen territoret përgjatë kurrizit malor fill në pjesën e sipërme të qytetit dhe vazhdon në drejtim të jugut, e kufizuar nga të dy anët midis rrugës nacionale inter-ubane Levan – Tepelenë – Gjirokastër si dhe rrugës Tepelenë – Bënçë. Projekti synon shtimin dhe dendësimin

[6] PM10 është termi që percakton nivelin e grimcave në ajer, me diameter deri në 10 mikron.
[7] NO2 – është formula e Dioksidit te Azotit, nje nga ndotesit me te rrezikshem në atmosfere.

e hapësirës pyjore ekzistuese në këtë territor me bimësi të të njëjtit lloj, në mënyrë të tillë konsolidimin e bimësisë vendase.

- -krijimin e Parkut Lumor të qytetit të Tepelenës nëpërmjet krijimit të hapësirave të gjelbra rekreative, të kombinuara me panoramën e korridorit lumor të Vjosës. Propozohet të krijohet përgjatë pjesës lindore të qytetit të Tepelenës, duke nisur nga zona e plepave në jug dhe duke vazhduar si brez përgjate lumit të Vjosës, deri pranë grykëderdhjes së lumit të Bënçës.
- -krijimin e parkut "Kurora e Kurveleshit" – të radhitur pas njëri tjetrit në pllajen përgjatë rrugës komunikuese, fshatrat e kësaj krahine kufizohen në pjesën jugore të tyre me kurrize kodrinore, të cilat propozohet të konvertohen në mënyrë graduale në terrene të pyllëzuara. Një ndërhyrje e tillë do të përmirësojë potencialisht treguesit natyrorë dhe jetësorë të krahinës.

Përveç efekteve në cilësinë e ajrit, këto projektet të propozuara për ripyllëzim do të kenë një efekt pozitiv sinergjik në rigjenerimin e habitateve dhe biodiversitetit. Gjithashtu vlerësohet një efekt pozitiv i lidhur me zhvillimin e formave të veçanta të interesit të turizmit (ekoturizmit, turizmit rekreativ, agro – turizmit, turizmit malor).

### 3.3.1.6 ZGJIDHJA E PROBLEMATIKËS MJEDISORE DHE VATRAVE TË EVIDENTUARA

Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë i kushton një vëmendje të veçantë trajtimit të mbetjeve urbane në qytet si dhe në zonat rurale periferike. Plani thekson domosdoshmërinë e përmirësimit të sistemit ekzistues të grumbullimit dhe depozitimit, duke rivlerësuar skemën aktuale të shërbimit në funksion të lidhjes së saj në nivel rajonal. Në momentin aktual, Bashkia Tepelenë duhet të përmirësojë urgjentisht kushtet mjedisore të vend-depozitimit aktual duke mos lejuar ndotjen e territoreve përreth si deri në gjetjen e një alternative të qëndrueshme për trajtimin final të tyre. Metodologjia e analizës së problematikës së mbeturinave në Bashkinë Tepelenë synon në:

- **Parandalimin e krijimit të mbetjeve**: Bashkia Tepelenë duhet të synojë pakësimin e sasisë totale të mbetjeve që në origjinë duke reduktuar në këtë mënyrë efektin ndotës si dhe duke ulur kostot e shërbimit në nivel Bashkiak;
- **Zhvillimi dhe promovimi i proceseve të riciklimit të mbetjeve;** në këtë kontekst, një process riciklimi i mirëorganizuar dhe i promovuar nga ana e Bashkisë Tepelenë, do të stimuloje interesin e industrisë së riciklimit për grumbullimin dhe largimin e tyre nga zona por edhe do të gjenerojë vende pune dhe të ardhura;
- **Përmirësimi i hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi**. Është jashtëzakonisht thelbësore që të promovohet një nivel më i lartë ndërgjegjësimi nga ana e banorëve lidhur me mënyrën e hedhjes dhe depozitimit të mbetjeve. Në të gjithë botën tashmë aplikohen mënyra të diferencuara të hedhjes së mbeturinave në burim, të cilat ndikojnë esencialisht në një shërbim efektiv dhe me kosto të ulët. Kjo lloj skeme duhet të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË
ARCHISPACE STUDIO Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration studio@archi-space.com

aplikohet në mënyrë të gjerë në të gjithë territorin e qytetit të Tepelenës, ndërkohë që në zonat periferike rurale është e rëndësishme që të luftohen mënyrat e hedhjes informale të mbetjeve në vende jo të përshtatshme. Një Bashki më e pastër do të jetë një objektiv më i përshtatshëm dhe më atraktiv për të gjitha llojet e zhvillimeve ekonomike, investimeve apo turizmit në të ardhmen.

Ndërkohë, për sa i përket skemës së shërbimit, vend-depozitimi aktual në Bashkinë Tepelenë është mjaft problematik për shkak të pozicionit të tij pranë lumit të Vjosës, si dhe mungesës së parametrave teknike për mbrojtjen e zonave përreth tij nga ndotja. Mungesa e këtyre parametrave bën që shumë mbeturina plastike, kryesisht qese, të përfundojnë në zonat përreth si dhe në lumin Vjosë. Po ashtu problematike mbetet mungesa e masave teknike ndaj ndotjes së ujërave nga filtrimet që shkaktohen gjatë periudhës së shirave.

Për këtë arsye plani propozon eliminimin e plotë të këtij dumpsit'i si dhe ndërtimi i një pike të re depozitimi për të gjithë Bashkinë Tepelenë, në distance nga trupat ujore si dhe e mbrojtur nga korrentet ajrore të forta, karakteristike për grykën e Vjosës.

Ndërkaq Plani propozon ndërtimin e një serie pikash tranzit të depozitimit të mbetjeve, në të cilat do të grumbullohen mbetjet e gjeneruara nga grupet e fshatrave, në varësi të afersise midis tyre dhe skemes së grumbullimit. Më pas, mbeturinat nga këto pika do të transportohen drejt pikës qëndrore të re të depozitimit, dhe më pas në drejtim të landfillit rajonal të Bajkaj.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon ndërtimin e pikës së re qëndrore të depozitimit të mbetjeve pranë grykëderdhjes së përroit të Turanit në lumin e Bënçës. Propozimi synon në krijimin e një pike depozitimi të mbuluar me strukturë të lehtë, duke penguar depërtimin e ujërave të shiut si dhe me hapësirat dhe infrastrukturën e posaçme për ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve.

Plani propozon eliminimin e pikës aktuale të depozitimit të mbetjeve të Bashkisë Tepelenë, pranë lumit Vjosë, si dhe pastrimin dhe rehabilitimin e plotë të terrenit të dumpsite'it ekzistues si dhe zonave të ndotura perreth. Ndërhyrja e propozuar duhet të ketë në konsideratë rivitalizimin mjedisor të të gjithë hapësirës, duke e transfomuar atë nga një zonë mbeturinash, në një hapësirë të pyllëzuar në krah të lumit Vjosë.

Për sa i përket zonave periferike rurale Plani propozon ndërtimin e pesë pikave tranzit të depozitimit të mbetjeve dhe konkretisht:

1. Ne Pllajën e Kurveleshit – zonen midis fshatrave Progonat dhe Gusmar;
2. Përgjatë korridorit midis fshatrave Dragot dhe Luadh – propozohet pranë rrugës kryesore, pranë fshatit Luadh.
3. Pranë urës së Leklit – në këtë pikë do të depozitohen mbeturinat e fshatrave Koder, Lekël, Hormovë dhe Luzat.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration ARCHISPACE STUDIO studio@archi-space.com NIPT: L42030012Q
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

4. Përgjatë korridorit midis Dukaj dhe Salarise – propozohet pranë rrugës së vjetër Tepelenë – Lopës.
5. Ne grykën e Lopësit – propozohet midis fshatrave Dhëmblan dhe Matohasanaj dhe do të shërbejë për depozitimin e mbetjeve të fshatrave Dhëmblan, Matohasanaj, Lap-Martalloz dhe Sinanaj.

## 4.4 PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

### 4.4.1 PLANI I VEPRIMEVE

#### 4.4.1.1 ZHVILLIMI I NJËSIVE STRUKTURORE

Gjatë përpunimit të hartës së njësive strukturore të Bashkisë Tepelenë, një fokus të veçantë ka marrë përcaktimi i atyre njësive, në të cilat parashikohet ndryshimi i treguesve territoriale apo i funksionit ekzistues të përdorimit të tokës. Të gjitha këto njësi do ti nënshtrohen procesit të hartimit të PDV've, duke ndjekur të gjitha përcaktimet rregullatore të Ligjit Nr. 107/2014 "**Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit**" dhe VKM Nr.686, datë 22.11.2017 "**Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit**" të ndryshuar.

Në terma të fazimit të periudhës së përgatitjes së këtyre PDV've, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon strukturimin e procesit në tre faza specifike:

- **FAZA i** – Hartimi dhe miratimi i PDV've për qytetin Tepelenë, (njësitë strukturore brenda qytetit si dhe njësitë strukturore të pozicionuara në zonën fushore në pjesën veriore të qytetit), njësitë strukturore të fshatit Veliqot, të gjitha njësitë strukturore të pozicionuara përgjatë rrugës kryesore interurbane Levan – Tepelenë – Gjirokastër, si dhe të gjitha njësitë strukturore urbane të fshatrave të Njësisë Administrative të Kurveleshit (Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin). Ky propozim bazohet në faktin së territoret e këtyre njësive strukturore paraqesin zonat më prioritare të zhvillimit ekonomik të Bashkisë, kështu që përgatitja dhe miratimi i dokumenteve të detajuar zhvillimore të tyre krijon hapësirën e nevojshme teknike dhe administrative për miratimin e lejeve përfundimtare të zhvillimit dhe të ndërtimit. Në terma kohore, **FAZA i** do të përfshijë tre vitet e para të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, dhe konkretisht periudhën 2020-2023
- **FAZA II** – hartimi dhe miratimi i PDV've për njësitë strukturore të fshatrave të ndodhura pergjate akseve rrugore kryesore (ku mund të përmenden fshatrat si Dragot, Beçisht, Mamaj, Turan, Dukaj, Lekël, Hormovë). Këto janë zonat e klasifikuara si kategori e dytë e potencialit të zhvillimit në Bashkinë Tepelenë, për shkak të dendësisë së banorëve si dhe distancës nga qendra e Bashkisë dhe nga rruga kryesore interurbane. në terma kohore, **FAZA II** do të shtrihet përgjatë periudhës 2023 – 2028, në një segment kohor 5 vjeçar.

- **FAZA III** – Hartimi dhe miratimi i PDV've për njësitë strukturore të zonave urbane periferike (duke përmendur fshatrat e Njësisë Administrative Lopës, fshatrat Mezhgoran, Peshtan). Në terma kohorë, kjo **FAZE III** do të shtrihet nga viti 2028 deri në përfundim të afatit të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.




*fig 48 – harta e fazimit te PDV've, per zbatimin e Planit te Përgjithshëm Vendor*

Gjithsesi, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi, hartimi i PDV've specifike mundet të zbatohet edhe jashtë përcaktimeve kohore të Fazave të përmendura më lart, kjo në rastet e ndërmarrjes së nismave nga ana e subjekteve private, pronare apo investitore të interesuar

për zhvillimin e parcelave që përfshihen brenda territorit të një Njësie Strukturore specifike, në çfarëdo pozicioni gjeografik brenda territorit të Bashkisë Tepelenë.

Në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi për planifikimin dhe menaxhimin e territorit, hartimi dhe miratimi i PDV've për Njësitë Strukturore të Bashkisë Tepelenë do të ndjekë procedurat si më poshtë, duke respektuar përcaktimet e fazave të zhvillimit:

1. Hartimi dhe miratimi i Nismes për hartimin e PDV-së – zyrtarisht ky dokument miratohet nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, ndërkohë që iniciativa për hartimin e Nismes motivohet nga interesi publik për ndertimin e infrastrukturave dhe shërbimeve në nje territor të caktuar të Bashkisë, apo me kërkesë të çdo pale private të interesuar për zhvillim.
2. Hartimi i dokumentit të PDV-së kryhet nga vetë autoriteti vendor për planifikimin dhe/ose nga pala e interesuar, në varesi të kriterit të raportit të pronesise mbi sipërfaqen totale të Njësise Strukturore. Në rast hartimi nga palët e interesuara, procesi mbikëqyret në çdo hap nga struktura përgjegjëse e planifikimit të territorit të Bashkisë Tepelenë.
3. Ne të dy rastet e hartimit të dokumentit të PDV, miratimi bëhet nga kryetari i Bashkisë Tepelenë.

Si rregull, procesi i hartimit PDV'se për çdo Njësi Strukturore nis me botimin e Nismës përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, të miratuar zyrtarisht dhe të sigluar nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë. Nga pikëpamja teknike, nisma do të përmbajë:

a) Kodin e Njësisë, të paracaktuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor, shoqëruar me përcaktimet dhe treguesit e zhvillimit të Njësisë Strukturore, të përcaktuar në Rregulloren e Planit.
b) Deklaratën e dakordësisë së pronarëve që kanë në pronësi jo më pak së 51% të sipërfaqes së njësisë, në rastin e hartimit të PDV-së me nismë private.
c) Buxhetin për hartimin e PDV-së;
d) Planin e veprimit për hartimin e PDV-së.

Hartimi i Planit të Detajuar Vendor, sipas kriterit të raportit të pronësive mbi parcelën, do të kryhet:

1. Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit të Territorit, në rast së Nisma për hartimin e PDV'së merret nga Bashkia Tepelenë.
2. Subjekt i interesuar privat, në rast së ai disponon marrëveshje kontraktuale të pronarit apo grupit të pronarëve që disponojne jo me pak së 51% të pronesisë së sipërfaqes së Njësisë Strukturore.

#### 4.4.1.2 ZHVILLIMI i PROJEKTEVE STRATEGJIKE TË INFRASTRUKTURES DHE SHËRBIMEVE

Në dokumentin e Strategjisë Territoriale të Bashkisë Tepelenë janë listuar 70 projekte specifike për zbatim nga ana e administratës së kësaj Njësie Vendore. Këto projekte janë analizuar dhe propozuar në funksion të rëndësisë strategjike që ata kanë për zhvillimin dhe

konsolidimin e pesë sistemeve territoriale të Bashkisë, duke u fokusuar në:

- Rikonstruksionin dhe modernizimin e infrastrukturave publike
- Mbrojtjen dhe rivitalizimin e parametrave mjedisore të territoreve urbane, natyrore dhe ujore;
- Mbulimin me shërbimet publike bazë të të gjithë territorit të Bashkisë Tepelenë;
- Promovimin dhe zhvillimin e investimeve strategjike; Përmirësimin e aksesit dhe ndërlidhjes së të gjithë zonave urbane të Bashkisë me njëra tjetrën;

Të gjitha këto projekte janë përcaktuar për tu zbatuar sipas fazave përkatëse, përgjatë të gjithë periudhës së zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA

ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration - studio@archi-space.com

LISTA E PROJEKTEVE STRATEGJIKE TE PLANIT TE PËRGJITHSHËM VENDOR TE BASHKISE TEPELENË

| Projektet | | Prioriteti | | | | | Fazat e Zbatimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emertimi i Projektit | I lartë | I mesem | I ulët | Kosto e përafërt(leke) | Kohëzgjatja e projektit | Afat-shkurtër (1vit) | Afat-mesëm (1-3 vjet) | Afat-gjatë (4-10) | Afat-gjatë (+10 vjet) |
| 1 | Sistemimi i dy anëve të brigjeve veriore të lumit Bënçë | ■ | | | 10,000,000 | 3 vjet | | ■ | | |
| 2 | Hartimi i Projekteve të Detajuara Vendore për zonën veriore të Tepelenës | | ■ | | 3,000,000 | 1 vit | ■ | | | |
| 3 | Ndertimi dhe konsolidimi i rrjeteve të infrastruktures fizike (rruge, ujesjelles-kanalizime si dhe furnizim me energji) në zonën veriore të qytetit të Tepelenës | | ■ | | 150,000,000 | 2 vjet | | ■ | | |
| 4 | Rikualifikimi dhe rikonstruksioni i strukturave ndërtimore në fshatrat e Kurveleshit | ■ | | | 20,000,000 | 3 vjet | | ■ | | |
| 5 | Krijimi i Parkut Malor të qytetit të Tepelenës | ■ | | | 20,000,000 | 4 vjet | | | ■ | |
| 6 | Krijimi i Parkut Lumor të qytetit të Tepelenës | ■ | | | 5,000,000 | 1 vit | ■ | | | |
| 7 | Krijimi i parkut "Kurora e Kurveleshit" | | ■ | | 20,000,000 | 4 vjet | | | ■ | |
| 8 | Projektimi, ndërtimi dhe venia në shfrytëzim i strukturave të magazinimit dhe përpunimit të produkteve blegtorale | ■ | | | 100,000,000 | 2 vjet | | ■ | | |
| 9 | Projektimi dhe ndërtimi i zones së magazinimit dhe perpunimit të bimëve medicinale | ■ | | | 5,000,000 | 2 vjet | | ■ | | |
| 10 | Ndërtimi i thertores së re të Tepelenës | | ■ | | 100,000,000 | 2 vjet | | ■ | | |
| 11 | Ndertimin e impiantit eolik pranë territorit të fshatit Mamaj (Majkosh) | ■ | | | 200,000,000 | 2 vjet | | ■ | | |
- Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.
- Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Procesi i dhënies me qera të tokës bujqësore do të kryhet përmes procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij, në mbështetje të Udhezimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për Procedurat e Dhënies me Qera të Tokave Bujqësore të Pandara" si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit tokë bujqësore.

Vlerësimi dhe përcaktimi i projekteve kapitale në zbatim të Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Tepelenë është bërë në përputhje me objektivat strategjik të dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit të Territorit. Referuar pamundësisë aktuale të financimit të të gjithë projekteve të identifikuara në tabelën përmbledhëse të mesipërme, është e nevojshme identifikimi i nje metodologjie të posaçme nga ana e Bashkisë Tepelenë, lidhur me mënyrat e financimit dhe zbatimit të projekteve në terma afatgjate. Konkretisht, duke iu referuar procesit të hartimit të Projekt-Buxhetit Afatmesem, zbatimi i projekteve në vazhdim do të duhet të marre në konsiderate:

- koston e investimit;
- jetëgjatësinë dhe kohën e përdorshme të investimit;
- koston e mirëmbajtjes së projektit potencial;

Mbi bazën e këtyre tre kritereve të mesipërme zbatimi i investimeve kapitale duhet të perputhet sipas nje time-line strategjik, ku të ndiqen:

- kontributi i projektit të dhënë në arritjen e objektivave strategjike:
- niveli i ndikimit të projektit në parandalimin/eleminimin e një situate urgjente/të rrezikshme;
- vendndodhja gjeografike e territorit që preket nga projekti dhe në cilën njësi administrative identifikohet ai;
- mundësia e financimit të projektit: a financohet projekti prej buxhetit vendor kapital, apo prej programeve të qeverisë qendrore (QQ)/donatorëve/etj);
- kohëzgjatja e shlyerjes së kostos së projektit duke marre në konsiderate mundesite që ka projekti të gjenerojë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Tepelenë

Parashikimi i zërave të të ardhurave dhe të shpenzimeve për hartimin e PIK të Bashkisë Tepelenë është bazuar në Projekt-Buxhetet Afatmesme, duke aplikuar metodologjine zyrtare

të miratuar për këtë komponent të rëndësishem financiar. Për periudhën 2020 – 2030, parashikimet u kryen duke konsideruar trendin e përgjithshëm të ndjekur nga zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së mëparshme, normat rritëse të parashikuara në PBA 2017 – 2019, parashikimet e përgjithshme për treguesit makroekonomikë të publikuar nga Ministria e Financave. Parashikimet për të ardhurat dhe shpenzimet vendosen në një kontekst makroekonomik të qendrueshëm, ndërkohë që normat e rritjes së treguesve të ndryshëm për të ardhurat dhe për shërbimet do të aplikohen në mesataren rrëshqitëse të 5 viteve paraardhëse. Konkretisht parashikimet janë bazuar ne:

- balancim dhe rritje e moderuar e popullsisë vendore të Bashkisë;
- rritje nominale dhe reale e ekonomisë pranë vlerës potenciale;
- normë inflacioni e qëndrueshme dhe pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë për 3%;
- kurs këmbimi me valutat kryesore (euro dhe dollar amerikan) i qendrushëm pa goditje permanente dhe të qenësishme;
- rënie e ngadaltë por progresive e papunësisë;
- qendrueshmëri e bilancit të pagesave (llogari korente dhe financiare).




*fig 57 - Tabela përmbledhese e burimeve dhe nevojave financiare të PIK- Bashkia Tepelenë*

### 4.4.3 NDRYSHIMET INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR ZBATIMIN E PPV-SË

Zbatimi i suksesshëm i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë ka nevojë për një rivlerësim të kujdesshëm dhe riorganizim të strukturës ekzistuese organizative të institucionit të Njësisë Vendore, duke përditësuar në këtë mënyrë rolet dhe përgjegjësitë përkatëse për çdo drejtori apo sektor, sipas kontekstit të ri të zbatimit dhe monitrorimit të Planit. Kjo strukturë e re administrative dhe operacionale do të mundësojë zbatimin e projekteve strategjike të zhvillimit si dhe një monitorim më të mirë të zbatimit të treguesve të zhvillimit në të gjithë territorin administrativ të kësaj Njësie Vendore.

#### 4.4.3.1 PROPOZIMET PËR STRUKTUREN ADMINISTRATIVE NË BASHKINË TEPELENË

Vlerësimi dhe propozimet për këtë pjesë të dokumentit të Planit janë bërë duke ndjekur ndarjen aktuale të roleve dhe të funksioneve të disa drejtorive dhe sektoreve në strukturën e Bashkisë Tepelenë, pa përfshirë pjesën drejtuese të administrimit që përmban kabinetin e kryetarit të Bashkisë, nënkryetarit, sekretarit të përgjithshëm dhe auditit të brendshëm. Objektivi është rritja dhe përmirësimi i performances së Bashkisë Tepelenë, pa shtuar numrin e punonjësve të sektoreve mbështetës, pra pa shtuar peshë financiare në Buxhet. Propozimet lidhen me ndryshimet e sektorëve aktive në shërbimet Bashkiake, me qëllimin final të rritjes së performancës së këtij institucioni si dhe me objektivin final zbatimin me sukses të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Vlerësimet dhe propozimet lidhur me këtë pjesë të dokumentit janë bërë duke u bazuar në të dhënat e detajuara statistikore sipas Vendimit Nr 76, datë 28/12 /2018 "Për Miratimin e Buxhetit Për Vitin 2019" të Bashkisë Tepelenë. Sipas këtij dokumenti zyrtar, janë nxjerrë të dhënat e sakta të numrit të Drejtorive dhe Sektorëve të këtij Institucioni, si dhe numrin e punonjësve, duke përfituar kështu një panoramë të strukturës administrative të Bashkisë Tepelenë. Konkretisht, struktura administrative është e ndarë në:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Aparati i Bashkisë | 30 | punonjës |
| 2. Policia Bashkiake | 7 | punonjës |
| 3. Drejtoria e Bujqësise | 6 | punonjës |
| 4. Njësia Administrative Qender | 7 | punonjës |
| 5. Njësia Administrative Kurvelesh | 6 | punonjës |
| 6. Njësia Administrative Lopës | 4 | punonjës |
| 7. Çerdhet | 5 | punonjës |
| 8. Qendra Kulturore/Muzeu | 11 | punonjës |
| 9. Agjencia e Shërbimeve Publike | 66 | punetore |
| 10. Rrugët rurale | 13 | punonjës |
| 11. Arsimi i mesem | 6 | punonjës |
| 12. Arsimi 9-vjecar | 52 | punonjës |
| 13. MZSH | 14 | punonjës |
| 14. Pyjet | 6 | punonjës |

15. Ujitje kullim 1 punonjës
TOTAL 234 punonjës

Në bazë të analizës së strukturës organizative si dhe nevojave për përmirësimin e punës dhe zbatimin e objektivave strategjike, Plani i Përgjithshëm Rregullues propozon ndryshime në strukturën apo edhe numrin e punonjësve të Sektorit të Zhvillimit Urban, Kadastrës dhe Mirëmbajtjes së Mjedisit. Po ashtu Plani propozon ndryshime në Sektorin e Shërbimeve Publike, ndërkohë që nuk propozohen ndryshime në strukturën drejtuese të Bashkisë Tepelenë, përfshirë këtu kabinetin e Kryetarit, nën-Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Po ashtu Plani nuk identifikon domosdoshmëri për ndryshim të numrit të punonjësve të angazhuar për marrëdhëniet me publikun si dhe për Njësinë e Auditit të Brendshëm.

Gjithashtu Plani nuk parashikon nevojë për ndryshim në perspektivë të numrit dhe kapaciteteve të burimeve njerezore të Drejtorise së Financës dhe Tatimeve. Ky përcaktim i referohet faktit të një dinamike relativisht të ulët të zhvillimit ekonomik ekzistues të Bashkisë Tepelenë, dhe konkretisht në numrin e ulët të aktiviteteve private në territorin e kësaj Njësie Vendore. Për këtë arsye, Plani gjykon së nuk është e nevojshme që të parashikohet rritje e numrit të punonjësve të kësaj strukture, e cila edhe në gjendjen ekzistuese ka mundësi të përballojë rritjen e procedurave financiare dhe fiskale të aktiviteteve të reja ekonomike që do të mund të zhvillohen në territorin e Bashkisë Tepelenë.

Struktura dhe numri i organikës së Policisë Bashkiake gjykohet si i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave operative dhe për të mbuluar të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Tepelenë. Kjo strukturë e Policisë Bashkiake do të jenë përgjegjës për mbikqyrjen e aktiviteteve të përditshme të administrimit të të gjithë territorit të Bashkisë. Referuar Ligjit Nr. 89/2022 "Për policinë Bashkiake", detyra kryesore e Policisë Bashkiake është ruajtja e sigurisë dhe e qetësisë publike në territorin e Bashkisë Tepelenë, ndërkohë që në kontestin e Planit të Përgjithshëm Vendor, ajo merr një rol të rëndësishëm në kontrollin e territorit, dhe konkretisht në ndalimin, shmangien dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme, ndalimin e zënies e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të Bashkisë Tepelenë, si dhe të organizojë lirimin e tyre.

Për sa i përket Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Plani propozon strukturimin e Sektorit të Zhvillimit Urban, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Territorit. Në tabelën më poshtë specifikohet struktura e propozuar për këtë sektor

| **SEKTORI i I ZHVILLIMIT URBAN, KADASTRES DHE MBROJTJES së TERRITORIT** | |
|---|---|
| Pergjegjes Sektori | 1 |
| Specialist i Inspektoriatit Ndërtimor dhe Mbrojtjes së Tokave | 1 |
| Specialist i Urbanistikes | 2 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIT SEKRETARIA

| | |
|---|---|
| Specialist infrastrukturash | 1 |
| Specialist GIS/Kadaster | 1 |
| Punonjës i Mbrojtjes Civile, Urbanistika, Pyje, Kullota Nj. Qender | 2 |
| Punonjës i Mbrojtjes Civile, Urbanistika, Pyje, Kullota Nj. Kurvelesh | 1 |
| Punonjës i Mbrojtjes Civile, Urbanistika, Pyje, Kullota Nj. Lopës | 1 |
| total | 10 |

Zbatimi i Planit të Përgjithshëm të Bashkisë Tepelenë, dhe në mënyrë specifike zbatimi hartimi, zbatimi dhe monitorimi i projekteve strategjike apo dhe hartimi dhe monitorimi i Planeve të Detajuara Vendore PDV, kerkon në mënyrë të domosdoshme rritje të kapaciteteve të Sektorit të Zhvillimit Urban. në perputhje edhe me kategorine e Bashkisë Tepelenë, si nje qender terciare, Plani propon që kjo strukture të kete:

- Dy specialiste urbanistike, pergjegjes per:
  - ndjekjen e procedurave të perditshme të aplikimeve për leje zhvillimi, leje ndertimi dhe deklaratave paraprake të punimeve,
  - hartimi i Planeve të Detajuara Vendore, për zonat e rëndësise së veçante, së bashku me Pergjegjesin e Sektorit
  - permiresimin gradual të arkives urbanistike të Bashkisë Tepelenë
- Nje specialist infrastrukturash, pergjegjes për hartimin e projekteve të infrastruktuave, mbikqyrjen dhe raportimin
- Nje specialist GIS/Kadaster, pergjegjes për operimin dhe perditesimin e të gjithë sistemit të GIS/Kadastres në Bashkinë Tepelenë, dhe konkretisht:
  - Kontrollin e aplikimeve për Leje Zhvillimi/Ndërtimi të cilat vijnë nga sistemi online e-Leje
  - Krijimin dhe menaxhimin e database-it të Sistemit GIS për Bashkinë Tepelenë
  - Botimin në Regjistrin e Integruar të Territorit të akteve të miratuara

Gjithashtu, specialisti i GIS/Kadaster do të jetë pergjegjes për koordinimin e proceseve planifikuese të Bashkisë Tepelenë me "e-platforma", brenda struktures së Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit, e ngritur me qellim koordinimin e proceseve planifikuese të Njësive Vendore që nga ndermarrja e Nismes për hartimin e nje PDV'je dhe deri në miratimin e tyre final.

Gjithashtu Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon kater specialiste të posaçem për Mbrojtjen Civile, Urbanistiken, Pyjet dhe Kullotat, të ndare sipas Njësive Administrative, ku Njësia Administrative Qender do të këtë dy, për shkak të sipërfaqes së konsiderueshme që ajo mbulon. Keta specialiste do të punojne në koordinim të vazhdueshem me strukturen e Policise Bashkiake, në funksion të kontrollit dhe mbrojtjes së tokës, duke iu referuar përcaktimeve të funksioneve të lejuara dhe të palejuara si dhe treguesve territoriale për çdo Njësi Strukturore të territorit të Bashkisë Tepelenë.

| | |
|---|---|
| total | 6 |
| **SEKTORI i SHËRBIMEVE PUBLIKE** | |
| Pergjegjes Sektori | 1 |
| Specialist Sektori | 1 |
| Specialist emergjencash & supervizim i firmes së pastrimit | 1 |
| Pergjegjes gjelbërimi, mirembajtje e rrugëve, varrezave publike | 1 |
| Punonjës mirëmbajtje varrezash publike | 4 |
| Punonjës gjelbërimi dhe mirembajtje të hapesirave të gjelbra | 6 |
| Sanitar Bashkie | 1 |
| Sanitar i pallatit të kultures | 1 |
| Punonjës i mirembajtjes së ndricimit në qytet dhe Nj. Administrative | 2 |
| Punonjës i mirembajtjes së godinave publike dhe shkollave | 2 |
| Shofer për makinen e grumbullimit të mbetjeve | 1 |
| Shofer i skrepit për piken e depozitimit të mbetjeve urbane | 1 |
| Punetor i mirembajtjes së rrugëve rurale | 13 |
| Shofer i administrates | 1 |
| Punetor i mirembajtjes së rezervuareve | 2 |
| Punetor i vendgrumbullimit të mbeturinave | 4 |
| Punetore të impiantet e pastrimit të ujerave të zeza | 3 |
| Punonjes për stacionin multimodal të Tepelenës | 2 |
| Roja e i Bashkisë | 1 |
| total | 49 |

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon minimalisht **2 (dy) punonjës** për mirëmbajten e ndriçimit publik në qytet dhe në Njësitë Administrative të Bashkisë. Aktualisht ndriçimi i hapesires publike, perveçse është nje detyrim për institucionin e Bashkisë, është nje nga elementët me themelore të rikualifikimit urban të qendrave të banuara në këtë njësi vendore. në kontekstin e zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, dhe konkretisht të mënyrës së ndërhyrjes në Njësite Strukturore urbane, permiresimi i këtij komponenti të shërbimeve publike gjykohet me nje rëndësi të konsiderueshme. Rritja e numrit të punonjësve për këtë sektor merr në konsiderate dhe distancat e medha midis zonave të banuara të Bashkisë Tepelenë.

Duke iu referuar analizes së gjendjes ekzistuese të objekteve publike si dhe domosdoshmerise për rritjen e cilesise së shërbimeve, Plani e gjykon të pamjaftueshem numrin e punonjësve të mirembajtjes së godinave publike dhe shkollave në territorin e Bashkisë Tepelenë. Edhe pse nje pjesë e mire e objekteve arsimore në Tepelenë kane qene objekt i ristrukturimeve fizike në vitet e fundit, Plani e gjykon mjaft të domosdoshem mbajtjen e nje numri të mjaftueshme punonjësish të mirembajtjes. Duke marre në reference edhe natyren e funksionit të ketyre objekteve si dhe dosmosdoshmerine e ruajtjes së sigurise dhe komoditetit të mesimdhenies, Plani propozon dy **(dy)** punonjës të mirembajtjes së ndriçimit publik.

| |
|---|
| Duke iu referuar projektit strategjik për krijimin e tre pikave tranzitore të depozitimit të mbetjeve, Plani propozon shtimin e numrit të punonjësve të vend-grumbullimit të mbeturinave, dhe konkretisht, nga 1 (nje) punetor aktual, në **4 (kater)**.<br><br>Plani propozon shtimin e organikes së Sektorit të Shërbimeve Publike me 3 **(tre)** punetore shtese, të pozicionuar në impiantin e pastrimit të ujërave të zeza të qytetit si dhe në monitorimin, mirembajtjen dhe pastrimin e impianteve septike sanitare të fshatrave. Këto të fundit janë propozuar si projekte strategjike të zhvillimit të Bashkisë Tepelenë, në kontekstin e permiresimit të shërbimeve publike dhe sidomos në mbrojtjen e mjedisit të kesaj Njësie Vendore. Gjithashtu, këto projekte inxhinierike rrjedhin si nje detyrim ligjor i Bashkisë Tepelenë, referuar Ligjit Nr.10 431, datë 9.6.2011 "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT" i ndryshuar.<br><br>Referuar propozimit strategjik për ndertimin e stacionit multimodal, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë propozon **2 (dy)** punonjësve shtese në strukturen e Sektorit të Shërbimeve Publike. Kjo shtese organike do të zbatohet pas ndertimit të Objektit të Stacionit të ri. |
| Numri i punonjësve të perkohshem të mirembajtjes është në varesi të ekzigjencave periodike të Bashkisë Tepelenë. për këtë arsye Plani i Përgjithshëm Vendor nuk parashikon ndryshime në numrin e nevojshem të punonjësve me kohe të pjesshme. |

Në përfundim të analizës së strukturës së organigramës së Bashkisë Tepelenë, në funksion të zbatimit të suksesshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor, llogaritet një shtesë e nevojshme personeli prej 13 personash. Gjithsesi duhet thënë që Bashkia ka tagrin e saj brenda kuadrit ligjor ekzistues që të rikonceptojë skemën e brendshme të emërtimit dhe ndarjes së përgjegjësive midis drejtorive dhe sektoreve të ndryshëm të saj.

### 4.4.3.2 RRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT TË BASHKISË TEPELENË

Përveç rritjes numërike të numrit të stafit administrativ të drejtorive dhe sektoreve përkatës, të propozuar si më sipër, zbatimi me sukses i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë do të kërkojë potencialisht edhe ndërmarrjen e një sërë proceseve trainuese periodike për rritjen e kapaciteteve teknike të stafit. Si të tillë, Plani propozon:

1. **Organizimin e programeve të trainimit profesional**

Këto programe do të duhet të adresojnë rritjen e kapaciteteve të sektorëve të ndryshëm të administratës së Bashkisë, lidhur me temat:

- Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i proceseve që lidhen me zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe konkretisht për Planet e Detajuara Vendore si dhe proceset pasuese si Lejet e Zhvillimit dhe Lejet e Ndërtimit.

- Përmirësimi i kapaciteteve për planifikimin me pjesëmarrjen e publikut, përmes promovimit të proceseve të negociatave dhe arritjes së marrëveshjeve për bashkëveprimin e midis palëve të interesuara;
- Rritje e aftësive lidhur me analizat e vlerësimit të tregut të pasurive të paluajtshme dhe e aktiviteteve ekonomike që lidhen me to;
- Rritja e kapaciteteve në formulimin e ligjeve dhe rregullave lokale, integrimi i bazës së të dhënave dhe menaxhimi i informacionit (një sistem i unifikuar për të gjithë Bashkinë).
- Rritja e kapaciteteve të stafit të departamenteve të ndryshme për sa i përket hartimit të analizave socio-ekonomike, urbanistiko-mjedisore, infrastrukturore, fizike dhe arkitekturore, në funksion të përgatitjes së raporteve të ndryshme vlerësuese teknike.
- Proceset dhe metodologjitë e koordinimit midis departamenteve dhe sektoreve të ndryshëm të Bashkisë si dhe midis drejtorive rajonale, në funksion të arritjes së objektivave të Planit të Përgjitshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë.
- Aplikimi i programeve kompjuterike në sistemin GIS, jo vetëm në fushën e planifikimit urban, por edhe në proceset e hartimit dhe zbatimit të investimeve strategjike në infrastrukture, transport, kontrollin dhe monitorimin e emergjencave civile, monitorim dhe lehtësim të procedurave të mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, etj. Këto programe trajnimi duhet të adresojnë:
    - Njohja me parametrat bazë të funksionimit të sistemit të teknologjisë të informacionit dhe komunikimit;
    - Gjuha teknike e funksionimit të sistemeve GIS;
    - Krijimi, regjistrimi dhe administrimi i shtresave pikësore, lineare dhe sipërfaqësore të sistemit;
    - Integrimi në sistem i të dhënave vektoriale, variantet e ndryshme dhe gjeoreferencimi;
    - Prezantimi i koncepteve të strukturës, sistemit operativ dhe produkteve potenciale të programit kompjuterik GIS;
    - Përdorimi, editimi dhe gërshetimi i bazës së të dhënave;
    - Krijimi, mirëmbajtja dhe modifikimi i etiketave dhe shënimeve gjeografike;
    - Përfaqësimi në hartë i të dhënave kuantitative dhe cilësore;
    - Përfaqësimi në hartë i të dhënave pikësore;
    - Prezantimi, sistemi i referencimit hapësinor dhe i koordinatave gjeografike dhe të projektuara;
    - Prodhimi i hartave të kombinuara sipas të dhënave të ndryshme:
    - Prezantimi grafik në shkalle të ndryshme i të dhënave gjeohapësinore;

Të gjitha modulet e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve teknike të stafit administrativ të Bashkisë Tepelenë, përfshirë materialet, metodologjitë si dhe dokumentacioni përkatës do të depozitohen rregullisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Në këtë mënyrë, ky dokumentacion do të shërbejë për transferimin e njohurive dhe koncepteve tek punonjësit e rinj potenciale

të Bashkisë, të cilët mund të përfitojnë periodikisht nga të njëjtat cikle të trajnimeve. Në të njëjtën kohë, pjestarë të stafit të trajnuar do të mund të kthehen në trajnues të brendshëm brenda strukturës së Bashkisë Tepelenë, me një angazhim periodik jo më tepër së 1.5 orë në javë. Kostoja e aplikimit të këtij lloj sistemi trainimesh do të ishte si vijon:

- Kosto e ditës së punës të funksionarëve të trajnuar në qendrat e trajnimit publike për ditët e trajnimit;
- Kosto e 1.5 orëve kohë pune në javë për trainuesin si dhe kosto e kohës së shpenzuar për rekrutimin e punonjësve të rinj që do të trainohen.

Në këtë mënyrë, kostoja e trajnimit për stafin e ri të Bashkisë do të jetë më e vogël së përfitimet e rritjes potenciale të numrit dhe përmasave të projekteve publike të zbatuara në fazat e njëpasnjëshme të zbatimit të PPV-së, duke dhënë impakt në uljen e peshës së shpenzimeve të administrimit të përgjithshëm.

**PERMIRESIM I KUADRIT RREGULLATOR TË BRENDSHEM TË BASHKISË TEPELENË**

Zbatimi me sukses i Planit të Përgjithshëm Vendor kërkon si domosdoshmëri një bashkëpunim dhe koordinim efikas institucional dhe ndërinstitucional, midis drejtorive dhe sektoreve të Bashkisë Tepelenë. Për këtë arsye Plani identifikon nevojshmërinë për hartimin e një dokumenti të brendshëm rregullator, duke adresuar mënyrën operacionale të proceseve të hartimit të PDV apo projekteve fizike, duke përfshirë aplikimin online të lejeve të zhvillimit apo ndërtimit, përdorimin e sistemeve të informacionit me bazë GIS apo edhe procedurat komplekse të prokurimit publik.

Nga rishikimi institucional i strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë identifikohet mungesa e një zyrë e të dhënave statistikore vendore dhe asnjë punonjës me detyrë funksionale përkatëse në këtë drejtim. Gjatë procesit të hartimit të Planit, kjo mungesë ka rezultuar mjaft problematike, e reflektuar në vonesën e mbledhjes së të dhënave statistikore cilësore, të nevojshme për Analizën e Përgjithshme të Territorit.

Në këtë kontekst është thelbësore që të rriten kapacitetet teknike të stafit lidhur me aktivitetet e përpunimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të të dhënave gjeohapësinore, në mbështetje të sektorit të planifikimit dhe menaxhimit të projekteve. I gjithë ky proces duhet bërë në bashkëpunim të ngushtë me kadastrën urbane dhe rurale të Bashkisë Tepelenë, i cili në perspektivë mund të marrë në konsideratë përfshirjen e detyrave të tyre ose në varësi të një ristrukturimi total të integrohet me Sektorit e Planifikimit dhe Menaxhimit të Territorit.

Gjithashtu, Plani i Përgjithshëm i Bashkisë Tepelenë thekson nevojën urgjente për përmirësimin e bazës materiale të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm të institucionit, si edhe rritjen e shkalles së përdorimit të teknologjisë së informacionit në një numër sa më të madh procesesh.

të Bashkisë, të cilët mund të përfitojnë periodikisht nga të njëjtat cikle të trajnimeve. Në të njëjtën kohë, pjestarë të stafit të trajnuar do të mund të kthehen në trajnues të brendshëm brenda strukturës së Bashkisë Tepelenë, me një angazhim periodik jo më tepër së 1.5 orë në javë. Kostoja e aplikimit të këtij lloj sistemi trainimesh do të ishte si vijon:

- Kosto e ditës së punës të funksionarëve të trajnuar në qendrat e trajnimit publike për ditët e trajnimit;
- Kosto e 1.5 orëve kohë pune në javë për trainuesin si dhe kosto e kohës së shpenzuar për rekrutimin e punonjësve të rinj që do të trainohen.

Në këtë mënyrë, kostoja e trajnimit për stafin e ri të Bashkisë do të jetë më e vogël së përfitimet e rritjes potenciale të numrit dhe përmasave të projekteve publike të zbatuara në fazat e njëpasnjëshme të zbatimit të PPV-së, duke dhënë impakt në uljen e peshës së shpenzimeve të administrimit të përgjithshëm.

**PERMIRESIM I KUADRIT RREGULLATOR TË BRENDSHEM TË BASHKISË TEPELENË**

Zbatimi me sukses i Planit të Përgjithshëm Vendor kërkon si domosdoshmëri një bashkëpunim dhe koordinim efikas institucional dhe ndërinstitucional, midis drejtorive dhe sektoreve të Bashkisë Tepelenë. Për këtë arsye Plani identifikon nevojshmërinë për hartimin e një dokumenti të brendshëm rregullator, duke adresuar mënyrën operacionale të proceseve të hartimit të PDV apo projekteve fizike, duke përfshirë aplikimin online të lejeve të zhvillimit apo ndërtimit, përdorimin e sistemeve të informacionit me bazë GIS apo edhe procedurat komplekse të prokurimit publik.

Nga rishikimi institucional i strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë identifikohet mungesa e një zyrë e të dhënave statistikore vendore dhe asnjë punonjës me detyrë funksionale përkatëse në këtë drejtim. Gjatë procesit të hartimit të Planit, kjo mungesë ka rezultuar mjaft problematike, e reflektuar në vonesën e mbledhjes së të dhënave statistikore cilësore, të nevojshme për Analizën e Përgjithshme të Territorit.

Në këtë kontekst është thelbësore që të rriten kapacitetet teknike të stafit lidhur me aktivitetet e përpunimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të të dhënave gjeohapësinore, në mbështetje të sektorit të planifikimit dhe menaxhimit të projekteve. I gjithë ky proces duhet bërë në bashkëpunim të ngushtë me kadastrën urbane dhe rurale të Bashkisë Tepelenë, i cili në perspektivë mund të marrë në konsideratë përfshirjen e detyrave të tyre ose në varësi të një ristrukturimi total të integrohet me Sektorit e Planifikimit dhe Menaxhimit të Territorit.

Gjithashtu, Plani i Përgjithshëm i Bashkisë Tepelenë thekson nevojën urgjente për përmirësimin e bazës materiale të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm të institucionit, si edhe rritjen e shkalles së përdorimit të teknologjisë së informacionit në një numër sa më të madh procesesh.

**PLOTESIMI i MUNGESAVE APO VAKANCAVE NEPERMJET NENKONTRAKTIMEVE PERIODIKE**

Duke marrë në konsideratë nevojat për staf të kualifikuar, vështirësinë për të integruar kompetenca të reja, Bashkisë Tepelenë i lind e drejta të nënkontraktojë një pjesë të funksioneve të veta, duke ia deleguar një palë të tretë. Me qëllim që procesi i nënkontraktimit të kryhet në kushtet optimale, është e nevojshme të identifikohen dhe specifikohen qartësisht funksionet e çdo zyre dhe sektori. Bashkia mund të delegojë një pjesë të funksioneve të veta drejt të tretëve, të cilët nëpërmjet procesit të prokurimit ose tenderimit garantojnë realizimin e detyrës.

Për realizimin e nënkontraktimit në kushte optimale, nuk mjafton vetëm identifikimi i funksioneve të cilat do t'i delegohen palës së tretë, por është i nevojshëm dhe një proces hartimi i Termave të Referencës, menaxhimi i procesit të tenderimit ose prokurimit, ku përfshihet dhe monitorimi i gjithë procesit të prokurimit dhe kushteve të kontratës për zbatim. Pra, eksternalizimi i funksioneve, edhe pse e redukton punën e Bashkisë, kërkon një staf mbikqyrës dhe hartues të termave të referencës dhe përpilimit të kontratës, gjë që përbën një kosto fikse për Bashkinë, për shkak të stafit të ngarkuar në përmbushjen e këtyre roleve.

Përfundimisht, në rast delegimi të funksioneve specifike, është e nevojshme të ndërmerret një studim i kostos, në të cilin përfshihet, jo vetëm kostoja e delegimit, por dhe kostot fikse të Bashkisë në përpilimin e kontratave dhe monitorimit të tyre

## 4.4.3.3. PROPOZIMET PËR BAZEN TEKNIKE DHE LOGJISTIKE PËR ZBATIMIN E PLANIT

Duke iu referuar vlerësimit të gjendjes ekzistuese të logjistikës teknike në dispozicion të administratës së Bashkisë Memaliaj, evidentohet qartë nevojat emergjente që kanë zyrat e kësaj administrate, në kuadër të funksionimit normal dhe realizimit të suksesshëm të objektivave të Strategjisë Territoriale dhe Planit të Përgjithshëm Vendor. Në këtë pikëpamje, Plani propozon rivlerësimin e plotë të strukturës logjistike të çdo drejtorie dhe sektori të administratës publike të Bashkisë Memaliaj. Në vazhdim paraqiten nevojat për plotësim për periudhën 15 vejçare të Planit.

| PERMIRESIMI i KUADRIT LOGJISTIK DHE BAZES TEKNIKE | |
|---|---|
| | |
| **EMERTIMI** | **NR. I PUNONJËSVE** |
| **Zyrat e Kryetarit të Bashkisë dhe Nen-Kryetarit** | **5** |
| **Zyrat e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Sekretarit të Këshillit Bashkiak** | **2** |
| **Zyra e Auditit të Brendshëm** | **1** |

Aktualisht, kjo strukture drejtuese disponon hapesirat e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre, brenda Bashkisë Tepelenë. në aspektin logjistik, Plani i Përgjithshëm Vendor propozon që këto struktura të kene në dispozicion:

- 5 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe dhe Autodesk, si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik
- 3 printera/skaner/fotokopje – me lidhje të brendshme
- 2 automjete të dedikuara - autoveture
- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar.

**Drejtoria e Finances dhe Tatimeve** | **14**

Kjo strukture administrative financiare disponon hapesirat e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre, brenda godines së Bashkisë Tepelenë. në aspektin logjistik, Plani propozon që këto struktura të kene në dispozicion:

- 10 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office dhe Adobe, si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik;
- 3 printera/skaner/fotokopje – me lidhje të brendshme
- 1 automjet të dedikuar, - autoveture - kryesisht për specialistet e tatimeve për Qendrat Adminstrative
- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar.
- Dy kasaforta të dedikuara

**Policia Bashkiake** | 6

Kjo strukture mbikqyrese dhe sigurie ka nevoje për zgjerim të hapesirave të nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre, të cilat mund të akomodohen jashte godines së Bashkisë Tepelenë. në aspektin logjistik, Plani propozon që trupa e policise Bashkiake të kene në dispozicion:

- 2 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe dhe Autodesk, si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik
- 1 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme;
- 2 automjete të dedikuara – pickup;
- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapësire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration




Model i propozuar automjet PICkUP

| | |
|---|---|
| **SEKTORI i I ZHVILLIMIT URBAN, KADASTRES DHE MBROJTJES së TERRITORIT** | 13 |

Ky sektor ka nje rëndësi të veçante në zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Territoriale dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë. Aktualisht hapesirat e kesaj strukture administrative dhe monitoruese janë të pozicionuara pranë godines së Bashkisë, ndërkohë duhet thene së këto hapesira kane nevoje urgjente për rikonstruksion të brendshem, duke mundesuar nje hapesire pune të përshtatshme për të akomoduar ngarkesen në rritje, në kontekstin e zbatimit të PPV. në aspektin logjistik, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:

- 5 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe dhe Autodesk, si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik
- 1 printer/skaner/fotokopje A2-A3 – me lidhje të brendshme
- 1 projektor elektronik të nevojshem për prezantimet e studimeve PDV apo projekteve specifike teknike
- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapësirë të arkivimit të dokumentacionit zyrtar.

| | |
|---|---|
| **SEKTORI i BURIMEVE NJEREZORE** | 6 |

Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:

- 3 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik
- 1 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme
- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar.

| | |
|---|---|
| **SEKTORI i SHËRBIMIT SOCIAL** | 7 |

Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:

- 3 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik

- 1 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme
- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar.

| **SEKTORI i SHËRBIMEVE PUBLIKE** | 53 |
|---|---|

Plani propozon shtim të numrit të punonjësve të këtij sektori, me qellim permiresimin e performances administrative në perballimin e sfidave për realizimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. për sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:

- 3 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik
- 1 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme
- 3 automjete të dedikuara – pickup - për levizjen e stafit dhe transportin e bazes materiale
- 2 automjete për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve - kamion
- 1 automjet –kamion- për evakuimin dhe transportin e mbetjeve inerte apo të gjelbra
- Hapesirat e nevojshme për magazinimin e bazës materiale dhe mjeteve të punes për punonjësit e mirembajtjes publike,
- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar




Model i propozuar i grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

| **SEKTORI BUJQËSOR, VETERINAR DHE MJEDISIT** | 14 |
|---|---|

Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:

- 2 kompjutera desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik
- 1 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme
- 1 automjet të dedikuara – pickup - për levizjen e stafit dhe transportin e bazes materiale për mirembajtjen e rezervuareve dhe rrjeteve të vaditjes
- 2 automjete të dedikuara – pickup - për levizjen e specialisteve pyjore dhe rojtareve të pyjeve kullotave dhe livadheve.

| |
|---|
| - Hapesirat e nevojshme për magazinimin e bazës materiale dhe mjeteve të punes për punonjësit e mirembajtjes së rrjeteve vadites dhe kullimit,<br>- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar |
| **DREJTORIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR & PUNONJËSIT MBËSHTËTES për ARSIMIN 9-VJECAR/MESEM** |
| Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:<br>- 2 kompjuter desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik<br>- 1 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme<br>- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar |
| **SHËRBIMI i MBROTJES NGA ZJARRI** |
| Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:<br>- 1 kompjuter desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik<br>- 1 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme<br>- 3 automjete të dedikuara – kamion - për shuarjen e zjarreve dhe ndërhyrje të sigurise fizike.<br>- Hapesirat e nevojshme për magazinimin e bazës materiale,<br>- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapësirë të arkivimit të dokumentacionit zyrtar |
|  Model i propozuar për mbrojtjen kunder zjarrit |
| **NJËSITE ADMINISTRATIVE** |
| Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:<br>- 3 kompjuter desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik<br>- 3 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme |

| | |
|---|---|
| - Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar | |
| **GJENDJA CIVILE** | 4 |
| Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:<br>- 4 kompjuter desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik<br>- 4 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme<br>- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar | |

#### 4.4.3.4. EFEKTET FINANCIARE TË PROPOZIMEVE TË STRUKTURES SË RE DHE LOGJISTIKES

Në praktikën e administrimit publik, raporti i shpenzimeve korente për paga dhe shpenzimeve operative në funksion të administrimit të përgjithshëm duhet të jetë i tillë, që të justifikohet nga niveli i shërbimeve të ofruara të popullatës (shërbimet publike) dhe potenciali për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen (d.m.th investimet).

Propozimet lidhur me ndryshimet në skemën administrative dhe përmirësimin e logjistikës së Bashkisë Tepelenë, në funksion të zbatimit të Planit, implikojnë kosto shtesë për këtë institucion. Për sa i përket ndryshimeve në burimet njerëzore, shtesa financiare e nevojshme është llogaritur duke u bazuar në nivelet e pagave zyrtare, të përcaktuara sipas:

- Nenit 5 të ligjit 10405 datë 24.03.2011 "Për kompetencat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve" të ndryshuar;
- Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" të ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- VKM Nr. 328/2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes vendore".
- VKM nr 350 datë 19.04.2017 "Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin "e ndryshuar;
- VKM nr. 175, datë 08.03.2017 "Për trajtimin me page dhe shtesat mbi page të punonjësve mesimore në arsimin parauniversitar" e ndryshuar;
- VKM nr 717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështëtes në institucioneve buxhetore " i ndryshuar;
- VKM nr 175 datë 08.03.2017 "Për trajtimin me page dhe shtesat mbi page të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar" i ndryshuar.

| | |
|---|---|
| - Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar | |
| **GJENDJA CIVILE** | 4 |
| Per sa i perket logjistikes së nevojshme, Plani propozon që kjo strukture të këtë në dispozicion:<br>- 4 kompjuter desktop – të pajisur me programet përkatëse të paketes Office, Adobe si dhe lidhje të shpejtë interneti për të mundesuar komunikimin zyrtar elektronik<br>- 4 printer/skaner/fotokopje A4 – me lidhje të brendshme<br>- Pajisjet standard të mobilimit të zyrave, perfshire hapesire të arkivimit të dokumentacionit zyrtar | |

#### 4.4.3.4. EFEKTET FINANCIARE TË PROPOZIMEVE TË STRUKTURES SË RE DHE LOGJISTIKES

Në praktikën e administrimit publik, raporti i shpenzimeve korente për paga dhe shpenzimeve operative në funksion të administrimit të përgjithshëm duhet të jetë i tillë, që të justifikohet nga niveli i shërbimeve të ofruara të popullatës (shërbimet publike) dhe potenciali për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen (d.m.th investimet).

Propozimet lidhur me ndryshimet në skemën administrative dhe përmirësimin e logjistikës së Bashkisë Tepelenë, në funksion të zbatimit të Planit, implikojnë kosto shtesë për ketë institucion. Për sa i përket ndryshimeve në burimet njerëzore, shtesa financiare e nevojshme është llogaritur duke u bazuar në nivelet e pagave zyrtare, të përcaktuara sipas:

- Nenit 5 të ligjit 10405 datë 24.03.2011 "Për kompetencat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve" të ndryshuar;
- Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" të ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- VKM Nr. 328/2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes vendore".
- VKM nr 350 datë 19.04.2017 "Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin "e ndryshuar;
- VKM nr. 175, datë 08.03.2017 "Për trajtimin me page dhe shtesat mbi page të punonjësve mesimore në arsimin parauniversitar" e ndryshuar;
- VKM nr 717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës në institucioneve buxhetore " i ndryshuar;
- VKM nr 175 datë 08.03.2017 "Për trajtimin me page dhe shtesat mbi page të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar" i ndryshuar.

Ndërkohë, ndryshimet e propozuara administrative, në mënyrë të përmbledhur janë si me poshte:

| nr | pozicioni dhe funksioni | numri | paga | total |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Punonjës të policise Bashkiake | 2 | 42,000 | 84000 |
| 2 | Specialiste të inspektoriatit ndertimor | 2 | 30000 | 60000 |
| 3 | Specialist urbanistike | 1 | 30000 | 30000 |
| 4 | Punonjës së ndricimit | 2 | 39000 | 78000 |
| 5 | Punonjës mirembajtje godinash administrative | 2 | 33000 | 66000 |
| 6 | Punonjës së pikave të mbeturinave | 3 | 31600 | 94800 |
| 7 | Punonjës impiantesh spetike | 3 | 33000 | 99000 |
| 8 | Punonjës terminali | 2 | 33000 | 66000 |
| 9 | Punonjës pyjore | 2 | 36500 | 73000 |
| | **TOTAL** | **19** | **308100** | **650800** |

Për sa i përket logjistikës, llogaritja e kostos është bërë duke marrë për bazë një vlere të përafërt të tregut të këtyre produkteve. Bashkia Memaliaj ka tagrin që të rivlerësojë kostot përkatëse në bazë të ofertës së dhënë nga operatorë të ndryshem, duke ruajtur një marzh ndryshimi prej 15% ndaj vlerës së dhënë.

| nr | emertimi | nr | Cmimi | total |
|---|---|---|---|---|
| 1 | kompjutera desktop | 51 | 25000 | 1275000 |
| 2 | printer/skaner/fotokopje A4 | 24 | 12000 | 288000 |
| 3 | printer A3 | 1 | 35000 | 35000 |
| 4 | projektor | 1 | 50000 | 50000 |
| 5 | autovetura | 3 | 2500000 | 7500000 |
| 6 | automjet pickup | 7 | 3000000 | 21000000 |
| 7 | kamion mbeturinash | 2 | 10000000 | 20000000 |
| 8 | kamion transporti | 1 | 4000000 | 4000000 |
| 9 | zjarrfikse | 3 | 10000000 | 30000000 |
| 10 | mobilim zyrash | | 2000000 | 2000000 |
| | **TOTAL** | **TOTAL** | **31622000** | **86148000** |

### 4.4.4 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCES PËR HARTIMIN E PDV'VE

Plani i Përgjithshëm Vendore i Bashkisë Tepelenë përcakton nje seri Njësish Strukturore, të cilat do të zhvillohen permes hartimit të Planeve të Detajuara Vendore (PDV). Këto njësi janë përcaktuar kryesisht në qytetin e Tepelenës, në fshatin Dukaj, Rexhinë, Progonat si dhe në fshatin Nivicë të perfshire në programin "Akademia 100 fshatrat". Duke iu referuar Rregullores së Planifikimit të Territorit, këto PDV do të zbatohen në sinkron me treguesit e

bilancit të territorit, pjesë e Rregullores së Planit. Sipas ketyre treguesve, PDV që do të hartohen do të kene parasysh:

- Përcaktimin e zonave të zhvillimit brenda Njësise Strukturore, të cilat do të jenë subjekt rizhvillimi, rigjenerimi apo konsolidimi urban;
- Përcaktimin e korridoreve të brendshme të komunikimit, të lidhur me me rrjetin rrugor të propozuar të Planit të Përgjithshëm Vendor.
- Përdorimet e tokës dhe kushtet e zhvillimit për çdo zone;
- investimet publike në infrastrukturë apo shërbimet publike, që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e kushteve të zhvillimit;
- Programet e drejtimit të zhvillimit nëpërmjet instrumenteve, në përputhje me nenet 30 dhe 31 të ligjit.

Bashkia Tepelenë është pergjegjese për administrimin e proceseve teknike për hartimin e dokumenteve përkatës të PDV-ve për Njësite Strukturore të parashikuara në Plan. Hartimi i dokumentit të PDV do të behet nga ana e Bashkisë, në rastet kur parashikohen projekte të rëndësishme në infrastrukture dhe shërbime në territorin e nje Njësie, ose nga ana e aktoreve të interesuar për zhvillim. Në rast hartimi nga palët e interesuara, procesi mbikëqyret në çdo hap nga struktura përgjegjëse e planifikimit të territorit të Bashkisë Tepelenë.

Referuar kuadrit ligjor në fuqi, procesi i hartimit PDV-ve do të nise permes botimit të dokumentit të Nismes nga ana e Bashkisë, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit. Dokumenti i miratuar dhe i publikuar i Nismes do të permbaje:

- Kodin e Njësisë, të paracaktuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor, shoqëruar me përcaktimet për zhvillimin e njësisë që rrjedhin nga ky plan.
- Deklaratën e dakordësisë së pronarëve që kanë në pronësi jo më pak së 51% të sipërfaqes së Njësisë, në rastin e hartimit të PDV-së me nismë private, në përputhje me pikën 5, të nenit 22 të Ligjit për Planifikimin e Territorit
- Planin e veprimit për hartimin e PDV-së.

Proceset e diskutimit dhe këshillimit të te gjitha dokumenteve të PDV-ve që do të përgatiten në kuader të zbatimit të PPV'se, do të ndjekin të gjitha momentet dhe afatet ligjore të përcaktuara në kuadrin rregullator përkatës, duke perfshire mjetet e informacionit publik në Bashkinë Tepelenë, botimin në Regjistrin Kombëtar si dhe nepermjet takimeve të hapura me banorët dhe aktoret e perfshire. Çdo dokument i përgatitur i PDV'se për nje Njësi Strukturore të caktuar duhet të permbaje:

a) Analizën dhe planin e zhvillimeve të propozuara të territorit në forme hartografike, si dhe relacion përkatës
b) Strukturen e ndarjes së Njësise në Nen-Njësi përkatëse (Zona Zhvillimi) duke identifikuar për secilen prej tyre kushtet e zhvillimit, funksionet e propozuara si dhe treguesit e miratuar sipas pasaportes së Njësise Strukturore.
c) Strukturen e rrjetit të propozuar të hapesirave, infrastruktures rrugore si dhe rrjetet e tjera të shërbimeve publike duke përfshirë energjinë, telekomunikacionin dhe ujësjellës-kanalizimeve;

d) Përcaktimet e kushteve të zhvillimit për nënnjësitë, sipas rastit dhe/ose për parcelat;
e) Dokumentin e Rregullores së planit të detajuar, ku përfshihen perveç termave dhe kodeve të gjitha përcaktimet që kane të bejne me kushtet e zhvillimit të hapesires dhe rrjeteve të infrastrukturave të çdo Zone Zhvillimore brenda Njësise Strukturore. Gjithashtu rregullorja do të permbaje kriteret për zbatimin e distancave midis zhvillimeve, rregullat e mbrojtjes së mjedisit si dhe të zonave me karakteristika të veçanta si ato historike, turistike, zonat e mbrojtura, etj.
f) Dokumenti i Planit të Veprimit për zbatimin e PDV'se;
g) Informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS, në përputhje me standardet e miratuara ligjore.
h) Relacion teknik përkatës që trajton shperndarjen e të drejtave të zhvillimit si dhe raportet e perfitimit sipas kontributit.

Dokumentet e PDV've të përgatitura hyjne në fuqi me botimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të vendimit të miratimit nga kryetari i Bashkisë dhe dokumenteve përbërëse të PDV-së, pas respektimit të te gjitha procedurave teknike dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren e Planifikimit të Territorit. Pas hyrjes në fuqi të tij, Bashkia Tepelenë është pergjegjese për rregjistrimin e PDV've në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Monitorimi i zbatimit të çdo PDV'je do të kryhet nepermjet shqyrtimit rigoroz të termave teknike, afateve dhe indikatoreve të monitorimit të specifikuar në dokumentin e Planit të Veprimeve.

### 4.4.5 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCES PËR HARTIMIN E PLANEVE SEKTORIALE

Planet Sektoriale janë dokumente zhvillimore, brenda kuadrit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë, të cilat trajtojne zhvillimin e elementëve specifike zhvillimore, që kane të bejne me rrjetet e infrastrukturave dhe shërbimeve, duke perfshire:

- Furnizimi me ujë të pijshëm
- Zgjerimi dhe permiresimi i rrjetit të rrugëve vendore
- Largimi publik i mbeturinave
- Shtrirja, zgjerimi dhe permiresimi i rrjetit të transportit publik
- Shtrirja, zgjerimi dhe permiresimi i shërbimeve social-kulturore, perfshire arsimin, shendetesine, sigurine, mbrojtjen nga zjarri dhe permbytjet, etj.
- Permiresimin e varrezave publike
- Permiresimi i rrjetit të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore

Perveç infrastrukturave dhe shërbimeve publike, Planet Sektoriale në Bashkinë Tepelenë do të trajtojne komponente të permiresimit të parametrave mjedisore, zhvillimin ekonomik, turizmin malor dhe të aventures si dhe zhvillimin e bujqësise rurale. në mënyrë të përmbledhur, nje Plan Sektorial trajton nje element të caktuar të rolit dhe pergjegjesise që ka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planning - Architectural Restoration
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA

nje Njësi e Qeverisjes vendore. në princip, nje Plani Sektorial nuk kufizohet nga përcaktimet e kufijve të Njësive Strukturore apo të Sistemeve Territoriale, por mund të shtrihet në territore të ndryshme.

Ne varesi të komponentit të perfshire në projektim, nje Plan Sektorial do të permbaje:

1. Analizën e detajuar të elementit të perfshire në studim, duke perfshire të gjithë komponentet ekzistues territoriale, potencialet, problematikat, legjislacionin përkatës dhe strategjite, vlerësimin e zonave apo objekteve të rëndësise kombëtare që mund të ndodhen në territorin e përcaktuar të Planit Sektorial. Gjithashtu analiza do të permbaje vlerësimin e elementëve perjashtues dhe kufizimeve që rrjedhin si pasoje e zhvillimeve të sektorit përkatës në territorin e Bashkisë Tepelenë apo në Rajonin e Gjirokastres. të gjitha këto elemente të analizes së detajuar do të shoqerohen me materialet hartografike përkatës.
2. Analizën Social Ekonomike të territoreve të banuara që preken prej zhvillimit dhe zbatimit të Planit Sektorial.
3. Vizioni i zhvillimit të sektorit përkatës të trajtuar në Plan duhet të perputhet dhe të jetë në sinkron me Vizionin e Strategjisë Territoriale të Bashkisë Tepelenë si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Rajonit të Gjirokastres.
4. Strategjinë e zhvillimit të Sektorit përkatës duke perfshire objektivat përkatës, skenaret e mundshem të zhvillimit, përfituesit, përgjegjësit, kostot e përafërta, veprimet për zbatimin e strategjisë, afatet dhe kohëzgjatjen, ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, indikatoret e zbatimit dhe monitorimit si dhe hartat shoqëruese;
5. Dokumentin e Planit Sektorial, i cili, në varësi të sektorit mund të përmbajë:
    - strukturimin i territorit, duke evidentuar propozimet e përdorimit të tokës, sipas kategorive dhe nënkategorive të çdo Sistemi territorial
    - planin e shërbimeve dhe infrastrukturave në varësi të sektorit përkatës
    - parashikimet për mbrojtjen dhe zgjidhjen e problematikave mjedisore, permiresimin e karakteristikave peisazhistike, mbrojtjen e trupave ujore, permiresimin e cilesise së ajrit, shtimin e hapesireva të gjelbra, etj
6. Dokumentin e Planit të Veprimeve, duke perfshire zbatimin e infrastrukturave publike sipas prioritetit dhe fazave kohore, nevojat për ndryshime në kuadrin ligjor si dhe indikatoret e monitorimit të zbatimit;
7. Hartat shoqëruese;
8. Dokumentin e Rregullores së Planit Sektorial ku perfshihen kushtet e përgjithshme për zhvillimin e Sektorit në studim, kushtet e zhvillimit për çdo zonë të përcaktuar brenda territorit të perfshire në Planin Sektorial, rregullat për zbatimin e ndërhyrjeve në infrastrukture dhe shërbime. Gjithashtu dokumenti i Rregullores do të permbaje rregullat për ruajtjen e mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore dhe objekteve të trashëgimisë kulturore;
9. Dokumentin e Vlerësimin Strategjik Mjedisor;

10. Informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS, në përputhje me standardet e miratuara ligjore.

Miratimi i Planit Sektorial të përgatitur për nje territor të caktuar të Bashkisë Tepelenë do të bazohet në përcaktimet ligjore për miratimin e instrumenteve të planifikimit të territorit. në këtë rast, nje element i rëndësishem është perfshirja e dokumentit të perputhshmerise që leshohet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, e cila kryen procesin e shqyrtimit të përputhshmërisë së dokumentit të Planit Sektorial, duke hartuar me pas raportin e vlerësimit teknik në mënyrë të përseritur, deri në arritjen e përputhshmërisë.

Dokumentet e përgatitura të Planeve Sektoriale hyjne në fuqi me botimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, pas respektimit të te gjitha procedurave teknike dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren e Planifikimit të Territorit. Pas hyrjes në fuqi të tij, Bashkia Tepelenë është pergjegjese për rregjistrimin e Planit në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Monitorimi i zbatimit të çdo Plani Sektorial do të kryhet nepermjet shqyrtimit rigoroz të termave teknike, afateve dhe inidkatoreve të monitorimit të specifikuar në dokumentin e Planit të Veprimeve.

### 4.4.6 TREGUESIT E MONITORIMIT PËR ZBATIMIN E PPV-SË

#### 4.4.6.1 INDIKATORËT PËR MONITORIMIN DHE UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË PPV-SË

Zbatimi me sukses i Strategjisë Territoriale dhe i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë imponon si domosdoshmëri konsolidimin e një sistemi të brendshëm kontrolli dhe monitorimi. Ky sistem do të shërbejë si një instrument afatgjatë në shërbim të administratës së Bashkisë, i cili do të mundësojë verifikimin në çdo kohë të ecurisë së zbatimit të dokumenteve zhvillimore. Në këtë mënyrë, ky sistem mund të aplikohet si një sistem afatgjatë i vlerësimit të performancës së sektorëve të ndryshëm të administratës, duke saktësuar nevojat për përmirësim të mëtejshëm.

Efektet monitoruese të këtij sistemi do të bazohen në kontrollin e një sërë treguesish përkatës të radhitur në tabelën në vijim. Vlerësimi i indikatorëve do të jetë subjekt analizave periodike statistikore të performancës së punës së Bashkisë Tepelenë, të cilat mund të hartohen në terma 6 mujore apo vjetore, si dhe të paraqiten për komente apo miratim para Këshillit Vendor të këtij institucioni.

**TABELA E TREGUESVE të MONITORIMIT të PPV BASHKIA TEPELENË**

| | NDËRHYRJET | INDIKATORËT E MONITORIMIT të PLANIT | Njësia matese |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| PERMIRESIMI i PARAMETRAVE të HAPESIRES URBANE | Permiresimi i cilesive fizike të hapesirave publike urbane të Bashkisë Tepelenë | Sipërfaqja e rikualifikuar të hapesirave publike të qytetit dhe fshatrave | m² |
| | | Numri sheshеve publike | njësi |
| | | Numri i ambienteve dhe rrugëve të pajisura me ndriçim publik | njësi |
| | | Sipërfaqja e hapesirave të dedikuara për kembesoret | m² |
| | | | |
| | Permiresimi i fasadave të banesave dhe objekteve në zonat urbane | Numri i banesave dhe objekteve me ndërhyrje | njësi |
| | | Sipërfaqe rekreative urbane | m² |
| | | | |
| | Rritja e sipërfaqes së parkimeve publike | Numri i parkimeve në funksion të tipit të mjetit. | njësi parkimi |
| | | Sipërfaqja e parkimeve | m² |
| | | | |
| | Permiresimi i situates së hapesirave të gjelbra në të gjithë territorin e Bashkisë | rritja e sipërfaqes së gjelbër në të gjithë territorin e Bashkisë | m² |
| | | Numri i lulishteve dhe parqeve | njësi |
| | | Numri i pemëve të mbjella | njësi |
| | | Takime sensibilizuese të mbrojtjes së mjedisit me banorët dhe përfaqësuesit e bizneseve në Tepelenë | takime |
| | | | |
| | Rehabilitimi i stokut të banesave të braktisura në Bashkinë Tepelenë | Numri i banesave dhe objekteve me ndërhyrje | njësi |
| | | Sipërfaqe banimi e rivitalizuar | m² |
| | | | |
| | Rritja e cilesise dhe performances së shërbimeve shëndetësore në Bashkinë Tepelenë | Numri qendrave shëndetësore | njësi |
| | | Numri i shtreterve | njësi |
| | | Numri i mjekëve | persona |
| | | Numri i Infermierëve | persona |
| | | Sipërfaqe e ambienteve shendetesore të rikonstruktura | m² |
| | | | |
| | Rritja e cilësisë dhe performances së sistemit arsimor në Bashkinë Tepelenë. | Numri i shkollave të rikonstruktuara | njësi |
| | | numri i shkollave me infrastrukturë sportive | njësi |
| | | Numri i shkollave me ambiente të dedikuara në teknologjinë e informacionit dhe TIK | njësi |

ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
studio@archi-space.com NIPT: L42403012A
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT - SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT - SEKRETARIA

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Numri i shkollave të pajisura me sisteme ngrohje. | njësi |
| | | Numri i shkollave me klasa laboratorike kimi / fizike / biologji | njësi |
| | | Numri i shkollave me biblioteka të dedikuara | njësi |
| | | Numri i shkollave me ambiente të dedikuara sportive | njësi |
| | | | |
| | Rritja e aktiviteteve sportive në të gjitha territoret urbane të Bashkisë Tepelenë | Sipërfaqja e dedikuar sportive | $m^2$ |
| | | Numri i objekteve sportive | njësi |
| | | Numri i aktiviteteve sportive | njësi |
| | | | |
| ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR | Permiresimi i situates së biznesit në të gjithë territorin e Bashkisë | Rritja e numrit të subjekteve ekonomike të vogla dhe të mesme | njësi |
| | | Densiteti i subjekteve prodhuese | subj/ $km^2$ |
| | | Subjekte tregtare për kilometër | subj/ $km^2$ |
| | | Numri i bizneseve sezonale | njësi |
| | | Numri i zonave të perqendruara ekonomike | njësi |
| | | Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore | lek |
| | | Ulja e nivelit të papunësise | % |
| | | | |
| | Zhvillimi i sektorit të bujqësise në Bashkinë Tepelenë | Sipëfaqe totale e tokës së kultivuar | ha |
| | | Sipërfaqe totale e kultivuar me kultura periodike | ha |
| | | Sipërfaqe totale e kultivuar me kultura të perhershme | ha |
| | | Numri i pemëve frutore të mbjella | njësi |
| | | Sipërfaqja e serave të instaluara | ha |
| | | Numri i mjeteve bujqësore | njësi |
| | | Numri i mjeteve bujqësore sipas përdorimit. | njësi |
| | | Volumi i prodhimit të dritherave | ton |
| | | Volumi i prodhimit të frutave | ton |
| | | Volumi i prodhimit të produkteve foragjere | ton |
| | | Volumi i qumështit të prodhuar | litra |

| | | |
|---|---|---|
| | Volumi i mishit të prodhuar në nivel Bashkie | kg |
| | Numri i krerëve të bagetise së imët | krere |
| | Numri total i gjedheve | krere |
| | Numri total i shpendeve | krere |
| | Subjekte të perpunimit dhe magazinimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale | njësi |
| | Numri i mjeteve bujqësore | njësi |
| | Numri i subjekteve prodhuese bujqësore dhe blegtorale | njësi |
| | Aktivitete në mbështëtje të bujqësise dhe blegtorise të organizuara | njësi |
| | | |
| Rivitalizimi i zonave me potencial për zhvillimin e turizmit natyror dhe agroturizmit në Bashkinë Tepelenë | Numri i bizneseve të prodhimit artizanal. | njësi |
| | Numri i aktiviteteve kulturore dhe sociale në mbështetje të Turizmit. | njësi |
| | Numri i panaireve, në mbështetje të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë | njësi |
| | Numri i bizneseve të sektorit të agro-turizmit | njësi |
| | Numri i subjekteve akomoduese | njësi |
| | Numri i B&B | |
| | Qarkullimi vjetor i subjekteve turistike | lek |
| | Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore | lek |
| | | |
| | Numri i shërbimeve mbështetëse të turizmit | njësi |
| | Numri i subjekteve që ofrojnë shërbime rekreative në mbështetje të turizmit | njësi |
| | | |
| Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve turistike | Numri i siteve arkeologjike | njësi |
| | Numri i muzeve | njësi |
| | Numri i operatorëve turistikë, që operojnë në territor. | njësi |
| | Numri i qëndrave të informacionit | njësi |
| | Numri i sinjalistikes së aktiviteteve sportive, kulturore, turistike, etj. | njësi |
| | **Numri i Broshurave fletushkave etj. në promovimin e turizmit** | **Copë** |
| | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **RRJETI RRUGOR DHE TRANSPORTI PUBLIK** | Zhvillimi i rrjetit rrugor në të gjithë territorin e Bashkisë | Gjatësia lineare sipas kategorisë së rrugëve | km |
| | | Sipërfaqja totale e rrugëve të rikonstruktuara | m² |
| | | Sipërfaqe totale e parkimeve | m² |
| | | Numri i parkimeve të krijuara | njësi |
| | | Numri i parkimeve për banorë | njësi / banor |
| | | Numri i tabelave sinjalizuese | njësi |
| | | | |
| | Zhvillimi dhe permiresimi i transportit publik | Ndertimi i terminalit multimodal | njësi |
| | | Numri i stacioneve të reja të transportit publik | njësi |
| | | Numri i mjeteve në dispozicion të transportit publik | njësi |
| | | Distanca e akseve rrugore të mbuluara me transport publik | km |
| | | Numri i udhëtarëve për linjë | udhëtar/ linjë |
| | | | |
| **ENERGJIA** | Permiresimi i infrastruktures energjitike | Gjatësi lineare e rrjetit të tensionit të ulët | km |
| | | Gjatësi lineare e rrjetit të tensionit të ulët | km |
| | | Sipërfaqja e territorit e mbuluar me rrjetin e tensionit të ulët | km² |
| | | Numri i centraleve elektrike në të gjithë territorin | njësi |
| | | Numri i transfomatorëve | njësi |
| | | Gjatësi lineare e rrjetit të tensionit të lartë nëntokësor | km |
| | | Gjatësi lineare e rrjetit të tensionit të lartë ajror | km |
| | | Numri i ndërhyrjeve permiresuese në rrjetet e furnizimit dhe shperndarjes | njësi |
| | | Reduktimi i humbjeve në rrjet | % |
| | | | |
| | Zhvillimi dhe përdorimi i energjisë alternative. | Prodhimi i energjise hidrike | KV |
| | | Prodhimi i energjise fotovoltaike | KV |
| | | Prodhimi i energjise eolike | KV |
| | | Energji e konsumuar nga ndriçimi publik | KV |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Numri i ndriçuesve me energji fotovoltaike në të gjithë territorin e Bashkisë | njësi |
| | | | |
| RRJETET E UJIT, KANALIZIMET DHE REZERVUARET | Përmiresimi i rrjetit të furnizmit me uje në të gjithë territorin e Bashkisë | Rritja e gjatesise lineare e linjave primare të furnizimit me uje | km |
| | | Numri i depove të reja të ujit të instaluara | njësi |
| | | Numri i depove të rikonstruktura | njësi |
| | | Gjatesia e linjave të furnizimit të rikonstruktuara | km |
| | | Rritja e sasise së ujit të furnizuar në rrjete | $m^3$ |
| | | Numri i sahateve të ujit të instaluar | njësi |
| | | Reduktimi i humbjeve në rrjetet e furnizimit me uje | % |
| | | Rritja e të ardhurave të shërbimit | % |
| | | | |
| | Përmiresimi i rrjetit të kanalizimeve të ujerave të zeza | Ndërtimi i impiantit të pastrimit/purifikimit të ujerave të zeza të qytetit Tepelenë | njësi |
| | | Ndertimi i impianteve të pastrimit të ujerave të zeza të fshatrave | njësi |
| | | Rikonstruksioni i kolektoreve kryesore të kanalizimeve të ujerave | km |
| | | Rikonstruksioni i rrjeteve të brendshme urbane të kanalizimeve | km |
| | | Sipërfaqja e zonave urbane të sherbyer me rrjet kanalizimesh | ha |
| | | Rikonstruksioni i rrjeteve të ujerave të bardha | km |
| | | | |
| | Përmirësimi i rrjetit të vaditjes dhe kullimit | Ristrukturimi i rrjetit ekzistues të ujitjes dhe vaditjes | Km |
| | | Sipërfaqe e mbuluar nga rrjeti vaditës dhe i kullimit | ha |
| | | **Rikonstruksioni i rrjetit të rezervuareve ekzistues të Bashkisë Tepelenë** | **njësi** |
| | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration - ARCHISPACE STUDIO - studio@archi-space.com NIPT: L42403012A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SEKRETARIA

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Numri i ndriçuesve me energji fotovoltaike në të gjithë territorin e Bashkisë | njësi |
| | | | |
| RRJETET E UJIT, KANALIZIMET DHE REZERVUARET | Përmiresimi i rrjetit të furnizmit me uje në të gjithë territorin e Bashkisë | Rritja e gjatesise lineare e linjave primare të furnizimit me uje | km |
| | | Numri i depove të reja të ujit të instaluara | njësi |
| | | Numri i depove të rikonstruktura | njësi |
| | | Gjatesia e linjave të furnizimit të rikonstruktuara | km |
| | | Rritja e sasise së ujit të furnizuar në rrjete | $m^3$ |
| | | Numri i sahateve të ujit të instaluar | njësi |
| | | Reduktimi i humbjeve në rrjetet e furnizimit me uje | % |
| | | Rritja e të ardhurave të shërbimit | % |
| | | | |
| | Përmiresimi i rrjetit të kanalizimeve të ujerave të zeza | Ndërtimi i impiantit të pastrimit/purifikimit të ujerave të zeza të qytetit Memaliaj | njësi |
| | | Ndertimi i impianteve të pastrimit të ujerave të zeza të fshatrave | njësi |
| | | Rikonstruksioni i kolektoreve kryesore të kanalizimeve të ujerave | km |
| | | Rikonstruksioni i rrjeteve të brendshme urbane të kanalizimeve | km |
| | | Sipërfaqja e zonave urbane të sherbyer me rrjet kanalizimesh | ha |
| | | Rikonstruksioni i rrjeteve të ujerave të bardha | km |
| | | | |
| | Përmirësimi i rrjetit të vaditjes dhe kullimit | Ristrukturimi i rrjetit ekzistues të ujitjes dhe vaditjes | Km |
| | | Sipërfaqe e mbuluar nga rrjeti vaditës dhe i kullimit | ha |
| | | **Rikonstruksioni i rrjetit të rezervuareve ekzistues të Bashkisë Memaliaj** | **njësi** |
| | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| NDËRHYRJE MJEDISORE | Permiresimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane | Sipërfaqja urbane e mbuluar me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve | km² |
| | | Ndertimi i pikave tranzitore të depozitimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë | njësi |
| | | Numri i koshave të mbeturinave të instaluar në të gjithë territorin | njësi |
| | | Sasia e mbeturinave të ricikluar | ton |
| | | | |
| | Permiresimi i parametrave natyrore | Eliminimi i pikave të ndjeshme HOTSPOT, në të gjithë territorin e Bashkisë | njësi |
| | | Sipërfaqe natyrore e rehabiltuar | km² |
| | | Sipërfaqe natyrore e pyllezuar | km² |
| | | Renia e sipërfaqes së prekur nga zjarret | % |
| | | Rritja e sipërfaqes natyrore të mbrojtur | % |
| | | | |
| | Permiresimi i parametrave të trupave ujore | Rehabilitimi i zonave pranë brigjeve ujore të prekuara nga erozioni lumor | m² |
| | | Sipërfaqe e pyllezuar e brezave repariane | m² |
| | | Permiresimi i parametrave kimike të ujerave të lumenjve dhe përrenjve | parametra kimike |

Duhet pasur parasysh, së për kryerjen e këtij procesi periodik monitorimi, Bashkia Tepelenë ka nevojë për rritje të kapaciteteve teknike të drejtorive dhe sektoreve të administratës, si dhe duke nëpërmjet krijimit të zyrave statistikore dhe njësive të implementimit të projekteve.

### 4.4.7 FAKTORËT QË NDIKOJNË RISHIKIMIN E PLANIT të PËRGJITHSHËM VENDOR

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë mund të ketë nevojë për rishikime, si pasojë e disa faktorëve potenciale, të paraqitura si në vijim:

- Ndryshime të statusit të zonave specifike, të miratuara nga KKT-ja, në varësi të projekteve apo strategjive kombëtare dhe sektoriale, në përcaktimin e zonave për investime strategjike sipas ligjit përkatës mund të sjellin ndryshime në përcaktimet e PPV-së së Bashkisë Tepelenë.
- Ka ndryshim të kushteve ekonomike, sociale dhe demografike: Kushtet sociale-ekonomike mund të ndryshojnë në varësi të problemeve, apo fatkeqësive natyrore, nga kriza ekonomike, nga mungesa e investimeve, apo orientimi i saktë i tyre mos diversifikimi i tregut të punës, mund të sjellin migrim të popullsisë. Në zona të caktuara

ka interes ekonomik, që sjell punësim dhe të ardhura në nivel vendor, i cili nuk gjen hapësirë në parashikimet aktuale të PPV-së dhe kërkon përshtatje të dokumentacionit.

- Planet Sektoriale në nivel qarku apo të ministrive të ndryshme, mund të diktojnë rekomandime dhe masa të ndryshme nga parashikimet e PPV-së, duke kërkuar akomodime në territor apo ndryshime të parametrave të parashikuar.
- Të gjitha detajet e përcaktuara në Vendimin Nr.232, date 17.042019 "Per disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 686, date 22/11/2107 të Këshillit të Ministrave, "Per Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit". Sipas këtij vendimi, dhe konkretisht referuar pikes 38 të Nenit 2, korrigjimi i dokumentit të planifikimit në fuqi do të behet në rastet kur konstatohen gabime drejtshkrimore, dy ose me shume parashikime të ndryshme për të njejten zone/njësi strukturore në dokumente të ndryshme perberese të planit, mosperputhje të treguesit të lartesise në kate me ate të lartesise në metra, mosperputhje të përcaktimeve në dokumentin e planifikimit me gjendjen faktike të zhvillimeve në territor.

Ne rast të evidentimit të çdo nje prej rasteve të permendura me sipër, i cili implikon nevojen për ndryshimin e nje pjesë të permbajtjes së Planit të Përgjithshëm Vendor, referuar Vendimit Nr. 232, autoriteti pergjegjes për planifkimin e territorit përgatit nje relacion shpjegues dhe njofton Agjencine e Zhvillimit të Territorit, e cila shqyrton rastet sipas karakteristikave të tyre specifike. në rastet kur Agjencia verifikon domosdoshmerine për ndryshimin sipas kerkeses së autoritetit të planifikimit, ajo ia percjell KKT kërkesen për miratimin e vendimit, shoqeruar me dokumentin e korrigjuar të ndryshimit. Vendimi i ndryshimit hyn në fuqi pas publikimit në fletoren zyrtare.

### 6.5. SHTOJCAT

Bashkia Tepelenë duhet të këtë në dispozion në mënyrë të printuar dhe të kataloguar dokumentet kryesore strategjike të zhvillimit të sektoreve të ndryshem, që kane ndikim në zhvillimin territorial, social ekonomik dhe infrastrukturor të kesaj Njësie Vendore.

**Plani i Përgjithshëm Kombëtar "Shqipëria 2030"** është dokumenti kryesor që përfaqëson harmonizimin e qasjes së integruar të zhvillimit urban, me sektorë të tjerë strategjikë të vendit si turizmi, bujqësia, energjia, transporti, strehimi dhe të tjera aspekte, që ndërthuren brenda synimit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.

**Strategjia Sektoriale e Transportit 2016-2020 dhe Plani i Veprimit** - Objektivi kryesor i këtij dokumenti strategjik është zhvillimi i rrjetit kombëtar të transportit duke përmirësuar ndërveprimin, qëndrueshmërinë dhe integrimin e tij me sistemin rajonal dhe europian të transportit. në këtë dokument trajtohen 43 politika specifike për transportin për zbatim deri në vitin 2022

**Strategjia Kombëtare të Energjise 2018-2030** - Strategjia synon në krijimin e nje tregu elektrik konkurrues bazuar në kerkesat e Bashkimit Europian për reformimin e sektorit elektroenergjitik (Direktiva 96/92 EU) dhe detyrat e Shqipërise në kuadrin e Memorandumit të Mirekuptimit të Athines, (15 Nentor 2002), për integrimin e sektorit elektroenergjitik shqiptar në Treg.

**Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve** - është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve për Shqipërine. Strategjia rregullon menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë nga gjenerimi deri tek asgjesimi përfundimtar mbi bazën e një qasje të integruar që do të strukturohet në përputhje me mundësitë reale që ka vendi për të përshtatur në kohë standardet më të mira Evropiane, në mënyrë që të shmangë dhe zvogëlojë në masën më të madhe ndikimet negative në shëndetin e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

**Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime** – synon në hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe -kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Evropian dhe me Objektivin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për qëndrueshmërinë e mjedisit

**Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027** - sherben si nje udhezues për politikat për ujin, si dhe të nxise zhvillimet operacionale dhe investime ndermjet të gjithë sektoreve brenda afatit 10 vjeçar. Strategjia është hartuar në mënyrë të tille që të ofroje nje kornize gjithëperfshirese të burimeve ujore, duke perbere keshtu në nje kuader mjaft relevant për zhvillimin dhe administrimin e territoreve të Bashkisë Tepelenë, bazuar kjo në burimet ujore që kjo njësi disponon.

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020** - përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon Agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020** paraqet vizionin e Qeverisë Shqiptare për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore dhe përparimin e procesit të decentralizimit sipas standardeve më të përparuara evropiane. Ai prezanton një përqasje gjithëpërfshirëse ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetë-Qeverisjen Vendore, si edhe me ato e Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA

**Strategjia Ndersektoriale e Mjedisit 2015-2020** – ku identifikohet Shqipëria si nje vend me një zhvillim të qëndrueshem social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vendosur ato në perfitim të prosperitetit ekonomik". Politikat mjedisore gjatë periudhës 2015 -2020 do të fokusohen në:

**Strategjia Kombëtare e Turizmit 2019 – 2023**, sipas së ciles ekonomia turistike po konturohet gjithnjë e më shumë si një nga deget kryesore të zhvillimit në Shqipëri. Sipas të dhenave zyrtare, kontributi total i turizmit në Shqipëri përbën rreth 26.2% të PBBsë, duke e pozicionuar këtë sektor si një ndër kontribuesit kryesor të zhvillimit të ekonomisë kombëtare. Po ashtu, në sektorin e turizmit janë punësuar rreth 7.7% e të gjithë forcës së punës në Shqipëri, ndërkohë që deri në 2028 parashikohet që ky numër të rritet në nivelin 8.8 %. Referuar raportit të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC), parashkohet që investimet në këtë sektor deri në 2028 të rriten në nivelin 8,2% të PBB'se kombëtare.

Perveç dokumenteve të permendura me sipër, me qellim zbatimin me sukses të Planit të Përgjithshëm Vendor, është e nevojshme që të hartohen dhe të vihen në dispozicion të studimeve në vazhdim:

1. **Raporti i detajuar i Censusit të Popullsise dhe Banesave - 2020**. Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka planifikuar të kryejë censin e ardhshëm të popullsisë dhe banesave në vitin 2020, i cili do të ndjekë metodën e numërimit të drejtpërdrejtë bazuar në operacionet në terren me përpilimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur metoda të reja për mbledhja e të dhënave. në saje të këtij censusi, Bashkia Tepelenë duhet të rifreskoje listat e popullsise ekzistuese në territorin e saj administrativ, duke saktësuar përfundimisht numrin e perditesuar të banorëve në të gjitha zonat urbane dhe rurale të territorit që administron. Ky informacion është thelbesor për proceset në vazhdim të administrimit të territorit dhe zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përcaktuar qartë popullsite e targetuara dhe perfituese nga projekte të ndryshme të zhvillimit.
2. **Studim i plote** për verifikimin dhe ri-vlerësimin e bonitetit të tokave bujqësore në territorin e Bashkisë Tepelenë, duke përcaktuar nivelet ekzistuese të bonitetit. Bashkia Tepelenë ka nevoje që të këtë në dispozicion nje material të perditesuar të klasifikimit të tokave bujqësore sipas bonitetit, material i cili do të sherbeje për identifikimin e atyre tokave që po humbasin bonitetin si pasoje e veprimtarise njerezore por eshe për shkak të agjenteve natyrore.
3. **Databaze** e digitalizuar e rrjeteve të furnizimit me uje dhe kanalizimeve të te gjitha zonave rurale. Nje nga problemet e evidnetuar gjatë analizes së rrejteve të infrastrukturave në Bashkinë Tepelenë është mungesa e bazave të perditesuara të informacionit për furnizimin me uje dhe kanalizime. Shumica e këtij informacioni gjendet në format letre, në hapesirat e godines së Bashkisë Tepelenë. Krjijimi i nje database të tille do të ishte mjaft i rëndësishem për administrimin e rrjeteve të furnizimit dhe kanalizimit në të gjitha zonat urbane dhe rurale të Bashkisë, duke ofruar

keshtu nje inventor të qartë dhe të perditesuar, si dhe duke racionalizuar proceset e ndërhyrjeve fizike permiresuese.

4. **Projekte teknike strategjike**, të listuara në dokumentin e Strategjisë Territoriale – në dokumentin e Strategjisë Territoriale të Bashkisë Tepelenë janë listuar rreth 70 projekte strategjike, të cilat adresojne transfmormime në të 5 Sistemet Territoriale të kesaj Njësie Vendore. Është e nevojshme që Bashkia të hartoje dokumentet teknike për të gjitha projektet strategjike të listuara si prioritet për fazen e pare të zbatimit. në këtë mënyrë, jo vetem krijohet nje metodologji e posaçme, por nga ana tjeter Bashkia Tepelenë do të këtë projekte të gatshme për të adresuar burime të ndryshme potenciale të financimit, donator, qeverine qendrore, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, etj.
5. **Projekt teknik për vlerësimin e zonave të rrezikuara** nga permbytjet pranë qytetit Tepelenë apo në territoret pergjate korridorit të Vjoses – është e nevojshme që të behet nje projekt i perditesuar i përcaktimit të zonave të rrezikuara nga permbytjet në territorin e Bashkisë Tepelenë. Ky Institucion duhet të koordinoje punen me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar për perditesimin e kufijve të zonave të rrezikuara, sidomos pranë qendrave të banuara, duke ndihmuar keshtu në identifikimin e masave paraprake për shmangien e katastrofave si dhe nevojave teknike për ndërhyrje pergjate shtratit të Vjoses.



*fig 58 - Pamje të vershimit të lumit Vjosë , dhjetor 2017*

6. **Manual i brendshëm** për hartimin e PDV dhe Planeve Sektoriale, në përdorim të Bashkisë

## 6.6. DËGJESA PUBLIKE

Takimi, i organizuar me iniciativen dhe angazhimin e Bashkisë Tepelenë, u krye në ambientet e Pallatit të Kultures "Mustafa Matohiti", të qytetit, në daten 04 Qershor 2020, ora 10:30. në këtë takim moren pjesë rreth 45 përfaqësues të komunitetit vendor të Tepelenës, Bashkisë, Njësive Administrative, arsimit, biznesit vendor, bujqësise.

Pjesëmarrja ishte relativisht e kufizuar për shkak të kritereve të detyrueshme të distancave midis njerezve, imponuar në kuader të situates së COVID-19 në Shqipëri. Takimi ishte njoftuar me pare në faqen zyrtare të Bashkisë Tepelenë, ndërkohë që prej nje muaji, në zyren e Drejtorise së Planifikimit të Territorit në këtë Njësi Vendore janë kryer mjaft takime me qytetare apo biznesmene të interesuar për investime apo zhvillime të ndryshme.

Fjalen e hapjes e mbajti Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Z. Tërmet Peçi, i cili beri nje prezantim të përmbledhur të procesit të ndjekur për finalizimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Z. Peçi falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin e tyre në këtë proces, por edhe të gjithë ata që kane qene pjesë dhe kane dhënë kontributin e tyre në process, duke theksuar ndërkohë nevojen e miratimit sa me të shpejte të këtij instrumenti të rëndësishem për administrimin e territorit të Bashkisë Tepelenë.




*fig 59 - Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Z. Termet Peçi, duke mbajtur fjalen e hapjes së takimit*

Gjithashtu, në fjalen e tij, Z. Peçi i informoi pjesëmarrësit lidhur me proceduren zyrtare të finalizimit të Planit, permes miratimit të tij zyrtar nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë si dhe nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit, që është edhe organi me i larte vendimmarres që ben miratimin përfundimtar të Planit.



*fig 60 – pamje të degjeses publike në Bashkinë Tepelenë*

Me pas, takimi vazhdoi me prezantimin e elementëve kryesore të Planit të Përgjithshëm Vendor, nga ana e përfaqësuesit të grupit të konsulencës. Prezantimi trajtoi në mënyrë kronologjike të gjithë momentet dhe fazat kryesore të procesit të hartimit të Planit, duke u ndalur paraprakisht në rezultatet e Analizes së Pergjithshme si dhe Strategjisë Territoriale lidhur me Sistemet Territoriale.

Bazuar në këto përfundime, është konceptuar Vizioni i përgjithshëm i zhvillimit të Bashkisë Tepelenë, i cili perfshin nje qasje shume-dimensionale të kontekstit të zhvillimit të kesaj Njësie

Vendore në perspektive, duke përcaktuar piketat përkatëse në aspektin e transformimit të territoreve urbane, mbrojtjes së tokës natyrore dhe bujqësore, zhvillimit ekonomik, punësimit si dhe zhvillimit social dhe të gjitha rrjeteve të infrastrukturave. Pjesëmarrësve në takim iu be e qartë në mënyrë të perseritur që propozimet finale të Planit janë produkt i komenteve dhe modifikimeve të vazhdueshme, në bashkepunim me Drejtorine e Planifikimit të territorit të Bashkisë Tepelenë, gjatë fazave pararëndëse të procesit. Sipas përfaqësuesit të grupit të konsulentëve, në baze të Vizionit të Përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit, është bërë zberthimi i të gjithë sistemeve territoriale të Bashkisë Tepelenë, proces i cili është finalizuar me përcaktimin e zonave territoriale, njësive strukturore, kritereve përkatëse të zhvillimit si dhe rrjeteve të infrastrukturave dhe shërbimeve.

Prezantimi është fokusuar në shpjegimin e konceptit të Njësive Strukturore, të cilat do të jenë elementët baze të menaxhimit të Planit si dhe territorit të Bashkisë Tepelenë në të ardhmen. Sipas përfaqësuesit të grupit të konsulentëve, njësite janë të zberthyera në tabela specifike të bilancit, në të cilat janë evidentuar treguesit dhe koeficientet e transformimit ose të ruajtjes së çdo territori të Bashkisë. Tabelat do të jenë pjesë e integruar e Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, dhe do të jenë të paraqitura online, në platformën zyrtare shteterore të administrimit të territorit, duke u bërë keshtu të aksesueshme për të gjithë.

Me pas është shpjeguar koncepti i PDV, si studime të detajuara për zona specifike të territorit të Bashkisë, të cilat duhet të zhvillohen vetem permes studimeve të tilla. në total Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë ka parashikuar nje numër prej 26 Njësish Strukturore, për të cilat do të jetë e nevojshme hartimi i Planeve të Detajuara. Këto zona perfshijne territoret kryesore urbane të qytetit të Tepelenës si dhe disa territore të tjera me interes zhvillimit, të diskutuara gjatë me Drejtorine e Planifikimit të Bashkisë.

Gjate prezantimit janë dhënë informacione lidhur me rrjetet e infrastrukturave dhe shërbimeve të propozuara, të përshtatura sipas treguesve reale të zhvillimit në Bashkinë Tepelenë.

Prezantimi ka trajtuar çeshtjet e përdorimeve të lejuar, përdorimeve të kufizuara si dhe atyre të ndaluara për kategorite e ndryshme të tokës. Objektivi në këtë pjesë të prezantimit ishte të theksohej në maksimum tek pjesëmarrësit fakti që në tokat bujqësore ndalohet kategorikisht ndertimi për qellime urbane, ndërkohë që janë shpjeguar klauzolat përkatëse të rregullores së planit për strukturat e lejuara në funksion bujqësor dhe blegtoral.

Po ashtu janë dhënë shpjegime lidhur me ndertimet e lejuara në tokat natyrore, sipas zonimit të propozuar, lidhur me strukturat akomoduese dhe rekreative të nen-kategorisë EKOTURIZEM. Ne fund të prezantimit, për prezantuesit u ritheksuan hapat finale të procesit të miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë, dhe konkretisht: miratimi në Këshillin Bashkiak si dhe miratimi në Këshillin Kombëtar të Territorit.

AKPT
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
ArchiSpace Studio
sferastudio architecture

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE

## PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR
### DËGJESË PUBLIKE NR 3 – 04 MAJ 2020
### LISTE PJESËMARRJA

| Nr | EMER MBIEMER | NE .TEL | E-MAIL | INSTITUCIONI | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Leonikho Mumej | 0696988052 | | ADM. HJ. O. | [signature] |
| 2 | Avni Çela | 0695737340 | anibla@live.com | N Profekt | [signature] |
| 3 | SPiro Koni | 0693873096 | [illegible] | DREJTOR FINANCE | [signature] |
| 4 | HEKURAN ALIA | 0696434652 | hekuranalia4@gmail.com | QYTETAR | [signature] |
| 5 | | | | | |
| 6 | Naso Meçaj | 0692416943 | | | [signature] |
| 7 | Marjana Balli | 0691780629 | [illegible] | Administr. N.E.PAK | [signature] |
| 8 | Rita Ferofili | 0694643617 | Bashkia | Tepelenë | [signature] |
| 9 | Vallona Celo | 0693319206 | celo.vallona10@gmail | Zv/d Kesh. Bashkia | [signature] |
| 10 | Miranda Nazaj | 0695151780 | [illegible]@gmail.com | Spec finance | [signature] |
| 11 | Arta Shuaku | 0693482422 | artashuaku@gmail.com | Drejtor | [signature] |
| 12 | Elseda Bilbili | 0684121128 | ElsedaBilbili1@gmail.com | Sekretar | [signature] |
| 13 | Aleksandër Tati | 0684363339 | [illegible] | Kshilli Bashkiak | [signature] |
| 14 | Almarina Pazo | 0698500664 | almarinapazo@gmail.com | Spec Protokolli | [signature] |
| 15 | Ariola Selimi | 0675150402 | ariolavalera@yahoo.it | Arkives | [signature] |
| 16 | Kleona Bdyja | 0688710695 | kleonabdyja@gmail.com | Bashkia Tepelene | [signature] |
| 17 | Redion Hashia | 0692262962 | hashiaredion@gmail. | Bashkia Tepelene | [signature] |
| 18 | Krisela Sulaj | 0693842730 | kristjela.sulaj@yahoo.com | Bashkia Tepelene | [signature] |



AKPT
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
ArchiSpace Studio
sferastudio architecture

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR
DËGJESË PUBLIKE NR 3 – 04 MAJ 2020
LISTE PJESËMARRJA

| Nr | EMER MBIEMER | NE .TEL | E-MAIL | INSTITUCIONI | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 19 | PERSANA SPAHA | 0698526414 | persanallajo@hotmail.com | DPKZHT | [signature] |
| 20 | BESIANA XHAFA | 0696634034 | besianatafili@gmail.com | Bashkia Tepelene | [signature] |
| 21 | Xhuljeta Pasho | 0697263043 | xh.velika@gmail.com | Bashkia Tepelene | [signature] |
| 22 | Vladimir Meçi | | | | [signature] |
| 23 | Geraldo Celo | 0694218333 | | P.A.Q. Tepelene | [signature] |
| 24 | Nevisa Hasa | 0676319039 | hasanevisa@gmail.com | DPKZHT | [signature] |
| 25 | Gazmend Groshi | 0694575180 | gazmendgroshi86@Gmail.com | Bashkia Tepelene | [signature] |
| 26 | Viktor Kume | 6947586668 | | | [signature] |
| 27 | | | | | |
| 28 | Valentina Kume | 6942433299 | | | [signature] |
| 29 | Gëzim Dervishi | 0684896289 | gezimdervishi79@gmail.com | ALB-MINIERA | [signature] |
| 30 | Elvis Shehu | 0692215256 | elvisshehu87@gmail.com | Zyra Punësimit Tepelene | [signature] |
| 31 | | | | | |
| 32 | | | | | |
| 33 | | | | | |
| 34 | | | | | |
| 35 | | | | | |
| 36 | | | | | |



REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA TEPELENE
REPUBLIKA E SHQIPERISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA
ARCHISPACE STUDIO - Architecture - Interior Design - Urban Planing - Architectural Restoration studio@archi-space.com